

MIROSLAV BOSHKOVIQ

DANÇE MAÇEVSKA

HISTORIA

PËR
VITIN I

arsimi i mesëm profesional

KOMISIONI RECENSUES

Prof. D-r. Margarita Peshevсka
Prof. Sashko Korçovski
Prof. Sllavço Markovski

Përkthyes: Besa Dërндar

Redaktor profesional: prof. dr. Asllan Hamiti

Lektor: mr. Ismail Hamiti

Botuesi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar dooel, Shkup

Tirazhi: 2.000

Me vendim të Ministrisë për arsim dhe shkencë ë Republikës së Maqedonisë Nr. 22-5318/1 prej datës 30.11.2010 lejohet përdorimi i këtij teksti shkollor.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент Охридски”, Скопје

94 (100) (075.3)

БОШКОВИЌ, Мирослав

Историја за 1 година средно стручно образование / Мирослав Бошковиќ, Данче Мачевска.

- Скопје: Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010, - 163 стр.

: илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-226-197-3

1. Манчевска, Данче [автор]

COBISS.MK-ID 85373706

PARATHËNIE

Libri i historisë për vitin e parë të arsimit të mesëm profesional është shkruar sipas programit mësimor - FLRE për të gjitha drejtimet e arsimit të mesëm profesional, për 2 orët e parashikuara të fondit javor ose 72 orë fond vjetor. Programi mësimor përfshin 40 njësi mësimore të ndara në pesë tërësi tematike të historisë së përgjithshme: Parahistoria, Koha e lashtë, Mesjeta, Koha e re dhe Koha më e re.

Gjatë përpilimit të përmbajtjeve të tekstit shkollor, jemi përpjekur që të japim një pasqyrë sa më të qartë të temave të cilat përpunohen, me qëllim që në mënyrë më të përshtatshme të shqyrtohen faktet historike dhe raportet shkaqe-pasojë dhe lidhjet e ngjarjeve historike.

Në shtojcë të tekstit themelor të librit, janë dhënë edhe shtojca të shumta të aparaturës didaktike, si: harta historike, ilustrime, pyetje dhe detyra, aktivitete hulumtuese, të përshtatura sipas grupmoshës së nxënësve për të cilët edhe është dedikuar ky tekst shkollor, për të cilat konsiderojmë se me ndihmën e sqarimeve të arsimtarëve të historisë, do të ndihmojnë shumë për kuptimin më të mirë të përmbajtjeve të tekstit shkollor nga ana e nxënësve.

Shpresojmë se libri do t'i përmbushë qëllimet dhe detyrat e parashtruara, të parashikuara në programin mësimor për vitin e parë, ndërsa të gjitha mangësitë e vërejtura do t'i pranojmë me kënaqësi dhe do t'i inkorporojmë në botimin e ardhshëm.

Autorët


TEMA 1

TEMA 1. PARAHISTORIA

NJERIU NË PERIUDHËN MË TË HERSHME KOHË E GURIT DHE E METALIT

KRIJIMI I NJERIUT

Që nga kohërat më të vjetra, njerëzit e kanë parashtruar pyetjen se si dhe kur është krijuar njeriu. Me kalimin e kohës, janë krijuar dy mendime: sipas religjionit dhe sipas shkencës. Për shembull, krishterimi dhe libri i tij fetar Bibla, predikojnë se njeriu është krijuar nga Zoti, i cili e ka bërë njeriun nga balta dhe i ka dhënë shpirt të pavdekshëm.



Çarlls Darwin (1809-1882)

Mandej, që të mos jetë i vetëm dhe që të lë trashëgimtarë, prej brinjëve të burrit e ka krijuar edhe gruan. Në mënyrë të ngjashme e kanë interpretuar krijimin e njeriut edhe predikimet tjera religjioze.

Sipas teorisë shkencore të shkencëtarit anglez Çarlls Darwin, në veprën *Prejardhja e njeriut* i pari ka thënë se njeriu nuk e ka prejardhjen prej ndonjë force madhore por se edhe ai është pjesë e natyrës së gjallë dhe se edhe ai ka paraardhësin e tij të largët - majmunin me fytyrë njeriu dhe i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme nëpër procesin zhvillimor, të evolucionit. Të dhënat më të reja flasin se paraardhësit e drejtpërdrejtë të specieve njerëzore janë paraqitur para katër ose më shumë milionë vitesh. Në kërkim të ushqimit dhe të kushteve më të mira për jetë, me kalimin e kohës, paranjeriu e ka ndryshuar pamjen e tij fizike. Për komunikim të ndërsjellë, njerëzit e parë mendimet i kanë shprehur me gjeste të ndryshme, me mimika dhe pasthirrma. Gradualisht, nën ndikimin e punës dhe mënyrës së jetës, është zhvilluar mendimi dhe vetëdija, ndërsa kjo, ka sjellë deri në paraqitjen e të folurit të njerëzit.

Si është interpretuar krijimi i njeriut në të kaluarën?

TEMA 1

KOHA E GURIT

Periudha më e vjetër e zhvillimit të shoqërisë njerëzore quhet koha e gurit. Koha e gurit ndahet në kohën e vjetër të gurit (paleolit) dhe në kohën e re të gurit (neolit).

Në kohën e vjetër të gurit, njeriu i parë ka qenë i detyruar të jetojë në grupe, të ashtuquajtura hordhi. Hordhitë e para nuk kanë qenë ngushtë të lidhura në mënyrë familjare, e as të organizuara. Në luftën e përhershme për ekzistencën e tyre, njerëzit kanë përfituar përvoja gjithnjë e më të mëdha, kështu që, jenë pjekur kushtet kur janë mësuar që vetë të bëjnë vegla prej guri. Në luftën e mëtutjeshme për jetë, njerëzit e kanë zbuluar dhe kanë filluar ta përdorin zjarrin, që paraqet një arritje të tyre të re. Zbulimi i zjarrit ua ka lehtësuar jetën njerëzve të parë. Ata kanë filluar të vendosen edhe në territoret më të ftohta, për jetesë kanë filluar t'i përdorin edhe shpellat dhe me ndihmën e zjarrit të përgatisin ushqim, që është reflektuar edhe në zhvillimin e tyre evolutiv. Njerëzit kanë filluar të bëjnë edhe veshje nga lëkurat e shtazëve, kanë pasur trup të drejtuar dhe duar të zhvilluara.



Shpellë



Vendbanimi mbi hunj



Vegla prej guri

Në kohën e re të gurit, njerëzit kanë mësuar ta përpunojnë gurin gjatë bërjes së veglave dhe të armëve. Kanë mësuar të bëjnë edhe lundra druri dhe ngjashëm. Atëherë, njerëzit kanë mësuar të ndërtojnë edhe vendbanime. Që të jenë më afër burimeve të ushqimit, vendbanimet e veta i kanë ndërtuar përreth pyjeve, përreth lumenjve dhe liqeneve. Vendbanimet përreth ujërave janë ndërtuar në hunj (vendbanime mbi hunj). Kanë filluar edhe me ndërtimin e kolibeve dhe kasolleve përdhese. Atëherë, njerëzit i kanë zbuluar edhe harkun dhe shigjetën, ndërsa gjahu dhe peshkimi janë bërë profesioni kryesor i njerëzve në kohën e gurit.

Me çka karakterizohet hordhi - bashkësia e parë e njerëzve?

KOHA E METALIT

Pas periudhës afatgjate të kohës së gurit, vijon shkalla e dytë dhe më e lartë e zhvillimit të shoqërisë së parë, dhe kjo është koha e metalit. Njeriu, në fillim e ka zbuluar bakrin, mandej bronzin dhe hekurin. Sipas këtyre metaleve dhe periudhave të caktuara të historisë së njerëzimit, emërohen si: koha e bakrit, e bronzit dhe e hekurit.

Në kohën e metalit, njerëzit kanë filluar me bërjen e enëve të argjilës. Paraqitja e poçerisë, ka luajtur rol të rëndësishëm në jetën e njerëzve, ka mundësuar që njerëzit përveç ushqimit të pjekur të konsumojnë edhe ushqim të zier. Në kohën e metalit, njerëzit kanë filluar t'i zbusin kafshët dhe me vetëdije t'i shumojnë dhe t'i kultivojnë. Ky është fillimi i blegtorisë. Gjithashtu, njerëzit kanë filluar ta përpunojnë tokën me shat, dhe ky është fillimi i bujqësisë.

Me përdorimin e metaleve, individë të caktuar vazhdimisht e kanë përsosur prodhimtarinë dhe i janë përkushtuar në mënyrë profesionale asaj veprimtarie. Kështu, ka filluar paraqitja e zejtarëve të parë profesional dhe e zejtarisë.

Ndarja e punës dhe paraqitja e tepicës së prodhimeve, kanë mundësuar që të paraqitet edhe tregtia?




Gjuetia e elefantëve

TEMA 1

RENDI FISNOR, MATRIARKATI DHE PATRIARKATI.

Në fillim, njerëzit kanë jetuar në grupe të vogla të quajtura hordhi. Më vonë, me zhvillimin e mjeteve për punë, janë paraqitur bashkësi më të mëdha të njerëzve, me lidhje gjaku sipas vijës së nënës. Ato bashkësi më të mëdha janë quajtur gjini. Në krye të gjinisë ka qëndruar eprori i zgjedhur. Në fillim, në krye të gjinisë, si epror, ka qëndruar gruaja, nga shkakku se gjinia kryesisht është varur nga puna e grave. Kjo periudhë e zhvillimit të bashkësisë fisnore quhet matriarkat. Me zbulimin e metaleve dhe me zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe zejtarisë, gradualisht, burri e ka ndërmarrë rolin kryesor në gjini. Kjo periudhë e zhvillimit të bashkësisë fisnore quhet patriarkat.

Në bashkësinë e parë ka ekzistuar pronësi e përbashkët mbi pronën e përgjithshme, kanë punuar bashkërisht dhe të mirat materiale i kanë ndarë në mënyrë të barabartë. Nuk ka ekzistuar pronësia private dhe eksploatimi. Gjinitë që kanë qenë në lidhje gjaku, janë bashkuar në fise, në krye me kryepleqtë e fisit ose këshillit të kryepleqve, të përbërë nga të gjithë kryepleqtë gjinorë.



Shpjegoni dallimet ndërmjet matriarkatit dhe patriarkatit.

PARAQITJA E SHTETIT

Me zhvillimin e prodhimit, ka filluar të shpërbëhet shoqëria gjinore. Tani, njerëzit kanë mundur jo vetëm të jetojnë në mënyrë solide, por edhe të prodhojnë tepricë të prodhimeve. Me tepricën e prodhimeve, është paraqitur nevoja për fuqi të re të punës, të cilën e kanë plotësuar me robër të cilët kanë punuar te kryepleqtë. Familjet e kryepleqve vazhdimisht janë pasuruar dhe janë veçuar nga familjet e tjera të fisit sipas pozitës pronësore. Në këtë mënyrë është paraqitur pabarazia pronësore. Familjet të cilat nuk kanë pasur lidhje gjaku janë organizuar në komuna. Me paraqitjen e pabarazisë pronësore, janë veçuar dy shtresa: të pasur dhe të varfër. Për shkak të frikës nga rebelimi, e që t'i ruajnë pronat e veta, të pasurit kanë organizuar pushtet të organizuar publik, të quajtur shtet në krye me sunduesin. Domethënë, shteti paraqet pushtet të organizuar, përkatësisht aparat politik i cili gjendet në duart e të pasurve.

Si është krijuar shteti?

NEVOJAT SHPIRTËRORE DHE KULTURORE TË NJERËZVE NË BASHKËSITË E HERSHME*totem***BESIMET MË TË VJETRA
TE NJERËZIT E PARË**

Gjatë gërmimit të lagjeve, përkatësisht vendbanimeve të njerëzve të parë, arkeologët kanë zbuluar një numër të madh sendesh, të cilat kanë qenë të ndërlidhura me pasqyrimet e tyre për jetën, për botën, përkatësisht për besimet e tyre. Para së gjithash, ato kanë qenë figura të vizatuara në muret e shpellave, më së shumti të shtazëve të egra, mandej të zogjve, si edhe figura të punuara nga guri, nga kocka, madje edhe nga materiale tjera.

Çdo gjë që ka ndodhur rreth tyre, njerëzit e parë e kanë shpjeguar me veprimin e ndonjë fuqie mbinatyrore. Së këndejmi, tek ata, ndërsa sot edhe te disa bashkësi të prapambetura njerëzore, janë përhapur besime më të ndryshme. Një nga besimet më të përhapura te njerëzit e parë është ai se ata kanë menduar që te njerëzit, te shtazët, te bimët, te sendet, në qiell, në tokë e gjithamdejt është e pranishme fryma - shpirti.

Posaçërisht ka qenë i përhapur kulti ndaj shtazëve, ndaj zogjve. Në fakt, njerëzit e parë kanë besuar se prejardhjen e kanë nga ndonjë shtazë dhe se ekzistimi i tyre, veçanërisht suksesi ose mossuksesi në gjah dhe ngjashëm varet nga ajo shtazë. Besimi i atillë në shtazë quhet - totemizëm. Përveç kultit ndaj shtazëve, te disa bashkësi të njeriut të parë, është zhvilluar edhe kulti ndaj kafkës. Kjo konkludohet nga besimet se pas vdekjes, shpirti e braktis trupin dhe qëndron afër vendit ku është varrosur njeriu, përkatësisht ku i ndjeri ka jetuar më parë. Së këndejmi, edhe të vdekurit ose vetëm kafkat e tyre, i kanë varrosur afër vendit të vendbanimit.

Në lidhje të ngushtë me këtë besim të përhapur te bashkësitë gjinore, ka qenë shumë i zhvilluar edhe kulti ndaj të parëve. Përkatësisht, njerëzit e gjinisë, e kanë respektuar shpirtin e paraardhësit të tyre, prej të cilit kanë konsideruar se e kanë prejardhjen dhe i cili është i pranishëm ndërmjet

TEMA 1

tyre edhe pas vdekjes. Ata kanë menduar se ai edhe më tutje i mbron nga e keqja dhe nga fatkeqësitë dhe kujdeset për ta edhe pas vdekjes.

Paraardhësit tanë të largët, më së shumti e kanë respektuar perëndeshën - nënë, të cilën e kanë konsideruar si prind-zanafillë e botës së gjallë në tokë. Ata kanë punuar figura të shumta dhe statuja të perëndeshës - nënë, duke besuar se në të është vendosur shpirti i paraardhësit dhe se i mbron.

Ndiqe zhvillimin e besimeve religjioze në bashkësinë e parë.



Figura e perëndeshës - nënë nga Maxhari (i Shkupit)



Vizatime në shpellë

ARTEFAKTET MATERIALE

Paraardhësit e tanë të largët, duke filluar prej kohës më të vjetër të gurit, kanë qenë shumë të shkathët në vizatim. Pikturat dhe vizatimet e tyre janë zbuluar nëpër muret e disa shpellave, siç janë Llasko në Francë, Alltamira në Spanjë dhe në vende të tjera. Ato janë më së shpeshti dema, të cilët i kanë vizatuar mjeshtrit e vjetër të gurit. Ca prej tyre janë edhe me ngjyra. Përveç demave, janë zbuluar edhe vizatime të bizonëve, të mamutëve, të drerëve dhe të shtazëve të tjera, me prezantimin e skenave të gjahut.

Në to janë paraqitur skena gjahu, bile edhe lojëra magjike, nëpërmjet të cilave, njerëzit e atëhershëm - gjahtarët e kanë shprehur dëshirën e vet për gjuh të suksesshëm ose lumturinë nga gjahu. Këtu shihen besimet më të vjetra të njerëzit e parë, në lidhje me admirimin ndaj shtazëve - totemizmin.

Gjurma të pikturimit gjejmë edhe në kohën më të re të gurit. Njerëzit, posaçërisht i kanë zbuluar me vizatime edhe veglat e tyre, veçanërisht ato që kanë qenë të punuara nga



Bizon i plagosur

kocka. Me paraqitjen e poçerisë, vizatimet janë bartur edhe në enët e argjilës. Gjurmët e vijave të thjeshta gjeometrike i kanë stolitur edhe ato sende.

Gjithashtu, janë zbuluar edhe figura të skalitura nga dora e njeriut paleolit dhe njeriut neolit. Ato janë figura të shtazëve që e kanë rrethuar njeriun, ose figura të kokave, bile edhe figura të tëra të vogla të grave, të skalitura nga steatiti (gur i butë), ose nga argjila. Punët e skalitjes të njeriut të parë i shohim edhe në figurat e shumta që i paraqesin idhujt e tyre të ndryshëm.

Përveç asaj që veprat më të vjetra artistike janë në lidhje të ngushtë me pasqyrimet primitive për natyrën dhe për jetën dhe na mundësojnë t'i shpjegojmë besimet më të vjetra fetare, përsëri, ato zbulime janë dëshmi për fillimet e para të krijimtarisë artistike, me të cilën njeriu nuk pushon së krijuari që nga fillimi i ekzistimit. Nëpërmjet saj, ai i shpreh botëkuptimet e veta, shijen e vet, dëshirën dhe ndjenjat ndaj së bukurës dhe fisnikes.

Si e shpjegon paraqitjen e artit të njerëzit e lashtë?

Hulumto dhe mëso! Çka shënon figura e perëndeshës - nënë nga Maxhari (i Shkupit)

**TEMA 2.
KOHA E LASHTË**

CIVILIZIMET MË TË HERSHME TË LINDJES SË LASHTË

KUSHTET NATYRORE DHE POPULLSIA

Territoret më të lashta në botë ku para rreth 6 000 vjetësh kanë lindur shtetet e para kanë qenë luginat pjellore të lumenjve të mëdhenj: të Nilit në Egjipt, të Tigrit dhe Eufratit në Mesopotami, të Indit dhe Gangës në Indi, si edhe Lumi i Verdhë dhe i Kaltër në Kinë. Pjelloria e këtyre luginave buronte kryesisht nga vërshimet e rregullta që i shkaktonin lumenjtë në periudha të caktuara të vitit. Vërshimet e lumenjve e bënë truallin edhe më pjellor, por njëkohësisht, ato u shkaktonin njerëzve edhe dëm. Me qëllim që të mbrohen nga stuhitë e ujit, njerëzit kanë ndërtuar diga, penda, kanale dhe sisteme për ujitje.

Ndërtimi i objekteve të këtyra të mëdha, mirëmbajtja e tyre si edhe përpunimi i tokës me veglat e atëhershme primitive për punë, ka kërkuar përdorim të fuqisë masovike të punës. Së këndejmi, në këto luginat ka ardhur deri në grupimin e shpejtë të fiseve. Gjithnjë e më shpesh janë zhvilluar lufta të ndërsjella për grabitjen e tokës më pjellore dhe të kanaleve dhe digave të ndërtuara. Kjo e ka përshpejtuar procesin e shpërbërjes së bashkësive fisnore, kështu që ka ardhur deri në formimin e shteteve të para.

Ku janë paraqitur civilizimet e para?



Lindja e Lashtë

FORMIMI I SHTETEVE TË PARA

Shtetet më të vjetra në Lindjen e Lashtë kanë qenë të vogla dhe zakonisht kanë përfshirë një qytet me rrethinën më të gjerë, andej janë emëruar qytete-shtete. Me bashkimin e më shumë shteteve të vogla, janë formuar shtete më të mëdha. Në krye të shtetit ka qëndruar sunduesi i cili ka pasur të drejta të pakufizuara dhe ka qenë zoti suprem i tokës dhe i njerëzve. Sunduesi ka jetuar në shtëpi të bukur luksoze me fron të stolisur në mënyrë luksoze. Në drejtimin e shtetit, sunduesit i kanë ndihmuar priftërinjtë, nëpunësit, gjykatësit dhe ngjashëm. Në shtetet e vjetra lindore, popullsia është ndarë në tre shtresa: të pasur, të varfër dhe robër. Në luftërat e shpeshta që i ka bërë kundër fiseve dhe popujve tjerë, sunduesi ka përfituar shumë robër, të cilët kanë qenë të obliguar të punojnë në pronën e sunduesit dhe në tempullin.

Si ka qenë i organizuar pushteti i shteteve më të vjetra?

CIVILIZIMET MË TË LASHTA NË INDI DHE NË KINË

Banorët më të vjetër të njohur të Indisë kanë qenë Dravidët, të cilët kryesisht janë marrë me bujqësi. Në mijëvjeçarin II para e.s., ata qenë pushtuar nga fiset nomade me prejardhje indoevropiane Arianët, të cilët kanë hyrë nga veriperëndimi, në krye me udhëheqësit e tyre fisnor-raxhat. Në krye të më shumë shteteve të vogla kanë qenë Maharaxhat. Përsosja e prodhimtarisë ka mundësuar paraqitje të hershme të robërisë, kështu që shfrytëzimi i punës së papaguar të robërve e ka përshpejtuar procesin e shtresimit pronësor të popullsisë, e cila ka jetuar në vendbanime fshatare dhe qytetare. Ndër qytetet më të vjetra, më të njohura kanë qenë Harapa dhe Mahenxho-Daro. Artefaktet arkeologjike të këtyre qyteteve vërtetojnë se në Indi ndërtimtaria ka qenë posaçërisht e zhvilluar. Atje ka lulëzuar zejtaria, ndërsa fushat kanë qenë të prera me sisteme të ujitjes nga digat, kanalet dhe pendat. Nëpër fushat kanë kultivuar bimë të ndryshme drithore, kallam sheqeri dhe pambuk. Prej shtazëve shtëpiake, më së shumti e kanë mbarështuar lopën të cilën e kanë konsideruar për shtazë të shenjtë.

Në Kinën e Lashtë, përgjatë rrjedhës së lumenjve të mëdhenj, janë krijuar qytete e vogla të para-shtete, dhe me bashkimin e tyre, rreth 2.200 vite para e.s. është formuar



Qyteti Mahenxho-Daro rikonstruktimi

shteti unik kinez. Sunduesit e parë kanë qenë të dinastisë Hsia, në kohën e së cilës ka lindur shkrimi kinez ideograf. Rreth vitit 1 750 para e.s. fronti sundues ka kaluar mbi dinastinë Shang në lumin Ho-anho. Sunduesi i parë i kësaj dinastie Tang, e ka përforcuar pushtetin e vet deri në atë masë që e kanë konsideruar si perandor.

Si dukeshin Qytetet më të vjetra në Indi?

CIVILIZIMET E PARA NË MESOPOTAMI

Një nga civilizimet më të vjetra në botë ka lindur në luginën e gjerë kënetore të Mesopotamisë, në derdhjen e poshtme të lumenjve Eufrat dhe Tigër. Banorët më të vjetër të atij territori kanë qenë Sumerët dhe Akadët, të cilët kanë formuar numër më të madh të qyteteve-shtete të cilët shpesh kanë luftuar ndërmjet veti për të mbisunduar. Rreth 2 400 vjet para e.s. mbreti Akad Sargon I i ka pushtuar territoret sumere dhe e ka bashkuar tërë Mesopotaminë. Për dallim nga Sumerët, në qytetet Akade ka ardhur deri në zhvillimin e përsheptuar të zejtarisë dhe të tregtisë, qenë ndërtuar edhe qytete të reja, pallate të pasura dhe tempuj, ndërsa me kanale dhe sisteme ujitjesh i ndërlidhën edhe lumenjtë Tigër dhe Eufrat. Sumerët dhe Akadët kanë lënë gjurmë të thella në historinë e njerëzimit dhe kanë lënë në trashëgimi përfitime shumë të rëndësishme. Kanë ditur t'i përpunojnë metalet dhe kanë

pasur tregti të zhvilluar. Kanë pasur edhe shkrim formë pykash dhe i përfitonin njohuritë e para nga astronomia. Pas vdekjes së mbretit Naram-Sin, populli malësor Guti ka ndërhyrë në Mesopotami dhe e ka ndërmarrë mbretërinë Akade.

Së shpejti, si qendër e mbretërisë së porsaformuar të Babilonisë, bëhet qyteti Babiloni, në lumin Eufrat. Sunduesit e Babilonisë vazhdimisht kanë bërë luftë për mbisundim në Mesopotami, dhe pas një shekulli, mbreti Hamurabi (1792-1750) pati sukses ta bashkojë tërë Mesopotaminë. Gjatë sundimit të tij shumëvjeçar, ai ka bërë reforma të rëndësishme sociale ndërsa për rregullimin juridik të marrëdhënieve në shtet, ka nxjerrë edhe kod të veçantë të rregullave ligjore, i njohur si Kodi i Hamurabit. Sipas kodit, mbreti ka qenë zoti suprem i tokës, nga shfrytëzimi i së cilës e ka grumbulluar tatimin nëpërmjet



Sunduesi i madh i Babilonisë Hamurabi

TEMA 2

pronarëve të mëdhenj të tokave, ndërsa prona të mëdha kanë pasur edhe qytetet. Pas vdekjes së Hamurabit, vendi ka rënë nën pushtetin e Hetëve dhe Kasitëve.

Zbulo dhe mëso! A ka vlejtur Kodi i Hamurabit në mënyrë të barabartë për të gjitha shtresat në shtet?

Gjatë historisë së mëvonshme, Mesopotamia ka rënë nën pushtetin e Asirianëve, të cilët atje kanë formuar shtetin e vet - Mbretërinë Asiriane, me kryeqytetin në qytetin Niniva. Mbretërit asirianë kanë ndërmarrë punë të mëdha publike-sisteme të mëdha të ujitjes, pallate dhe tempuj. Gjatë shekullit VIII para e.s., mbreti Sargon II e ka pushtuar Izraelin dhe shtetin Urartu. Kryeqyteti i Asirisë Niniva, ka qenë me emër të dëgjuar larg. Gjatë sundimit të mbretit asirian Asurbanipal (shekulli VII para e.s.), vendi ka filluar rënien.



Niniva (mbetjet)

Këtë e kanë shfrytëzuar Megjanët, fqinjët nga Irani, të cilët në vitin 612 para e.s. e kanë pushtuar kryeqytetin Niniva, ndërsa shtatë vite më vonë e kanë ndërmarrë tërë Mbretërinë Asiriane.

Përpiloni projekt: Civilizimet më të vjetra në Lindjen e Lashtë



Kopshtet ngjitëse në Babilon

EGJIPTI I LASHTË

KUSHTET NATYRORE DHE POPULLSIA

Egjipti gjendet në pjesën verilindore të Afrikës, në rrjedhën e poshtme të lumit Nil, që derdhet në Detin e Mesdheut. Atje, rrallë ka rënë shi, ndërsa në rrjedhën e sipërme të lumit Nil kanë rënë shira tropikë. Atëherë (në korrik), shtrati i lumit nuk ka mundur ta mbledhë ujin dhe ai është derdhur dhe e ka vërshuar luginën. Pas tre muajsh, uji kthehej në shtratin e vet duke lënë nëpër ara shtresë të trashë të llumit pjellor. Menjëherë pas kësaj, egjiptianët fillonin me punimin e tokës. Ajo ka qenë aq pjellore sa që ka mundur të japë edhe tre të korra në vit. Për mbrojtje nga vërshimet dhe për ujitjen e tokës gjatë muajve të thatësirës, Egjiptianët kanë ndërtuar diga, kanale dhe liqene artificiale.

Egjipti ka qenë i banuar që nga kohërat më të lashta, duke kaluar nëpër të gjitha etapat zhvillimore të shoqërisë fisnore, deri në përdorimin e metaleve. Përveç bujqësisë së zhvilluar, egjiptianët kanë pasur edhe zejтари dhe tregti.

Si kanë qenë kushtet e natyrës në Egjipt?



Egjipti

FORMIMI I SHTETEVE DHE BASHKIMI I TYRE

Njerëzit e parë në Egjipt kanë jetuar në gjini, por më vonë, për shkak të paraqitjes së pronës private, edhe tek ata është zhvilluar procesi i shpërbërjes së gjinive të familjeve. Për kryerjen e punëve të mëdha të ujitjes, ka pasur nevojë për më shumë njerëz. Për këtë arsye, familje të caktuara që kanë jetuar në territor të njëjtë, kanë filluar të bashkohen në bashkësi territoriale më të mëdha - komuna, ndërsa komunat në noma (qarqe). Me kalimin e kohës, nomat janë shndërruar në shtete të vogla të cilat gradualisht kanë filluar të luftojnë ndërmjet veti për fitimin e tokës dhe fuqisë së punës pa pagesë - të robërve. Në krye të nomave ka qëndruar nomarku. Ai ka qenë komandanti ushtarak suprem, prifti dhe gjykatësi. Pas një kohe të gjatë, në Egjipt janë formuar dy shtete: Egjipti i Sipërm - në rrjedhën e mesme të lumit Nil dhe Egjipti i Poshtëm - rreth grykës së lumit Nil.

Edhe këto dy shtete vazhdimisht kanë luftuar ndërmjet veti për mbisundim dhe për bashkim në një shtet. Rreth 3 200 vite para e.s. sunduesi i Egjiptit të Sipërm, Menesit i shkon për dore t'i bashkojë të dy shtetet në një shtet. Kryeqyteti i Egjiptit të bashkuar është bërë Memfisi, afër qytetit të sotëm të Kajros. Në periudhën më të vonshme, kryeqyteti i shtetit egjiptian është bërë qyteti Teba.



Piramidat në Gizë

Si erdhi deri në formimin e shtetit të vjetër egjiptian?

RREGULLIMI SHTETËROR DHE SHOQËROR

Shteti Egjiptian ka qenë monarki e centralizuar skllavopronare. Në krye të shtetit ka qëndruar sundues i trashëguar, i quajtur faraon. Faraoni ka qenë zoti i pakufizuar, absolut i shtetit. Egjiptianët kanë besuar se faraoni është biri i perëndisë së diellit Ra. I gjithë vendi, së bashku me popullin janë llogaritur si pronë e faraonit. Në udhëheqjen me vendin, atij i kanë shërbyer numër i madh i nëpunësve dhe priftërinjve.

Populli në shtetin egjiptian është ndarë në njerëz të lirë dhe jo të lirë. Popullsia e lirë është përbërë prej: aristokratëve ushtarakë, klerit fetar, nëpunësve, tregtarëve, zejtarëve dhe fshatarëve. Popullsia jo e lirë kanë qenë robërit. Pozita e robërve ka qenë shumë e vështirë. Ata kanë qenë të shfrytëzuar për punët fizike më të rënda dhe më të vrazhda. Edhe pse ka pasur shumë robër, përsëri, numri i tyre ka qenë më i vogël se numri i popullsisë së lirë.

Si ka qenë rregullimi shoqëror dhe shtetëror në Egjipt?

FUSHATAT USHTARAKE TË FARAONËVE NË KOHËN E MBRETËRISË SË LASHTË DHE TË MESME

Shteti i lashtë egjiptian ka zgjatur pothuajse 3 000 vjet. Gjatë kësaj kohe, kanë sunduar 31 dinasti faraonësh. Historia e tij ndahet në tri periudha të mëdha: Mbretëria e Vjetër, Mbretëria e Mesme dhe Mbretëria e Re. Ekziston edhe periudha e të ashtuquajturës Mbretëri e Vonshme Egjiptiane.

Gjatë Mbretërisë së Vjetër (3100-2160 para e.s.), shteti egjiptian ka bërë luftëra pushtuese. Në atë periudhë, faraonët Snofru dhe Keops i kanë pushtuar territoret e Etiopisë dhe të Nubisë, të cilat kanë qenë të pasura me flori. Fushata të karakterit të këtyllë janë ndërmarrë edhe ndaj Libisë, Fenikisë dhe Gadishullit të Sinajit, prej ku e kanë bartur bakrin.

Mirëpo, nga mesi i mileniumit III para e.s., fillon periudha e dobësimit të pushtetit të faraonit. Arsyeja qëndron në përforcimin e nomarsëve, të cilët veç më po ndaheshin nga pushteti qendror. Kjo ka sjellë deri në shpërbërjen e Mbretërisë së Vjetër. Por, kjo i ka shkaktuar dëm të madh sistemit të ujitjes në Egjipt. Në shtet ka ardhur deri tek luftërat e ndërsjella grabitëse.

Për shkak të pozitës së këtyllë, ka lindur synimi për bashkimin e Egjiptit, me çka do të riparoheshin kanalet dhe digat e dëmtuara dhe të lëna pas dore. Pas këmbënguljeve dhe përpjekjeve afatgjata, nomarsët e bashkuar të jugut, rreth qytetit të Tebës e kanë bashkuar përsëri Egjiptin. Kështu, në kohën e Mbretërisë së Mesme, Teba është shndërruar në qendër të Egjiptit.

Edhe pse Egjipti ka qenë i mbrojtur në mënyrë natyrore nga bastisjet e fiseve nomade të tjera, përsëri rreth vitit 1710 para e.s., nga verilindja kanë ndërhyrë fiset endacake Hiksa. Para kësaj, ata e kanë pushtuar Sirinë dhe Palestinën, ndërsa në pjesën veriore të Egjiptit kanë sunduar më shumë se 150 vite.

Pse është shpërbërë mbretëria e Vjetër?



TEMA 2

MBRETËRIA E RE

Prej Egjiptit jugor, në krye me faraonët e Tebës, ka filluar lëvizja për çlirimin nga Hiksët. Pas betejave të gjata, çlirimi dhe bashkimi ka përfunduar në vitin 1570 para e.s. Falë zhvillimit të zejeve, si dhe luftës me Hiksët, faraonët egjiptianë të Mbretërisë së Re kanë pasur sukses të formojnë ushtri të fuqishme, me teknikë ushtarake më të avancuar. Me ushtrinë e atillë, faraonët kanë ndërmarrë fushata ushtarake përgjatë bregut lindor të Detit Mesdhe, në Palestinë dhe në Siri. Një prej tyre ka qenë Tutmes III, i cili ka pasur sukses ta zgjerojë shtetin egjiptian deri në lumin Euftrat. Gjithashtu, edhe faraoni Ramzes II ka luftuar në Siri, por atje ka pësuar disfatë nga Hetët.

Fushatat pushtuese dhe kryengritjet e të varfërve dhe robërve e kanë dobësuar shtetin. Ai i ka humbur territoret e pushtuara në Siri dhe në Palestinë. Në vitin 671 para e.s., Asirianët e kanë sulmuar Egjiptin, i cili ka qenë i detyruar të pranojë pushtetin e tyre. Pas çlirimit nga pushteti asirian, Egjipti përfundimisht ka qenë i nënshtuar nga Mbretëria Persiane në vitin 525 para e.s. Pas rënies së Persisë nën pushtetin e Aleksandërit të Madh, edhe Egjipti është bërë pjesë e asaj mbretërie në vitin 332 para e.s.

Bëni projekt: Egjipti i Lashtë



Tutmes III



Ramzes II

ARRITJET KULTURORE DHE SHKENCORE TË POPUJVE TË LINDJES SË LASHTË

RELIGJIONI

Me krijimin e shteteve të para tek popujt e lashtë lindor, është formuar edhe religjioni zyrtar, dhe me këtë është formuar edhe kleri, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm ekonomik dhe politik në shtetet lindore.

Në Egjiptin e Lashtë, për një kohë të gjatë janë ruajtur edhe mbeturinat e magjisë, të animizmit dhe totemizmit. Në çdo nomë ka ekzistuar perëndi lokale, dhe ndonjëherë edhe më shumë perëndi. Përveç perëndive lokale, kanë ekzistuar edhe perëndi gjithëgjyptiane, ndërmjet të cilëve kanë qenë: Amon-Ra perëndia e diellit, Ozirisi dhe gruaja e tij Izida - perëndi të bimësisë dhe të pjellorisë, Gori - perëndia e të vdekurve, Pta - krijuesi i botës dhe të tjerë. Rol të madh në religjionin egjiptian ka pasur kulti ndaj faraonit, i cili është llogaritur si bir i perëndisë Amon-Ra. Egjiptianët e vjetër kanë besuar se pas vdekjes, shpirti kthehet përsëri në trup. Për këtë arsye, që ta mbrojnë trupin nga shpërbërja, e kanë balsamuar dhe e kanë varrosur në varreza madhështore - piramida.

Te popujt e Mesopotamisë, besimet kanë qenë të ngjashme me ato të Egjiptianëve. Perënditë më të njohura te Sumerët kanë qenë: Anu - perëndia e qiellit, Shamash - perëndia e diellit, Sin - perëndia e hënës, Perëndia supreme në shtetin e Babilonisë ka qenë Marduk, si edhe Ishtar - perëndesha e bimësisë dhe e pjellorisë.

Hebrenjtë e vjetër kanë qenë monoteist dhe kanë besuar në një perëndi, në perëndinë Jahve (Jehova). Mësimi fetar hebraik është shënuar në Librin e Shenjtë, Dhiatën e Vjetër ose Biblën që më vonë ka ndikuar në mësimin krishterë.

Në shekullin VI para e.s., ka ardhur deri te një lëvizje në Indi, e cila ka qenë e shkaktuar nga mësimi i Budës, që e paraqet lindjen e religjionit të parë që quhet budizëm. Buda, ka mësuar se të gjithë njerëzit janë të barabartë, pa dallim cilës kastë i takojnë. Budizmi është përhapur në më shumë vende në Lindjen e Largët në Indi, në Kinë, në Mongoli, në Japoni dhe në vende të tjera.


Pse egjiptianët i kanë balsamuar trupat e të vdekurve?



Perëndia Amon Ra

ZANAFILLA E SHKRIM-LEXIMIT

Te popujt e lashtë lindor, para shumë kohe, rreth 4 000 vitesh para e.s. ka lindur shkrimi. Shkrimi i egjiptianëve të vjetër quhet shkrim hieroglif. Hieroglifët paraqesin shenja, vizatime dhe piktura të ndryshme, prandaj edhe quhet shkrim idegrafik. Çdo shenjë paraqet një fjalë ose një rrokje. Me kalimin e kohës, shkrimi egjiptian është thjeshtëzuar, kështu që atëherë, janë paraqitur edhe shenja që shënojnë shkronja. Shkrimi egjiptian ka pasur rreth 700 shenjash, prandaj shumë vështirë ka mundur të mësohet. Egjiptianët, për shkak se nuk kanë ditur për letrën, kanë shkruar në papirus. Hieroglifët egjiptianë i ka deshifruar në vitin 1822 shkencëtari francez Champolion.



Shkrimi kuneiform

Në Mesopotami është formuar shkrimi kuneiform që e kanë zbuluar sumerët. Këtë emër e ka fituar për shkak se forma e shenjave të tij i përngjan pykës. Në Mesopotami, nuk ka pasur papirus si në Egjipt, prandaj është shkruar me shklopth të mprehët në pllaka të freskëta argjilore. Çdo shenjë ka përfaqësuar një fjalë ose një rrokje. Ka pasur rreth 500 shenja.

Të parët nga popujt e vjetër lindorë, të cilët kanë krijuar alfabet fonetik kanë qenë Fenikasit. Shkrimi i tyre fonetik (alfabeti), përbëhej prej 22 shkronjave. Për çdo tingull kanë pasur shenjë të caktuar (shkronjë). Sipas shembullit të alfabetit fenikas është përpiluar edhe alfabeti grek ndërsa nga alfabeti grek janë krijuar të gjitha alfabetet e mëvonshëm evropiane.

Cilat lloje të shkrimeve kanë ekzistuar te popujt e lashtë lindorë?



Shkrimi hieroglif

SHKENCA

Te popujt e lashtë lindorë, janë zhvilluar dhe më shumë disiplina shkencore. Te ato, për nevoja praktike, për shkak të rimatjeve të shpeshta të tokës, të kanaleve dhe të digave, që kanë qenë të detyruar ta bëjnë pas çdo vërshimi, është zhvilluar matematika dhe gjeometria. Ndërsa, në lidhje me zhvillimin e bujqësisë, e si rezultat i mbikëqyrjes shumëshekullore të trupave qiellorë, me qëllim që të parashikohen vërshimet ose thatësira, tek ata është zhvilluar edhe astronomia. Në bazë të hulumtimeve astronomike, është përpiluar edhe kalendari vjetor, që i përngjan shumë atij të sotmit. Te popujt lindorë janë paraqitur edhe kimia dhe medicina, e në lidhje me balsamimin, egjiptianët janë bërë njohës të mëdhenj të anatomisë.

Me paraqitjen dhe me zhvillimin e shkrimit te këto civilizime të vjetra, vërehen edhe gjinitë e para letrare - vjershat, tregimet, përrallat dhe veçanërisht epi. Një nga epet më të vjetra është epi sumer për trimin Gilgamesh. Në ep, kryesisht theksohet varësia e njeriut nga forcat madhore - perënditë dhe nga fati, të cilin askush nuk ka mundur ta evitojë. Letërsi të pasur kanë pasur edhe hindusët. Epet më të njohur hinduse janë Mahabharata dhe Ramajana, në të cilat lavdërohen perënditë, trimat dhe udhëheqësit ushtarakë, ndërsa përmbajnë edhe mjaft fjalë të urta dhe mendime.

Cilat degë të shkencës janë zhvilluar te popujt e lashtë lindorë?



Kulla e Babilonisë

ARKITEKTURA DHE ARTI

Te popujt e vjetër lindorë janë zhvilluar edhe degët e caktuara të artit, si për shembull, piktura, skulptura, arkitektura etj. Gjithandej janë bërë ndërtime për nder të perëndive dhe të mbretërve. Në Egjipt janë ndërtuar pallate të mëdha, tempuj dhe piramida - varreza prej guri, të cilat në brendinë kanë qenë të stolitura me piktura dhe mbishkrime. Ndërmjet 70 piramidave të ruajtura, më e madhja është ajo e faraonit Keops. Ajo është e lartë 146 metra ndërsa çdo anë e saj në bazë është e gjatë nga 230 metra. Afër piramidës së Keopsit, gjendet statuja voluminoze e quajtur sfinks, e skalitur në gurë. Sfinksit paraqet luan me kokë njeriu, i cili rri shtrirë me këmbë të shtrira. Besohej se ajo i ruan piramidat. Është e lartë 20 metra ndërsa e gjatë 72 metra.

Në Mesopotami, për arsye se nuk ka pasur gurë, është ndërtuar me tulla të pjekura. Tempujt i kanë ndërtuar në formë të piramidës katrore, zakonisht nga shtatë kate dhe kanë qenë të larta sa piramidat egjiptiane. Ndërtesa më e njohur dhe më e lartë ka qenë kulla shtatëkatëshe në Babiloni, e lartë 90 metra.

Hulumto dhe mëso! Si është ndërtuar Piramida e Keopsit?



Piramida e Keopsit

HELADA E LASHTË

KUSHTET NATYORE

Helada e Lashtë është shtrirë në pjesën jugore të Gadishullit Ballkanik, ishujt në Detin Mesdhe dhe bregdetin e Azisë së Vogël. Pjesa kontinentale e Heladës është më shumë vend malor. Masivët malorë e kanë ndarë Heladën në tre pjesë: Helada Veriore, e Mesme dhe Jugore. Në Heladën Veriore, krahinat më të mëdha kanë qenë: Epiri, në perëndim dhe Thesalia në lindje. Në Heladën e Mesme, krahinat më të njohura kanë qenë: Atika dhe Beotia. Në Heladën Jugore, në Gadishullin Peloponez, krahina më e rëndësishme ka qenë Llakona.

Në Detin Egje, ishujt më të njohur në historinë helene janë: Evbeja dhe Egina, në brigjet e Heladës evropiane, mandej, Hios, Lezbos, Samos dhe Rodos përreth brigjeve të Azisë së Vogël dhe ishujt Itaka, Leukas dhe Korfu, në bregun perëndimor si edhe Kreta në Heladën Jugore.

Përshkruaji kushtet natyrore në Heladën e Lashtë.



Harta për popullimin e fiseve helene

POPULLSIA

Territori i Heladës së Lashtë ka qenë i banuar që nga kohërat e vjetra. Sipas historianit helen Tukidit, banorët më të vjetër të Heladës kanë qenë Pellazgët, Korijanët dhe Lelegët. Civilizimi i tyre ka ekzistuar në Heladë para ardhjes së fiseve helene, ndërsa në histori është e njohur me emrin kultura kreto-mikenase. Kështu është emëruar sipas vendeve ku janë gjetur më së shumti artefakte nga ajo kohë. Ajo kulturë ka ekzistuar në kohën prej vitit 3 000 deri në vitin 1 400 para e.s. kurse përputhet me periudhën kur kanë ekzistuar edhe kulturat lindore.

Fiset helene kanë filluar të vendosen në Heladën e vjetër në mileniumin e dytë para e.s. Fillimisht, në pjesët veriore të Heladës janë vendosur Akajët, të cilët gradualisht kanë depërtuar kah pjesa jugore e Heladës - Peloponezi. Rreth vitit 1 200 para e.s. në Heladë kanë arritur edhe fiset helene të Jonëve, Dorëve dhe Eolëve. Ata, gradualisht e kanë banuar tërë Heladën me ishujt dhe me bregdetin e Azisë së Vogël. Me atë rast, tërësisht e kanë nënshtruar popullsinë e vjetër vendëse, e kanë asgjësuar ose asimiluar.

Përshkruaje procesin e popullimit të fiseve helene në Heladë.



Mikena

KRIJIMI I SHTETEVE (POLISEVE) TE HELENËT E LASHTË

Në Heladën e lashtë nuk është formuar shtet unik si në Lindjen e Lashtë por, janë formuar më shumë shtete të vogla (polise), të cilat kanë qenë të pavarura njëra nga tjetra.

Poliset helene kanë qenë të vogla. Ato e kanë përfshirë territorin e një qyteti me rrethinën më të afërme, andaj janë emëruar qytet-shtet (polis). Në krye të tyre ka qëndruar mbreti, të cilin Helenët e kanë quajtur bazileus. Mbreti, njëkohësisht ka qenë komandant i ushtrisë, gjykatës dhe kleriku i parë. Për të gjitha çështjet e rëndësishme, ai ka qenë i obliguar që të këshillohet me këshillin e kryepreqve, i përbërë prej anëtarëve të familjeve aristokrate, dhe me kuvendin popullor, i cili është përbërë prej të gjithë burrave të moshuar nga qytetarët e lirë. Poliset helene më të mëdha dhe më të njohura kanë qenë: Sparta, Athina dhe Teba. Poliset kanë ekzistuar si shtete të veçanta, shpesh kanë luftuar ndërmjet veti dhe sipas nevojës, janë bashkuar në aleanca.



Harta e poliseve helene

Si kanë qenë të organizuara shtetet e vogla helene (poliset)?

SPARTA

Shteti i Spartës është krijuar në shekullin VIII para e.s. në territorin pjellor të Llakonisë, në pjesën jugore të Peloponezitet. Qytetin e kanë themeluar Dorët, pasi që paraprakisht i kanë nënshtruar Akajët.

Popullsia e Spartës ka qenë e ndarë në të lirë (spartiatë dhe periecë) dhe jo të lirë (helotë). Pronarë dhe udhëheqës kanë qenë spartiatët të cilët janë marrë me shërbim ushtarak. Periecët, kanë qenë vendës të vjetër të cilët kryesisht janë marrë me bujqësi ndërsa më vonë edhe me zejtarë dhe me tregti. Edhe pse kanë qenë të lirë, ata nuk kanë pasur status të qytetarëve, përkatësisht nuk kanë pasur të drejta politike. Helotët, kanë qenë në pozitën e robërve shtetërorë. Ata nuk kanë pasur asnjë të drejtë dhe i kanë kryer punët më të rënda fizike.

Në krye të shtetit ka pasur dy mbretër. Pushteti i tyre ka qenë i pakufizuar vetëm në kohë lufte, kur njëkohësisht kanë qenë edhe komandantë të ushtrisë. Përndryshe, organi më i lartë i pushtetit në shtet ka qenë Këshilli i Kryepreqve (geruzia), që është përbërë prej dy mbretërve dhe 28 Spartiatëve më të moshuar se 60 vjeç. Këshilli ka shpallur lufta, ka lidhur

TEMA 2

paqe, ka përpiluar ligje dhe ngjashëm. Ka ekzistuar edhe Kuvendi Popullor i përbërë nga të gjithë Spartiatët më të moshuar se 30 vjeç. Pushteti kontrollues në shtet ka qenë në duart e pesë eforave (eforat). Sipas rregullimit të vet shoqëror dhe shtetëror, Sparta ka qenë monarki aristokrate skllavopronare.

Spartanët i kanë kushtuar kujdes të veçantë edukimit, qëllimi kryesor i të cilit ka qenë që për Spartën të sigurojnë ushtarë të shëndoshë dhe të fuqishëm. Pas vitit të shtatë, kujdesin për fëmijët e ndërmerrte shteti me mësues shtetërorë. Edukimi, kryesisht përbëhej nga ushtrimet fizike. Mësoheshin në disiplinat më të rrepta dhe mundime të llojllojshme, kryesisht ecnin zbathur, me veshje të lehtë, ndërsa në dimër laheshin me ujë të ftohtë. Fëmijët meshkuj janë shkolluar 10 vjet, prej moshës 7 deri 17 vjeçe, mandej e fitonin armën e vet dhe sistemoheshin nëpër shoqëri të quajtura sistia. Për edukatën e fëmijëve femra, kanë ekzistuar gjimnaze të veçanta ku kanë mësuar ushtrime gjimnastikore, muzikë dhe këndim. Falë edukatës së këtyllë, Spartanët janë bërë ushtarë të guximshëm, të disiplinuar dhe të durueshëm, ndërsa Sparta shteti ushtarak më i fuqishëm në tërë Heladën.

Cili ka qenë qëllimi i edukatës spartane?

ATHINA

Shteti i Athinës është krijuar në shekullin VIII para e.s. rreth qytetit të Athinës, sipas të cilit edhe e ka marrë emrin Athina. Popullsia në Athinë ndahej në njerëz të lirë dhe njerëz jo të lirë. Njerëzit e lirë ndaheshin në eupatridë (aristokratë) dhe në demos (popull). Eupatridët, kanë qenë qytetarë të pasur dhe të dalluar ndërsa demosin e kanë përbërë fshatarët, zejtarët dhe tregtarët. Në fillim, në krye të shtetit athinas ka qenë mbreti (bazileus), të cilit i ka ndihmuar Këshilli i Kryepaqe (areopag). Ka ekzistuar edhe Kuvendi Popullor, i përbërë nga të gjithë burrat e moshës madhore në shtet. Më vonë, eupatridët e kanë abroguar monarkinë dhe kanë vendosur republikë ndërsa pushtetin ekzekutiv ia kanë dorëzuar Këshillit prej nëntë arhontëve. Në këtë mënyrë, e kanë uzurpuar tërë pushtetin ndërsa popullin (demosin) e kanë lënë pa çfarëdo lloj pushteti politik.



Perikleu

Demosi, nuk ka qenë i kënaqur nga pushteti i eupatridëve. Një numër i madh i demosit u shndërrua në robër për shkak të borxhit të papaguar. Për ta përmirësuar pozitën e të varfërve, në vitin 594 para e.s., arhonti Sollon e ka abroguar robërinë debitore ndërsa qytetarët, sipas gjendjes pronësore i ka ndarë në katër grupe. Njerëzit e grupit të parë, kanë fituar të drejta politike më të mëdha, ndërsa ato të grupit të katërt, të drejta më të vogla. Për shkak të pakënaqësisë së demosit nga këto reforma, në vitin 509 para e.s., Klisteni ka bërë reforma të reja në shtet. Sipas vendit të banimit, popullin në Athinë e ka ndarë në dhjetë krahina me vetëqeverisje të gjerë lokale. Të gjithë njerëzit e lirë, pa dallim nga prejardhja dhe pasuria, kanë fituar të drejta të njëjta. Kështu, shteti athinas prej një shteti aristokratik u shndërrua në republikë demokratike skllavopronare.

Ngritjen më të madhe shteti athinas e ka përjetuar në shekullin V para e.s., kur në krye të tij ka qenë burrështetasi grek më i dalluar, Perikliu. Perikliu e ka përparuar dhe e ka përforcuar demokracinë. Në kohën e tij, Kuvendi Popullor paraqiste organin ligjvënës më të lartë në shtet dhe i zgjidhte të gjitha detyrat në shtet.

Si ka qenë rregullimi shoqëror dhe shtetëror në Athinë?

Bëni projekt: Shteti athinas gjatë kohës së sundimit të Perikliut.



Akropoli

MARRËDHËNIET ME FQINJËT

Kah fundi i shekullit VI para e.s., Persianët kanë filluar të depërtojnë në Gadishullin Ballkanik, duke e pushtuar Trakinë dhe Bizantin. Me këtë, është ndërprerë tregtia e helenëve me kolonitë e tyre në Detin e Zi. Synimi i helenëve që t'i çlirojnë rrugët detare, si edhe ta mbrojnë pavarësinë e vet nga rreziku persian, kanë qenë arsyeja kryesore për luftërat helene-persiane (viti 500-449 para e.s.). Në vitin 490 para e.s., forcat e bashkuara të Athinës dhe Spartës, mandej edhe të shteteve tjera helene, e mundën ushtrinë persiane te Fusha Maratone në Athinë. Pas fitoreve të Gjiri të Sallaminës dhe afër ishullit të Qipros, luftërat helene-persiane kanë përfunduar me fitoren e helenëve.

Pas fitores kundër Persisë, të helenët u formuan dy aleanca ushtarake të mëdha, me rregullim shtetëror dhe shoqëror të ndryshëm. Ato ishin Aleanca e Peloponezitet në krye me Spartën dhe Aleanca Detare athinase në krye me Athinën. Për shkak të rivalitetit të ndërsjellë për mbisundim ekonomik dhe politik, ndërmjet tyre nisi lufta, e njohur si Lufta e Peloponezitet e cila ka zgjatur rreth 30 vjet (viti 431-404 para e.s.), me ç'rast u shkatërrua edhe rregullimi demokratik athinas. Por, kjo luftë i dobësoi të gjitha shtetet helene, kështu që ato shumë lehtë ranë nën pushtetin e Maqedonisë në shekullin IV para e.s.

Pse janë bërë luftërat helene-persiane?



Ushtar spartan

ROMA E LASHTË

TERRITORI DHE POPULLSIA

Shteti romak është krijuar në Gadishullin Apenin, që është i njohur me emrin Itali. Italia, kryesisht është vend malor. Bregdeti i Italisë është shumë dobët i degëzuar dhe nuk është i përshtatshëm për porte detare. Nëpër të rrjedhin disa lumenj të mëdhenj si lumi Po, Tibër dhe Arno. Në afërsinë e Italisë gjenden edhe ishujt e mëdhenj Sicilia, Sardenja dhe Korsika.

Në të kaluarën e largët, në territorin e Gadishullit Apenin kanë jetuar fise dhe popuj të ndryshëm. Ndërmjet tyre, me numër më të madh kanë qenë Italet sipas të cilëve më vonë është emëruar tërë gadishulli Itali. Në pjesën veriore të gadishullit kanë jetuar Galët, Lugurët dhe Venetët. Në veri të lumit Tibër kanë jetuar Etrurët, Umbrët dhe Sabinët ndërsa në jug të tij Latinët dhe Samnitët. Në Italinë jugore kanë ekzistuar më shumë koloni helene ndërsa në Sicili, kartagjenas.

Cilët janë popujt dhe fiset më të vjetër të cilët kanë jetuar në Gadishullin Apenin?



Gadishulli Apenin dhe banorët më të vjetër

TEMA 2

KRIJIMI I ROMËS DHE THEMELIMI I SHTETIT ROMAK

Qyteti i Romës është krijuar në bregun e majtë të lumit Tibër, në krahinën Laciun. Është interesante legjenda për krijimin e qytetit të Romës. Vëllezërit Romuli dhe Remi kanë pasur xhaxha të keq i cili ka dashur ta trashëgojë fronin, prandaj i ka hedhur fëmijët në lumin Tibër. Por, fëmijët kanë pasur fat që uji t'i hedhë jashtë në breg, ku i ka gjetur një ujkonjë dhe u ka dhënë gji. Prandaj, edhe sot skulptura e ujkonjës që ushqen dy fëmijë është simboli i qytetit të Romës. Pastaj, fëmijët i ka marrë dhe i ka rritur një bari, kurse ata, kur janë rritur kanë vendosur të ndërtojnë një qytet në vendin ku i ka gjetur bariu. Kështu, më 21 mars të vitit 753 para e.s., është themeluar qyteti i Romës.

Në fillim, qyteti i Romës ka qenë një lagje dhe shtet i vogël. Qyteti i Romës, gradualisht është përforcuar ekonomikisht, e ka zgjeruar pushtetin e vet mbi lagjet përreth dhe rreth shekullit VI para e.s., është shndërruar në qendër politike dhe është formuar si qytet-shtet.

Në fillim, në krye të shtetit ka qenë mbreti i zgjedhur, i cili ka sunduar përjetësisht. Pushteti i mbretit ka qenë i kufizuar nga Këshilli i Kryepleqve i quajtur Senat. Pushtetin më të madh në shtet e ka pasur Kuvendi Popullor. Popullsia është ndarë në njerëz të lirë (patricë dhe plebenj), dhe në njerëz jo të lirë (robër). Patricët kanë qenë pasardhës të fiseve të lashta



Ujkonja i ushqen Romulin dhe Remin

romake, njerëz nga familje të njohura, kurse Roma ka qenë atdheu i tyre. Plebenjtë kanë qenë ardhacakë që janë marrë me tregti, me zejтари dhe me bujqësi. Ata personalisht kanë qenë të lirë por, pa të drejta politike. Robërit nuk kanë qenë të lirë. Në fillim, kanë qenë pak por më vonë Roma është bërë shteti skllavopronar më i madh në botë.

Si ka qenë rregullimi më i vjetër shoqëror dhe shtetëror i shtetit romak?

REPUBLIKA ROMA KE SI FUQI BOTËRORE

Për arsye se mbretërit romakë nuk e kanë respektuar Senatin, në vitin 509 para e.s., patricët e kanë dëbuar mbretin e fundit romak Tarkuinin Krenar dhe kanë shpallur republikë. Kështu, shteti romak është bërë republikë aristokratike, në të cilën tërë pushtetin e kanë pasur patricët. Në krye të republikës, çdo vit kanë zgjedhur nga dy konsuj, të cilët për punën e vet janë përgjigjur para Kuvendit Popullor.

Në kohën e republikës romake, janë realizuar pushtimet më të mëdha romake. Në fillim, romakët kanë luftuar me etrurët, me galët dhe samnitët, me ç'rast kanë pasur sukses ta pushtojnë Italinë Veriore dhe të Mesme. Pas këtyre pushtimeve, Roma ka luftuar me Italinë Jugore ku ka pasur shumë koloni të lashta greke. Rezistencën më të madhe e ka dhënë qyteti Tarent. Megjithatë, me humbje të mëdha, romakët e kanë pushtuar edhe këtë qytet.

Gjatë fushatave pushtuese, romakët kanë luftuar edhe kundër Kartagjenës në luftërat e njohura si Luftërat e Punëve (viti 264-146 para e.s.). Këto luftëra janë bërë me sukses të ndryshueshëm, dhe më në fund, në Luftën e tretë pune, Kartagjena shkatërrohet si shtet. Me këtë, Roma është bërë pronari i vetëm i pjesës perëndimore të Detit Mesdhe.

Në mënyrë paralele me luftërat Pune, romakët kanë filluar ta pushtojnë Ballkanin. Të parët janë nënshtruar ilirët, mandej në mesin e shekullit II para e.s., edhe Maqedoninë dhe Heladën. Në luftërat pushtuese në vijim, romakët e kanë pushtuar Sirinë, Mesopotaminë dhe Azinë e Vogël, mandej Galinë e Madhe (Franca e sotme), ndërsa në vitin 30 para e.s. e kanë pushtuar edhe Egjiptin. Me këtë, Roma është bërë shtet skllavopronar botëror i cili është shtrirë në tre kontinente (Evropë, Azi dhe Afrikë).

Si janë zhvilluar pushtimet romake?


Përpilo projekt: Luftërat Pune.

SHKATËRRIMI I REPUBLIKËS ROMAKE

Kryengritjet e shumta të robërve, të cilat janë përhapur nëpër shtetin romak, si edhe pakënaqësitë e popujve të nënshtruar, i kanë nxitur luftërat politike për mbisundim mbi shtetin. Në vitin 60 para e.s., tre komandantë Cezari, Pompei dhe Krasi kanë lidhur aleancë - triumvirat që të vendosin rend në shtet. Triumvirat kanë bërë kthesë dhe tërë pushtetin e kanë marrë në duart e veta. Kështu, në Romë është paraqitur diktaturë e tre personave. Personi më i rëndësishëm ndërmjet diktatorëve është bërë Cezari, i cili ka vendosur diktaturën e vet. Para rrezikut nga abrogimi i republikës, një pjesë e senatorëve më të afërm - republikanë, në krye me Brutin dhe Kasin, në vitin 44 para e.s., kanë organizuar komplot dhe e kanë vrarë Cezarin.

Pas vrasjes së Cezarit në vitin 43 para e.s., është formuar Triumvirati i Dytë në të cilin kanë hyrë Marko Antoni, Lepidi dhe Oktaviani, nipi i Cezarit. Triumvirati i Dytë, për dallim nga i pari, ka qenë i konfirmuar edhe nga Senati. Së shpejti, triumvirat, që të sundojnë më lehtë me shtetin, e kanë ndarë pushtetin. Pas një kohe të shkurtër, Lepidi ka qenë i detyruar që territorin e vetë t'ia dorëzojë Oktavianit. Por, së shpejti ka ardhur deri te lufta ndërmjet Oktavianit dhe Antonit, i cili në pjesën lindore të shtetit ka sunduar si sundimtar i pakufizuar. Beteja përfundimtare ndërmjet marinës së Oktavianit dhe marinës së bashkuar të Antonit dhe të mbretëreshës egjiptiane Kleopatrës, është zhvilluar në Akcij, në vitin 31 para e.s. Pas fitores në këtë betejë, Oktaviani e ka pushtuar Egjiptin. Me këtë, Oktaviani është bërë sundimtar i vetëm dhe i është vënë fund Republikës romake dhe fillimi i Mbretërisë romake.

Pse janë formuar triumvirati i Parë dhe i Dytë?



Oktavian Augusti



Ushtarë romakë

MBRETËRIA ROMAKE

Oktavian Augusti (prej vitit 30 para e.s. deri në vitin 14 para e.s.), nga ana e Senatit e ka fituar titullin *princes*, që do të thotë qytetari i parë romak. Së këndejmi ka lindur edhe emri principatë për sistemin e udhëheqjes në shtetin që e ka udhëhequr ai, e që ka zgjatur rreth tre shekuj. Principata ka qenë sistem i atillë i sundimit në të cilin vetëm për nga forma janë ruajtur institucionet republikane ndërsa në fakt, ka ekzistuar pushtet i pakufizuar i perandorit. Përveç ushtrisë së rregullt, Oktaviani ka formuar edhe gardë pallati perandorake të quajtur gardë pretoriane. Gjatë sundimit të tij, janë pushtuar territore të reja në: Slloveni, një pjesë e Austrisë, një pjesë e Panonisë, dhe Serbia e Bullgaria e sotme. Oktavian Augusti, e ka zbkuruar Romën me shumë pallate dhe përmendore, andaj koha e tij është e njohur si shekulli i artë i Augustit.

Në kohën e perandorit Trajan (viti 98-117), Perandoria Romake e ka arritur zgjerimin më të madh territorial. E ka pushtuar Dakinë (Rumaninë e sotme), në lindje e ka pushtuar Mesopotaminë, Jemenin dhe Arabinë.

Kah fundi i shekullit III, perandorët romakë, me qëllim që ta stabilizojnë dhe ta përforcojnë shtetin, vendosin pushtet të pakufizuar. Titullin e vjetër *princes* e zëvendësojnë me të ri - *dominus* (zot), kurse sundimi është quajtur *dominat*, dhe ka zgjatur dy shekujt e ardhshëm. Perandori i parë romak i kësaj kohe, Diokleciani, tërë territorin e shtetit e ka ndarë në katër pjesë, me të cilat kanë udhëhequr katër sundimtarë (tetrarki), por vetëm urdhrat e Dioklecianit kanë qenë në fuqi në tërë shtetin.

Për shkak të sulmeve të fuqishme të fiseve barbare mbi Perandorinë Romake, në vitin 395, perandori Teodosi I e ka ndarë mbretërinë në atë Lindore dhe Perëndimore. Mbretëria Romake Perëndimore është shkatërruar në vitin 476 kur njëri nga udhëheqësit e paguar, Odoakar e ka hequr nga fronin mbretin romak Romul Augustul dhe e ka shpallur veten për

mbret të Italisë. Mbretëria Romake Lindore ka vazhduar të ekzistojë edhe 1 000 vjet deri në rënien e Kostandinopojës nën pushtetin e Otomanëve.



Shpegojeni principatën dhe dominatin si sisteme sundimi.

Shpegojeni principatën dhe dominatin si sisteme sundimi.

KRISHTERIMI - RELIGJIONI I RI

PARAQITJA E KRISHTERIMIT

Kundërshtimet e ashpra të brendshme dhe konfliktet në të cilat është gjetur shteti romak, kanë shkaktuar numër të madh të kryengritjeve të popullit hebre në provincën romake Palestinë. Politeizmi në të cilin kanë besuar, nuk ka mundur t'u japë masave përgjigje për padrejtësitë ose shpresë për jetë më të mirë. Në kushte të atilla, në shekullin I para e.s., në Palestinë është paraqitur krishterimi si mësim i ri religjioz.



Katakombe

Predikuesit, kanë besuar se në vitin 30 të sundimit të perandorit romak Oktavian Augusti, në Betlehem në Palestinë, ka lindur i Biri i Zotit Jezu Krishti, i cili do t'i shpëtojë njerëzit nga vuajtjet e tyre dhe do të sakrifkohet për ta. Jezu Krishti, i ka mësuar njerëzit të bëjnë vepra të mira, ta ndihmojnë njëri tjetrin. Të gjithë ata që e kanë pranuar mësimin e tij, janë quajtur të krishterë. Sipas besimit të krishterëve, të gjithë ato që gjatë jetës bëjnë vepra të mira dhe jetojnë jetë të drejtë, pas vdekjes do të shkojnë në parajsë në qiell ku do të shpërblehen me jetë të lumtur të përjetshme, ndërsa ata që kanë gabuar do të shkojnë në ferr ku do të dënohen me mundime të përjetshme.

Si predikues, Jezu Krishti, ka qenë i akuzuar nga ana e romakëve dhe priftërinjve hebre para administratorit romak Ponti Pilat se është rebel. Atë e kanë kapur dhe e kanë dënuar me mbërthim në kryq. Ditën e tretë pas vdekjes, Jezu Krishti ringjallet, pastaj ka shkuar në qiell tek të Ati. Lindjen e Jezu Krishtit, të krishterët e kremtojnë si festën e Krishtlindjeve, ringjalljen e tij si festën e Pashkëve ndërsa ngjitjen e tij në qiell si ditën e Shëlbimit.

Prej vitit të lindjes së Jezu Krishtit, krishterët kanë filluar ta llogarisin kohën. Prej atëherë ka filluar epoka krishtere, ose era e re sipas së cilës e llogarisim sot kohën.

Në çfarë kushtesh është paraqitur dhe është zhvilluar krishterimi?

Hulumto dhe mëso? Në cilat katër ungjij gjejmë të dhëna për jetën e Jezu Krishtit dhe për veprimtarinë e tij?

PËRHAPJA E KRISHTERIMIT*Libri i Shenjtë (Bibla)*

Në përhapjen e mësimit, Jezu Krishtit i kanë ndihmuar nxënësit e tij - 12 apostujt. Apostujt, kanë udhëtuar nëpër shtet dhe kanë formuar komuna krishtere, prandaj edhe kanë qenë edhe më meritoret për përhapjen e krishterimit në shtetin romak. Ndërmjet apostujve, më të njohur kanë qenë: Pjetri, Pali, Josifi, Marku, Jakobi etj.

Në fillim, krishterët janë tubuar në tryeza, predikime dhe lutje të përbashkëta. Bashkësitë e besimtarëve janë quajtur komuna krishtere. Prona e komunës ka

qenë e përbashkët, me të kanë disponuar të gjithë dhe janë ndihmuar në mënyrë të ndërsjellë. Pa dallim asaj se në fillim në komunat krishtere kanë bërë pjesë vetëm të varfrit, prona që e kanë poseduar ka qenë shumë modeste. Në shekullin e dytë dhe të tretë, komunave krishtere u janë bashkëngjitur edhe njerëzit e pasur dhe të arsimuar romakë me tokën dhe pronën e vet. Kah fundi i shekullit II, të gjitha komunat krishtere janë bashkuar në

*Varri i Jezu Krishtit në Jerusalem*

TEMA 2

një bashkësi, në krye të së cilës ka qenë ipeshkvi romak. Atij i janë nënshtruar të gjithë ipeshkvit dhe priftërinjtë. Kështu është themeluar kisha krishtere.

Cili ka qenë roli i apostujve në përhapjen e Krishterimit?

Detyrë: Lexoni Dhjetë Urdhrat e Zotit. Shqyrtoni mesazhet e tyre!

KRISHTERIMI BËHET RELIGJION SHTETËROR

Krishterimi është përhapur shpejt në shtetin romak, së pari në Palestinë dhe në Azinë e Vogël, mandej edhe në territoret tjera të Perandorisë. Edhe pse të krishterët nuk kanë luftuar kundër pushtetit shtetëror romak, në fillim ai ka parë me mosbesim të madh ndaj tyre dhe mësimin e tyre e ka konsideruar si të rrezikshëm. Prandaj të krishterët kanë qenë të persekutuar dhe janë tubuar në mënyrë të fshehtë në strehimore nëntokësore të quajtura katakombe. Persekutimet e para të krishterëve kanë qenë në kohën e Neronit, i cili i ka akuzuar për zjarrin në Romë. Persekutimet e fundit, por me përmasa më të mëdha, kanë qenë në shekullin III, veçanërisht në kohën e perandorit Dioklecian. Ai ka qenë sundimtari i fundit i cili në kishën krishtere ka parë rrezik për pushtetin shtetëror. Perandorët Romakë, në këtë kohë i kanë konsideruar të krishterët si rebelë, si kundërshtarë të perandorit dhe të shtetit. Prandaj i kanë shkatërruar komunat e tyre, ua kanë konfiskuar pronat dhe i kanë dënuar me vdekje.

Perandori romak Konstantini I - njëri nga trashëgimtarët e Dioklecianit, duke kuptuar se kisha krishtere nuk paraqet rrezik për shtetin, në vitin 313 e ka publikuar Ediktin e Milanos me të cilin krishterimi është pranuar si religjion i barabartë me religjionet tjera në shtet. Me këtë, për herë të parë u është lejuar të krishterëve që ta predikojnë religjionin e vet në mënyrë të lirë dhe të ndërtojnë kisha të veta.

Pas Ediktit të Milanos, është paraqitur nevoja për mbajtjen e një sinodi në të cilin do të debatohet për çështjet e kishës dhe për organizimin e kishës krishtere. Në vitin 325, në Nike është mbajtur Sinodi i parë i përgjithshëm në të cilin ka marrë pjesë edhe perandori Konstantin I i Madh. Në Sinodin e dytë të përgjithshëm, të mbajtur në vitin 381, në Stamboll, është përpunuar simboli i fesë - kryqi, si edhe dogmat themelore të kishës krishtere. Menjëherë pas këtij sinodi, krishterimi është bërë edhe religjion shtetëror.

Si është bërë krishterimi religjion shtetëror?



Perandori Konstantini i Madh

KULTURA HELENE DHE ROMAKE

KULTURA HELENE

RELIGJIONI

Si edhe popujt tjerë, ashtu edhe Helenët nuk kanë qenë në gjendje që t'i shpjegojnë dukuritë natyrore, prandaj i kanë ndërlidhur me ndikimin e fuqive mbinatyrore. Besimet janë zhvilluar prej animizmit dhe totemizmit deri në politeizëm. Më vonë, totemet dhe shpirtrat janë zëvendësuar me perëndi të cilët i kanë prezantuar me fytyra njerëzore, me karakteristika të mira dhe të këqija, siç kanë pasur njerëzit e rëndomtë. Sipas legjendës, perënditë kanë jetuar në malin Olimp.

Perëndia kryesor ka qenë Zeusi, të cilin helenët e kanë parafytyruar si përfaqësues të pushtetit më të madh. Ai ka qenë zoti i qiellit, i ka grumbulluar dhe i ka shpërndarë retë,



TEMA 2

ka hedhur rrufe - prandaj e kanë quajtur edhe rrufehedhës. Vëllezërit e Zeusit kanë qenë Posedoni - zoti i deteve, ujërave dhe oqeanit dhe Hadi - zoti i mbretërisë nëntokësore. Gruaja e Zeusit, Hera, ka qenë mbrojtëse e lidhjes martesore ndërsa bija, Athina - perëndeshë e mençurisë. Afrodita - ka qenë perëndeshë e bukurisë dhe dashurisë. Apoloni ka qenë perëndia e diellit, dritës dhe poezisë. Dionisi, ka qenë zot i verës dhe hareshë.

Perëndive të vet, Helenët u kanë ofruar sakrifica dhe dhurata dhe u kanë ndërtuar tempuj luksoz. Helenët, kanë besuar edhe në demonë, në shpirtra, në muza, nimfa, satirë dhe fuqi të tjera. Tregimet për ato fuqi quhen mite, ndërsa të gjitha mitet së bashku quhen mitologji.

Si i kanë prezantuar Helenët e Lashtë perënditë e veta?

LOJËRAT OLIMPIKE

Helenët, kanë organizuar solemnitete të ndryshme dhe ndeshje sportive me karakter lokal dhe të përgjithshëm helen, kushtuar perëndive të tyre. Prej lojërave sportive, më të njohura kanë qenë Lojërat olimpike, të cilat janë mbajtur në qytetin e Olimpikut në Peloponez. Lojërat e para olimpike janë mbajtur në vitin 776 para e.s., Gjatë mbajtjes së lojërave, janë ndërprerë të gjitha luftërat dhe është shpallur paqe. Pjesëmarrësit kanë garuar në disiplina të ndryshme sportive: në atletikë, ushtrime, hedhje disku, shtize, shigjete etj. Fituesve, u varej kurorë dafine, pastaj i kremtonin nëpër tërë Heladën.



Hedhës disku (diskobolos)

LETËRSIA

Helenët e Lashtë, kanë dhënë poezi dhe prozë të pasur epike, lirike dhe të dramës. Veprat epike më të njohura në letërsinë helene janë Iliada dhe Odiseja të cilat, sipas traditës i ka kënduar poeti i verbër Homeri. Gjatë shekullit V para e.s., janë shkruar edhe tragjedi dhe komedi. Shkrimtarët më të njohur të tragjeditive kanë qenë: Eskili, Sofokliu dhe Euripidi, ndërsa shkrimtari më i njohur i komedive ka qenë Aristofani.

Për nder të zotit Dionis, janë mbajtur shfaqje teatrale. Vendi ku janë mbajtur shfaqjet është quajtur teatër. Në fillim, shfaqjet janë mbajtur nëpër sheshet, ndërsa



Teatër antik

*Sokrati*

më vonë kanë ndërtuar teatro në formë amfiteatrale të gjysmërrethit.

Çfarë përshkruhet në Iliadën dhe Odisenë?

SHKENCA

Prej më shumë disiplinave shkencore të helenët rëndësi të veçantë i është përkuftuar filozofisë. Në filozofi janë formuar dy drejtime themelore: materializmi dhe idealizmi. Filozofët-materialistë më të dalluar kanë qenë: Talesi, Demokriti dhe Herakliti. Filozofët-idealistë më të njohur kanë qenë: Sokrati, Platoni dhe Aristoteli. Prej shkencave tjera, të helenët më së shumti janë zhvilluar matematika, astronomia dhe medicina. Matematikanët më të njohur kanë qenë Pitagora dhe Anaksagora, ndërsa mjeku më i njohur, Hipokrati, i njohur si babai i medicinës. Historianët më të njohur kanë qenë Herodoti dhe Thukididi.

*Partenoni*

TEMA 2

ARKITEKTURA, SKULPTURA DHE PIKTURA

Helenët kanë arritur rezultate të mëdha në arkitekturë. Tempujt e tyre dhe ndërtesat publike kanë arritur përsosmëri dhe harmoni të madhe artistike. Në arkitekturë dallojmë shtylla në tre stile. Stili dorik, jonik dhe korintik. Ndërtesa më e bukur ka qenë tempulli i Partenonit, i ndërtuar në Akropol në Athinë, për nder të perëndeshës Athina. Helenët, kanë qenë mjeshtër të shkëlqyer në prezantimin e bukurisë së trupit të njeriut. Skulptorët helenë më të njohur kanë qenë Fidi dhe Mironi. Pikturimi ka arritur përkryerje, veçanërisht në vizatimin e vazove qeramike.

Cilat kanë qenë arritjet më të rëndësishme të arkitekturës dhe skulpturës helene?

KULTURA ROMAKE

RELIGJIONI

Romakët kanë besuar në më shumë zota dhe i kanë konsideruar për mbrojtës të blegtorisë, të bujqësisë, të vatrës shtëpiake etj. Çdo familje romake ka pasur edhe zotin e vet shtëpiak - mbrojtës. Ata i kanë quajtur larë dhe penatë. Kur romakët kanë ardhur në kontakt me popujt e tjerë, me etrurët dhe helenët, perënditë e veta kanë filluar t'i prezantojnë sipas modelit të zotëve etrurë, e veçanërisht helenë.



Koloseo në Romë



Jupiteri, zoti suprem i romakëve

Zotët më të rëndësishëm romakë kanë qenë: Jupiteri, zoti suprem - zoti i qiellit, gruaja e tij Junona, mbrojtëse e martesës, Minerva ka qenë perëndeshë e zejtarisë dhe e mençurisë ndërsa Venera ka qenë perëndeshë e bukurisë, Marsi ka qenë zot i luftës, ndërsa Vullkani zot i rrufesë etj.

Bëni krahasim ndërmjet perëndive romakë dhe helenë!

LETËRSIA DHE SHKENCA

Letërsia romake është zhvilluar nën ndikimin e fuqishëm të letërsisë helene. Koha e Oktavian Augustit për letërsinë romake paraqet shekull të artë. Në atë kohë, kanë jetuar dhe kanë krijuar poetët e njohur romakë Virgjili, Horaci dhe Ovidi. Vepra më e njohur e Virgjilit është epi Eneida, Horaci ka shkruar poezi lirike ndërsa Ovidi ka shkruar këngë të mallëngjyeshme - elegji.

Prej shkencave, në Romë veçanërisht janë zhvilluar: historia, shkenca juridike, filozofia dhe gjeografia. E drejta romake, në të kaluarën është shndërruar në bazë të shkencës juridike dhe për

këtë arsye mësohet në të gjithë fakultetet juridikë në botë. Historianët më të njohur kanë qenë: Tit Livi, Plini më i Vjetri, Plutarku, Cezari etj. Në filozofinë e Romës së Lashtë janë të njohur Lukreci Kar, Ciceroni dhe Seneka.

Romakët, veçanërisht e kanë çmuar dhe e kanë kultivuar gojëtarinë (oratorinë). Oratorët më të njohur romakë kanë qenë Ciceroni dhe Cezari.

ARKITEKTURA, SKULPTURA DHE PIKTURA

Në shtetin romak, posaçërisht shumë është zhvilluar ndërtimtaria. Romakët kanë ndërtuar pallate, banja publike, porta triumfale, amfiteatro, ura, rrugë, ujësjellës dhe ngjashëm. Ndërtimet nuk janë karakterizuar me origjinalitetin e vet, por me monumentalitetin e vet. Ndërtimet më monumentale në qytetin e Romës kanë qenë tempulli i Panteonit, kushtuar gjithë zotëve dhe amfiteatri Koloseum ku janë mbajtur luftërat e gladiatorëve.

Në shtetin romak, janë zhvilluar edhe skulptura dhe piktura. Janë skalitur statuja të sundimtarëve dhe të personave të dalluar të tjerë. Pikturat-freskat më të bukura janë zbuluar në Qytetin e Pompeit.

BALLKANI NË SHEKULLIN E VJETËR

ILIRËT


Ilirët kanë qenë popull i vjetër ballkanik dhe e kanë banuar pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, përkaj Detit Adriatik. Gadishulli i Triestes ka qenë atdheu i tyre më i hershëm. Më vonë, kanë zbritur kah bregu jugor i bregdetit Adriatik, deri në Shqipërinë e sotme të mesme dhe në Epir. Prej fiseve të shumta ilire, më të njohura kanë qenë: Tesprotët, Liburnët, Dalmatët, Japodët, Dardanët, Taulantët etj.

Ilirët janë marrë me bujqësi, me blegtori e më vonë me zejтари dhe me tregti. Nga shtazët shtëpiake kanë rritur: dhen, dhi, gjedhë, kuaj etj., ndërsa nga kulturat e drithërave kanë kultivuar grurë, elb, mel etj. Për shkak të pozitës së volitshme gjeografike të vendeve ilire të cilat kanë pasur dalje në Detin Adriatik dhe një pjesë në Detin Jon, ata kanë qenë lundërtarë të mirë. Kanë ndërtuar edhe anije të cilat i kanë quajtur liburne.

Në krye të çdo fisi ka qëndruar kryeplaku i fisit. Gjatë rrezikut të jashtëm, janë bashkuar në Lidhje fisesh. Kah fundi i shekullit V para e.s., fiset ilire në territorin e bregdetit lindor të Detit Adriatik janë bashkuar në bashkësi fisnore - mbretëri në krye me mbretin Grab.

Në shekullin IV, në territorin e Kosovës, është formuar mbretëria e Dardanëve. Mbretëria e Dardanëve ka pasur ushtri shumë të fuqishme dhe mirë të organizuar. Kah mesi i shekullit III para e.s., me Dardaninë kasunduar mbreti Logar.

Në shekullin III para e.s., është formuar mbretëria e madhe ilire e Ardianëve me kryeqytet në qytetin e Shkodrës. Në krye të mbretërisë ka qenë mbreti Agron. Atë e ka trashëguar gruaja e tij Teuta. Për shkak të zgjerimit territorial në Detin Adriatik, romakët, i kanë sulmuar forcat e saj me ç'rast ka filluar Lufta e parë romake-ilire. Mbretëresha Teuta ka pësuar disfatë dhe ka qenë e detyruar ta pranojë pushtetin romak. Në Luftën e dytë romake-ilire, romakët përsëri kanë arritur fitore. Në Luftën e tretë romake-



Liburna

ilire, në vitin 168 para e.s., mbreti ilir Genti është mundur nga romakët, me ç' rast territoret e tij janë shndërruar në provincë romake.

Cilat kanë qenë mbretëritë më të njohura ilire?

TRAKËT

Trakët kanë qenë popull i vjetër ballkanik me prejardhje indoevropiane. Ata i kanë banuar pjesët lindore të Gadishullit Ballkanik. Fiset më të njohura trake janë: Besët, Odrisët, Medet, Sertët etj. Në krye të çdo fisi ka qenë kryeplaku i fisit ndërsa në kohë të rrezikut të jashtëm, janë bashkuar në Lidhje fisesh.



Helmetë trake

Trakët janë marrë me gjueti, me peshkatari, me blegtori e më së shumti me bujqësi. Kanë rritur më shumë shtazë shtëpiake, e veçanërisht kanë qenë të njohur për rritjen e kuajve të bardhë. Kanë pasur poçeri të zhvilluar, ndërsa kanë ditur t'i përpunojnë edhe metalet. Kanë qenë tregtar të shkathët, e më së shumti kanë bërë tregti me Helenët.

Në shekullin V para e.s., ka filluar bashkimi i fiseve trake në organizim shtetëror. Për shkak të rolit udhëheqës të fisit trak Odris, në formimin e shtetit, njihet edhe si Mbretëria e Odrisit. Themelues i Mbretërisë ka qenë mbreti Odris. Në shekullin IV para e.s., Odrisët e kanë pranuar pushtetin suprem të mbretit maqedonas Filipi II, por kanë mbajtur vetëqeverisje të caktuar. Kah mesi i shekullit I para e.s., perandori romak Klaudij i ka pushtuar territoret e Mbretërisë Odrise dhe e ka formuar provincën romake Trake.

Trakët, nuk kanë pasur dëshmi të shkruar letrare. Letërsia e tyre është bartur gojarisht, brez pas brezi. Kanë pasur gjuhën e vet, por si edhe maqedonasit dhe ilirët, nuk kanë krijuar shkrim të vet dhe janë shërbyer me shkrimin helen.

Si është formuar Mbretëria Odrise?

PAJONËT


Pajonët, si popullsi e vjetër ballkanike me prejardhje indoevropiane, i kanë banuar krahinat në pjesën jugore dhe qendrore të Ballkanit, prej luginave të lumenjve Vardar dhe Strum, krahinat në perëndim deri në Pelagoni, në veri deri te burimet e Strumës, ndërsa në jug deri në Detin Egje. Për herë të parë përmenden në Iliadën e Homerit, si aleatë të Trojanëve. Prej fiseve pajone, më të njohur janë: Agrianët, Siropajonët, Pajoplitë, Doberët, Demonët etj.

Me përforcimin e shtetit maqedonas, pajonët si fise të afërme me maqedonasit, i kanë humbur territoret jugore. Në shekullin IV para e.s., fiset pajone kanë formuar shtet nën udhëheqjen e mbretit Agis. Pas vdekjes së tij, pajonët e kanë pranuar pushtetin suprem të mbretit maqedonas Filipi II. Rreth vitit 230 para e.s., shteti pajon ka pushuar së ekzistuari. Pjesët jugore të mbretërisë pajone kanë rënë nën pushtetin maqedonas ndërsa pjesët veriore i kanë pushtuar Dardanët.


Cilat krahina të Ballkanit i kanë banuar pajonët?

MAQEDONASIT

Maqedonia Antike përfshinte pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, në veri të malit Jakupicë, të lumit Pçinjë, Malin e Zi të Shkupit, kah Malet e Osogovës, në jug deri në malin Pind dhe Olimp, në lindje deri në malin Pirin dhe lumin Maricë, a në perëndim deri në malet Korab, Galiçicë, Jablanicë dhe Mali Sharr. Shkrimtarët antikë, e kanë ndarë Maqedoninë në Maqedoninë e Sipërme dhe Maqedoninë e Poshtme. Maqedonia ka qenë e pasur me pyje, me



Falanga maqedonase



Filipi II

lugina pjellore, me lumenj, liqene, ndërsa ka pasur dalje edhe në Detin Egje. Maqedonasit janë marrë me bujqësi, me blegtori, me gjueti dhe me peshkatari. Gjuetia paraqiste provë për guximin dhe pjekurinë e ushtarëve të rinj, gjuetia e luanëve është konsideruar si guximi më i madh.

Maqedonasit kanë qenë popull ballkanik me prejardhje indoevropiane. Kanë jetuar në veri të helenëve, në jug dhe juglindje të ilirëve, dhe në jugperëndim të trakeve. Kanë pasur gjuhë të veçantë, religjion, kulturë e cila ka dalluar nga ajo helene. Në etnogjenezën e tyre, rol të madh kanë pasur brigët dhe pajonët. Fiset më të rëndësishme maqedonase kanë qenë: Ogrestët, Elimejt, Pierijt, Linkestët, Pellagonët, Enkelejt, Dasaretët etj. Sipas legjendës, maqedonasit kanë pasur prejardhje nga mbreti i tyre mitik i quajtur Makedon.

Në shekullin VIII para e.s., ka filluar bashkimi i fiseve maqedonase në një shtet unik, nën udhëheqjen e dinastisë Argeadë. Themelimin e shtetit të parë, tradita ia përshkruan mbretit Perdika I. Kryeqyteti i parë maqedonas gjendej në qytetin Ajga, në rrjedhën e poshtme të lumit Bistricë, kurse më vonë është zhvendosur në qytetin Pela.

Në kohën e mbretit Filipi II (359-336 p.e.s.), shteti maqedonas është bërë fuqia më e madhe në Ballkan. Filipi II, ka zbatuar reforma financiare dhe ushtarake në shtet. Ka luftuar kundër ilirëve, helenëve, pajonëve, dhe trakëve. Në betejën tek Hajronea në vitin 338 para e.s., ai i ka mposhtur helenët, të cilët pastaj e kanë njohur ushtetin suprem maqedonas.

Shtirirjet më të mëdha territoriale, shteti maqedonas i ka përjetuar në kohën e sundimit të birit të Filipit, mbretit Aleksandri III i Madh. Në fushatën kundër Persisë, Aleksandri ka arritur ta shkatërrojë shtetin persian. Mandej, ka arritur t'i pushtojë pjesët perëndimore të Indisë, por për shkak të lodhjes së ushtrisë së tij, ka qenë i detyruar ta ndërpresë fushatën dhe të kthehet në Babiloni. Shteti i tij shumë i madh është shtrirë në tre kontinente: në Evropë, në Azi dhe në Afrikë.



Aleksandri i Madh

Si u zgjerua shteti maqedonas?

**TEMA 3.
MESJETA**

FILLIMET E EVROPËS - SHTETI I FRANKËVE

DYNDJA E MADHE E POPUJVE



Dyndja e madhe e popujve

Në gjysmën e dytë të shekullit IV dhe në fillim të shekullit V, nga Azia në Evropë kanë filluar të depërtojnë fiset barbare - hunët, avarët dhe të tjerë, të cilët kanë shkaktuar lëvizje të madhe të popujve dhe fiseve barbare, e njohur si Dyndja e madhe e popujve. Dyndjen e kanë filluar hunët. Ato kanë qenë fis endacak me prejardhje mongole. Në shekullin IV, kanë jetuar në krahinat ndërmjet liqenit Kaspik dhe lumit Vollgë, ku janë ndeshur me gotët. Kur në krye të federatës fisnore të hunëve ka ardhur Atilla, presioni i hunëve është përforcuar edhe më shumë. Kjo ka shkaktuar lëvizje të më shumë fiseve ku në numër më të madh kanë qenë fiset gjermane: Ostrogotë, Frankë, Vandalë, Vizigotë, Langobardë

etj. Pasuria e Perandorisë Romake i ka tërhequr këto fise, të cilët në shekullin V dhe VI, në territorin e vet kanë themeluar më shumë shtete të veta.

Si është shkaktuar Dyndja e madhe e popujve?

FORMIMI I SHTETIT TË FRANKËVE

Frankët kanë qenë fis gjerman, i cili gjatë Dyndjes së madhe të popujve ka jetuar në brigjet e Rajnës së mesme dhe të poshtme. Në kërkim të vendit të ri, janë vendosur në provincën romake Galia. Në luftërat pushtuese, më së shumti është dalluar knezi Kllodovik (481-511), i cili i ka bashkuar frankët dhe ka formuar shtet të vet, e mandej është shpallur për mbret i të gjithë frankëve. Me qëllim që të sigurojë përkrahje nga kisha në pushtimet e mëtutjeshme në Gali, kah fundi i shekullit V, Kllodoviku e ka pranuar krishterimin. Pas vdekjes së Kllodovikut, shteti ka filluar të dobësohet. Bijtë e tij, pastaj edhe nipërit e kanë ndarë shtetin ndërmjet veti dhe ai është shpërbërë në më shumë mbretëri.

Mbretëria e frankëve ka filluar përsëri të përforcohet në shekullin VIII, kur në krye të shtetit ka ardhur Karlo Martel i cili e ka themeluar dinastinë e tij mbretërore në shtetin Frank - Karolingët. Në vitin 732, në betejën në Poatje i ka fituar arabët, e ka parandaluar depërtimin e tyre në Spanjë në Evropën Perëndimore. Karlo Martel, ka zbatuar reforma ushtarake me të

TEMA 3

cilat i ka dhënë përparësi kalorësisë. Për këtë arsye, të gjithë ushtarëve të cilët kanë dashur të shërbejnë në këtë gjini të ushtrisë, u ka dhuruar parcela të tokës për shfrytëzim të përhershëm. Këto prona tokësore janë quajtur beneficium, kurse ushtarët që e kanë pranuar janë quajtur vasal. Kështu janë krijuar kushte për formimin e kalorësisë së ardhshme.

Pse e kanë pranuar frankët krishterimin?

SHTETI FRANK NË KOHËN E KARLIT TË MADH

Fuqinë më të madhe dhe përhapjen territoriale shteti Frank e ka arritur në kohën e Karlit të Madh (768-814). Ai ka luftuar kundër Langobardëve, kundër Arabëve, Sllovenëve etj. Me këto luftëra, ai e ka zgjeruar shtetin në veri deri në Detin Baltik, në perëndim deri në Oqeanin Atlantik dhe lumen Ebro në Spanjë, dhe në lindje deri në lumenjtë Laba, Sava dhe Malet Boheme. Territori i shtetit të Karlit të Madh i ka përfshirë pothuajse të gjitha vendet, të cilat paraprakisht i kanë takuar Perandorisë Perëndimore Romake. Për këtë shkak, Karli i Madh ka kërkuar nga Papa që ta shpallë për perandor romak. e ka shpallur perandor të Perandorisë së Shenjtë Romake.



Karli i Madh



Karli i Madh

Me qëllim që ta zmadhojë ushtrinë vasale, Karli i Madh e ka zmadhuar dhënie e beneficioneve gjatë luftërave. Perandori, prej tyre ka kërkuar jo vetëm personalisht të marrin pjesë në fushatat ushtarake, por me vete të marrin edhe shoqëri të armatosur. Që të vijin më shumë ushtarë, vasalët ushtarakë edhe vetë kanë filluar të japin beneficione, kështu janë paraqitur edhe vasalët e tyre. Vasalët mbretërorë, në raport me vasalët e vet janë quajtur seniorë. Seniori suprem në shtet ka qenë mbreti. Me kalimin e kohës, vasalët mbretërorë, tokën e fituar si beneficium kanë filluar ta shpallin si të trashëguar. Toka e trashëguar, me të cilën ka sunduar vasali, është quajtur feud ndërsa pronari feudal. Kështu, është krijuar një varësi e fortë


e feudalëve më të ulët nga ata më të lartë. Kështu është krijuar hierarkia feudale. Në krye të hierarkisë feudale ka qëndruar mbreti. Pas tij, vijojnë vasalët mbretërorë dhe kisha, pronarët e mëdhenj të tokës, baronët, grofët dhe të tjerë, ndërsa nën ta kanë qenë kalorësit. Për të gjithë pronarët feudal, kanë punuar fshatarët bujkrobër.

Si ka qenë i rregulluar shteti i Karlit të Madh?

SHPËRBËRJA E SHTETIT FRANK

Pas vdekjes së Karlit të Madh, në fron është ulur i biri Ludvigu, i quajtur “I devotshëm”. Për shkak se nuk i ka pasur aftësitë e të atit, Ludvigu, akoma derisa ka qenë gjallë ua ka ndarë tokën të tre bijve të vet - Lotarit, Ludvigut dhe Karlit, kurse për vete e ka mbajtur pushtetin suprem. Ata kanë luftuar ndërmjet veti në lufta që kanë përfunduar me marrëveshjen e Verdenit në vitin 843. Sipas marrëveshjes, Shteti frank përfundimisht është ndarë në tre pjesë, prej të cilëve janë formuar tre mbretëri: Mbretëria Perëndimore Franke e cila ka filluar të emërohet Francë, Mbretëria Lindore Franke që ka filluar të quhet Gjermani dhe Mbretëria Jugore Franke e cila ka filluar të quhet Itali.

Pse është shpërbërë shteti frank pas vdekjes së Karlit të Madh?



Shteti i Frankëve në kohën e Karlit të Madh

ARABËT DHE ISLAMI

TERRITORI DHE POPULLSIA

Territori ku kanë jetuar arabët e vjetër, shtrihet në Gadishullin Arabik. Më shumë se një e treta e këtij territori paraqet tokë shkretinore pa ujë dhe vështirë e kalueshme. Vetëm në pjesën jugore, të quajtur Jemen dhe bregdeti i Detit të Kuq që është quajtur Hexhas, kanë pasur krahina pjellore (oaza), të pasura me bimë tropikale dhe të përshtatshme për bujqësi. Nëpër këtë krahinë, ka kaluar rruga më e rëndësishme e karvanëve prej Bizantit për në Indi. Përgjatë asaj rruge janë themeluar më shumë qytete prej të cilave më të rëndësishme kanë qenë Meka dhe Medina.

Në Gadishullin Arabik kanë jetuar më shumë fise ndër të cilët me numër më të madh kanë qenë Beduinët. Beduinët, kanë rritur deve, dhen e dhi, si dhe kuajt e famshëm arabikë. Ato kanë jetuar jetë nomade. Kanë qenë të grupuar në gjini dhe në fise. Në shekullin IV, tek arabët vjen deri në shpërbërjen e rregullimit gjinor dhe është paraqitur aristokracia fisnore.



Gadishulli Arabik

Si kanë qenë kushtet natyrore në Gadishullin Arabik?

PARAQITJA DHE PËRHAPJA E ISLAMIT

Për bashkimin e arabëve, me rëndësi të madhe është paraqitja e religjionit të ri i quajtur islam, themelues i të cilit ka qenë Muhamedi (570-632). Feja e re të cilën e ka predikuar Muhamedi, ka qenë besim në një zot Allah, profeti - i dërguari i të cilit në tokë ka qenë ai. Ithtarët e islamit, janë quajtur mysliman. Mësimi muhamedan më vonë është paraqitur në Kuran (libri i shenjtë islam). Prej besimtarëve të vet, islami ka kërkuar rituale të caktuara fetare: lutje pesë herë në ditë, agjërim të Ramazanit, dhënie lëmoshë, shkuarja në haxh në Mekë së paku një herë gjatë jetës.

Për shkak të konfliktit me aristokracinë në Mekë, në vitin 622 Muhamedi ka qenë i detyruar të shpërngulet prej Meke në Medinë. Atë vit, myslimanët e quajnë hixhra, dhe vitet

*Faqe të Kuranit*

i numërojnë prej atëherë. Pasi që mësimi i Muhamedit është përforcuar dhe është përhapur edhe në Medinë, Muhamedi, me ithtarët e vet e ka pushtuar Mekën, me ç'rast është bërë lideri shpirtëror dhe i përgjithshëm i shtetit të ardhshëm Arabik.

Çka paraqet islami?

ZGJERIMI I SHTETIT ARAB

Pas vdekjes së Muhamedit, me shtetin arabik kanë udhëhequr trashëguesit e tij - kalifët, Abu Bekir, Omar, Osman dhe Ali. Dy kalifët e parë jo vetëm që e kanë bashkuar botën arabe por, kanë arritur që dukshëm ta zgjerojnë territorin arabik. Në fillim, arabët e kanë pushtuar Sirinë, Palestinën, Persinë, mandej edhe Mesopotaminë dhe Egjiptin. Pas vdekjes së Omarit, në Arabi ka ardhur deri tek luftërat e dinastive në të cilat ka fituar dinastia Umajjad. Ata e kanë zhvendosur kryeqytetin prej Meke në Damask dhe kanë sunduar me Arabinë prej vitit 661 deri në vitin 750. Në atë periudhë, Arabët e kanë pushtuar pjesën më të madhe të Azisë së Vogël, të Gjeorgjisë ndërsa kanë depërtuar deri në Azinë e Mesme, deri në lumin Ind. Në përfundim, ata e kanë pushtuar tërë Afrikën Veriore, dhe e kanë pushtuar edhe Gadishullin Iberik në Evropë.

Me ndihmën e hartës, ndiqe zgjerimin e Shtetit arabik.

DOBËSIMI SHE SHKATËRRIMI I SHTETIT ARAB

Luftërat e brendshme dhe përbërja e ndryshme e popullsisë, e kanë dobësuar shtetin. Në shekullin VIII, shteti arabik veç më ishte shpërbërë në dy pjesë: Në Kalifatin e Bagdadit dhe Kordit. Dobësimi i shtetit ka vazhduar edhe në dy shekujt në vijim, me ç'rast janë veçuar dhe janë pavarësuar shtete myslimane prej të cilave janë formuar Maroku, Egjipti, Siria si edhe vendet në Azinë e Mesme. Në mesin e shekullit XI, Turqit Selxhukë e kanë pushtuar Bagdadin dhe me këtë i kanë vënë fund

*Shteti Arab*

TEMA 3

ekzistimit të Kalifatit të Bagdadit. Kalifati i Kordit, në shekullin XI është shpërbërë në më shumë shtete. Pozitën e këtillë e kanë shfrytëzuar spanjollët dhe në vitin 1492 e kanë pushtuar Kalifatin e Kordit.

Cilat kanë qenë arsytet për dobësimin e shtetit arabik?

KULTURA E ARABËVE

Pas bashkimit të botës arabe nga Muhamedi dhe pushtimi i më shumë vendeve në Azi, në Afrikë dhe Evropë, ka ardhur deri në zhvillimin e përshpejtuar të kulturës arabe. Nën ndikimin e religjionit islam, është ndërtuar stil arkitektonik origjinal. Ai ka ardhur veçanërisht në shprehje në tempujt e ndërtuar madhështorë, të quajtur xhami. Përmendore më e bukur e arkitekturës arabike paraqet Xhamia në Kordobë, në Spanjë. Prej ndërtimeve tjera, dallohen pallatet në Seville dhe në Grenadë. Në frymën e arkitekturës islame janë ndërtuar edhe shumë ndërtime tjera: pallate, banja, shtëpi etj. Të gjitha këto kanë qenë të stolitura në mënyrë të pasur me ornamente - arabeska.

Në frymën e islamit është zhvilluar edhe letërsia e pasur arabe. Në gjuhën arabe janë shkruar një numër i madh i veprave origjinale letrare. Veçanërisht ka qenë e popullarizuar përmbledhje e tregimeve *Një mijë e një net*, e cila është përkthyer në më shumë gjuhë të tjera.

Arritje të rëndësishme shkencore arabët kanë pasur edhe në fushën e filozofisë, të astronomisë, të medicinës, gjeometrisë etj. Filozofët arabë i kanë njohur në mënyrë të shkëlqyeshme veprat e Aristotelit dhe të filozofëve të tjerë helen. Filozofi më i njohur arab ka qenë Avicena, i cili gjithashtu e ka njohur edhe medicinën.

Arabët, kanë treguar interes të madh për matematikën. Ata e kanë përkryer aritmetikën, gjeometrinë dhe astronominë. Prej indusëve i kanë marrë shifrat dhe i kanë përkryer me shtimin e zeros. Arabët e kanë çmuar shumë astronominë dhe të parët kanë filluar të bëjnë dallim ndërmjet vitit diellor dhe lunar.



Xhami

PERANDORIA LINDORE ROMAKE (BIZANTI)

FORMIMI I PERANDORISË BIZANTINE

Në vitin 395 Perandoria Romake u nda në dy pjesë, të cilat gjatë shekullit V janë formuar si shtete të veçanta. Perandoria Romake Lindore (Bizanti), me kryeqytetin në Konstantinopojë dhe Perandoria Romake Perëndimore me kryeqytetin në Romë. Konstantinopoja e cila ka qenë e ndërtuar sipas shembullit të Romës së vjetër, e ka imituar në gjithçka dhe prandaj emërtohej si Roma e Re. Edhe vetë Bizanti e ka llogaritur si vazhduese të Perandorisë Romake. Ndërsa emërtimet Bizanti dhe Bizantinët, të fituar sipas emrit të qytezës Bizantion, janë imponuar shumë më vonë në përdorim. Bizanti, edhe pse e ka ruajtur dhe e ka kultivuar civilizimin dhe kulturën heleno-romake, përsëri, ai ka qenë edhe qendër krishtere.

Si është formuar Perandoria Bizantine?



Bizanti në kohën e Justinianit I

TERRITORI DHE POPULLSIA

Që nga shekujt e parë të ekzistimit të vet, Bizanti është shtrirë në tre kontinente: aziatik, evropian dhe afrikan. Në kuadër të Bizantit atëherë kanë bërë pjesë Gadishulli Ballkanik, Afrika Veriore, Egjipti, Siria, Palestina, një pjesë e Mesopotamisë, pjesë të Arabisë, Azia e Vogël, një pjesë e Armenisë, bregdeti i Detit të Zi, Kaukazi dhe Gadishulli Krim.

Në Bizanti kanë jetuar popuj të ndryshëm: trakë, ilirë, grekë, maqedonas, koptë, sirianë, hebrenj, armenë, gjeorgjianë, etj. Gjuha zyrtare në fillim ka qenë gjuha latine, pastaj ajo helene. Në krye të Bizantit ka qenë mbreti (perandori). Ai ka pasur pushtet të pakufizuar dhe është mbështetur në nëpunësit e shumtë, në armatën dhe kishën. Perandori është konsideruar si person i shenjtë, dhe e kanë respektuar si zot. Profesionin kryesor i popullsisë në Bizanti ka qenë bujqësia. Bizanti, ka mbajtur lidhje tregtare si me Kinën dhe Indinë në Lindje, ashtu edhe me popujt në Evropë. Falë të hyrave shumë të mëdha që i ka realizuar, Bizanti ka mundur të ketë në dispozicion armatë dhe flotë të madhe, me të cilat i ka mbrojtur kufijtë e shtetit të vet.

Në cilat territore është shtrirë Perandoria Bizantine?

BIZANTI NË KOHËN E JUSTINIANIT I

Kulmin në zhvillimin e vet Bizanti e ka arritur në kohën e Justinianit I (527-565). Në atë kohë, popullsia fshatare dhe qytetare e ngarkuar me tatime dhe detyrime të ndryshme, ka filluar gjithnjë e më shumë të ngrihet në kryengritje. Prej të gjitha kryengritjeve kundër pushtetit të Justinianit, më masovike ka qenë kryengritja e ngritur nga popullsia e Konstantinopojës në vitin 532, e njohur me emrin „Nika” („Fito”).

Pas rregullimit të gjendjes së brendshme, Justiniani I i ka filluar pushtimet e tij për ripërtëritjen e Perandorisë Romake. Kështu, në vitin 555, Justiniani I i ka pushtuar Mbretërinë Vandale në Afrikën Veriore dhe Mbretërinë Ostrogote (Mbretëria Lindore Gotike) në Itali. Pastaj ka luftuar me Vizigotët në Spanjë dhe e ka pushtuar pjesën juglindore të Gadishullit Iberik. Por, përveç luftërave pushtuese, Justiniani I ka qenë i detyruar ta mbrojë Bizantin nga sulmet e armiqve të jashtëm, siç kanë qenë sllovenët, Mbretëria persiane, avarët dhe të tjerë. Për ta mbrojtur Gadishullin Ballkanik nga sulmet e sllovenëve dhe fiseve tjera



Mbreti Justinian



Mbretëresha Teodora

barbare. Justiniani i ka ripërtërirë objektet kufitare përkaj Danubit dhe ka ndërtuar edhe shumë të tjera. Në vitin 558, Justiniani I ka emëruar komision juristësh me detyrë të përpilojë një përmbledhje ligjesh të cilat do të vlejnin në tërë territorin e perandorisë. Ajo përmbledhje e ligjeve ka përmbajtur akte ligjore nga të gjitha fushat e drejtësisë, dhe e ka marrë emrin Kodi i Justinianit. Në afërsi të vendlindjes së tij Taurision (Taor), perandori e ka ndërtuar qytetin Justiniana Prima, i cili ka përfaqësuar seli administrative dhe kishtarë e Peshkopatës me emër të njëjtë.

*Në cilat territore është zgjeruar Bizanti në kohën e sundimit të Justinianit I?
Hulumto dhe mëso! Si është dukur Justiniana Prima sipas përshkrimit të historianit bizantin Prokopij Kesariski?*

DOBËSIMI DHE SHKATËRRIMI I SHTETIT BIZANTIN

Pas vdekjes së Justinianit I, Bizanti ka filluar të dobësohet me shpejtësi. Përveç kryengritjeve të shumta të popujve të nënshtruar, Bizantin vazhdimisht e kanë sulmuar edhe armiq të jashtëm. Pushteti mbretëror është dobësuar edhe nga ndryshimet e shumta në Konstantinopojë. Prej fundit të shekullit IV deri në rënien e shtetit në vitin 1453, kanë sunduar 109 perandorë, prej të cilëve vetëm 34 e kanë mbajtur pushtetin deri në vdekje. Gjatë Kryqëzatës së Katërt (1202-1204), pjesëtarët e kryqëzatave e kanë pushtuar Konstantinopojën dhe e kanë anuluar Perandorinë Bizantine, e cila është ripërtërirë në vitin 1261. Kah fundi i shekullit XIII, Bizanti është ballafaquar me sulmet e Turqve (Osmanli), të cilët kanë filluar t'i pushtojnë së pari okupimet bizantine në Azinë e Vogël, kurse në vitin 1453, Osmanlinjtë e kanë pushtuar edhe Konstantinopojën. Me këtë, përfundimisht është shkatërruar Perandoria Bizantine.

Si është shkatërruar Perandoria Bizantine?


KULTURA BIZANTINE

Në mesjetën e hershëm, Bizanti ka qenë qendra më e madhe kulturore në Evropë. Ai është formuar mbi themelet e kulturës antike. Për zhvillimin e kulturës, ka kontribuar shumë edhe tregtia e zhvilluar. Për mbajtjen marrëdhënieve tregtare dhe diplomatike me vendet tjera, ai ka pasur nevojë për shumë njerëz të arsimuar. Për këtë arsye, për arsimin nuk është kujdesur vetëm kisha, por edhe tregtarët dhe zejtarët. Në shumë shkolla, përveç leximit dhe shkrimit, është mësuar edhe aritmetika, gjeografia dhe veprat e shkrimtarëve të lashtë antikë. Shkolla më e lartë ka qenë shkolla Magnaure, e hapur në Konstantinopojë që në shekullin VI.

Letërsia në Bizant ka qenë nën ndikimin e fortë të kishës. Shumë ka qenë i përhapur shkrimi i jetëshkrimit të shenjtoreve. Por shkenca e historisë e ka mbajtur vendin më të rëndësishëm. Historianët bizantinë, japin shumë të dhëna për Bizantin në kohën e Justinianit dhe ithtarëve të tij si edhe për sllovenët. Në Bizant, ka qenë shumë e zhvilluar ndërtimtaria. Ndërtimet më të bukura kanë qenë kishat dhe pallatet e perandorëve. Shumica e kishave janë ndërtuar në stil të ri, të quajtur stil bizantin. Në të kanë dominuar kupolat dhe harqet mbi dyert dhe dritaret. Përmendorja më e bukur e ndërtimitarisë bizantine është kisha Shën Sofja në Stamboll, e ndërtuar në kohën e Justinianit. Sipas madhësisë dhe bukurisë së vet, ajo i ka tejkaluar të gjitha ndërtimet e asaj kohe. Muret e brendshme kanë qenë të dekoruara me mozaikë dhe freska me ngjyra të ndryshme. Me ardhjen e Turqve-Osmanli në Stamboll, kisha është shndërruar në xhami ndërsa freskat janë lyer me ngjyrë sipër.

Kultura bizantine ka pasur ndikim të fuqishëm mbi zhvillimin e kulturës dhe jetës kulturore të gjithë popujve në Evropë. Mbretërit, princat dhe peshkopët nga Evropa, i kanë ndërtuar kohë të gjatë dhe i kanë dekoruar kishat sipas modelit të pallateve dhe kishave bizantine.

Me çka ka të bëjë kultura e zhvilluar në Bizant?



Brendia e kishës Shën Sofja në Stamboll



Shën Sofja në Stamboll

EVROPA LINDORE

SLLAVËT PERËNDIMORË

LIDHJA FISNORE SAME

Lidhja fisnore same paraqet Bashkësinë politike të parë të Sllavëve Perëndimorë që ka ekzistuar në gjysmën e parë të shekullit VII (623-658). Formimi i saj ka qenë kushtëzuar nga nevoja për mbrojtje nga Avarët, a më vonë edhe nga Bavarët, përkatësisht Frankët, si edhe nga paraqitja e diferencimit pronësor që është krijuar te Sllovenët Perëndimorë. Qendra e krijimit të tij ka qenë territori i Çekisë, të cilës i janë bashkëngjitur edhe fiset sllovene në Moravi dhe në Sllovaki. Më vonë, kësaj lidhjeje i janë bashkëngjitur edhe fiset sllave në Alpet Lindore dhe në Panoni. Pas vdekjes së princit Samo, lidhja është shpërbërë. Përkatësisht, me përhapjen e krishterimit dhe gjermanizimin në vendet e përmendura sllave, ato e kanë humbur pavarësinë e vet dhe janë bërë vasalë në fillim të sundimtarëve frankë, e më vonë të atyre gjermanë.

Si është formuar Lidhja fisnore Same?

MORAVIA E MADHE

Në procesin e luftës kundër kolonizimit gjerman dhe në përgjithësi kundër fushatave ushtarake pushtuese gjermane, në



Pagëzimi i rusëve

fillim të shekullit IX, është formuar lidhje e re fisnore e cila është shndërruar në Mbretërinë e Moravisë së Madhe. Ajo është formuar nën udhëheqjen e sllavëve të



Mbreti Rostislav

Moravisë, e të cilëve u janë bashkëngjitur edhe sllavët në Çeki. Pavarësi të caktuar kanë krijuar sllavët Pollap dhe Priballtik. Sundimtari më i rëndësishëm i Principatës së Moravisë së Madhe ka qenë princi Rostislav. Ai, me qëllim që ta përforcojë pavarësinë e principatës, ka kërkuar nga Bizanti predikues për ta përhapur mësimin fetar në gjuhën sllave. Mbreti Bizantin Mihaili III, për këtë qëllim i ka dërguar në Moravinë e Madhe, Kirilin dhe Metodin.

TEMA 3

Si rezultat i përhapjes së krishterimit në gjuhën sllave, ata në Moravi kanë arritur të formojnë kishë të veçantë sllave. Feudalët gjermanë, si dhe kleri i madh gjerman kanë qenë kundër përhapjes së krishterimit në gjuhën sllave, dhe me këtë, edhe kundërshtues të pavarësisë së Moravisë së Madhe. Ata kanë ndërmarrë fushata ushtarake pushtuese të reja, për shkak të së cilave në fillim të shekullit X, kjo principatë është shpërbërë.

Pse Kirili dhe Metodi janë ftuar në Moravinë e Madhe?



Princi Vlladimir

SHTETI I ÇEKISË

Në gjysmën e dytë të shekullit XI, u formua edhe shteti i Çekisë. Fiset sllave në Çeki, të cilat në fillim kanë qenë në përbërje të Lidhjes fisnore Same, e pastaj në kuadër të shtetit të Moravisë së Madhe edhe në marrëdhënie vasale të mbretërve gjermanë në fillim të shekullit XI, kanë filluar të pavarësohen. Princat e tyre të cilët në atë kohë e kanë pranuar pushtetin suprem të mbretërve gjermanë, janë rritur gjithnjë e më shumë. Në gjysmën e dytë të shekullit XI, princi Çek Vratosllavi, e ka shfrytëzuar pozitën e rëndë të mbretit gjerman Henrih IV, për shkak të luftërave të brendshme, e ka detyruar ta pranojë pavarësinë e shtetit Çek në kuadër të Perandorisë Gjermane. Atëherë, princi çek është pranuar për mbret ndërsa Çekia për Mbretëri.

SHTETI POLONEZ

Pothuajse në kohën e njëjtë është formuar edhe shteti i parë i sllavëve në Poloni. Përkatësisht, në mesin e shekullit X, princi Meshko i ka bashkuar fiset sllave të cilët kanë jetuar përgjatë rrjedhës së lumit Vislla në Poloni. Gjatë fushatave ushtarake të ardhshme, nën pushtetin e tij kanë rënë edhe fise të tjera poloneze, edhe pse edhe ai vetë e ka pranuar pushtetin suprem të mbretit gjerman. Trashëgimtari i tij, Bolesllavi Guximtar, ka arritur që Poloninë ta çlirojë nga varësia e mbretërve gjermanë. Në vitin 1000, në Poloni është formuar Peshkopata Autonome Poloneze e cila ka qenë drejtpërdrejt e ndërlidhur me Papën. Për ta përforcuar pushtetin, kishës dhe aristokracisë u ka dhuruar prona dhe privilegje. Para përfundimit të jetës, Bolesllavi është shpallur mbret. Pas vdekjes së tij, Polonia ka filluar të dobësohet, pas së cilës së shpejti ka rënë nën pushtetin gjerman.

Sqaroje procesin e formimit të shtetit çek dhe polonez.

SLlavËT LINDORË

RUSIA E KIEVIT

Sllavët që janë vendosur në territorin ndërmjet lumenjve Dvina Perëndimore dhe Bug, mandej nëpër rrjedhën e sipërme të lumenjve Volga dhe Oka dhe liqenin Ladoga deri në territorin e Dnjeprit dhe Detit të Zi, janë quajtur Ante, përkatësisht sllavë Lindorë. Më vonë, gjatë shekullit IX, për ta është përcaktuar emri rusë, ndërsa vendi i tyre është emëruar Rusi.



Sh.Sofja në Novgorod

Në periudhën e shekullit VII dhe VIII, te sllavët Lindorë vjen deri në përforcimin e shtresimit shoqëror. Tregtia, veçohet nga bujqësia dhe blegtoria dhe krijohen qendra qytetare të caktuara të cilat kanë fituar gjithnjë e më shumë rëndësi ekonomike. Më të njohurit ndërmjet tyre kanë qenë Kievi dhe Novgorodi. Nëpërmjet tyre, janë mbajtur lidhjet tregtare me Bizantin dhe me vendet tjera. Në vend të lidhjeve fisnore të vjetra jostabile, janë formuar principata më të qëndrueshme. Gjatë shekullit IX, krijohet Principata e Novgorodit, ushtria e të cilës nën udhëheqjen e princit Rurik i dëbon me sukses fushatat grabitqare të Varjagëve, fiset

nomade nga Skandinavia. Kah fundi i shekullit të njëjtë, lind Principata e Kievit e formuar nën udhëheqjen e princit Oleg.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit X, Rusia e Kievit e arrin pushtetin më të madh. Olegu e ka sulmuar Stambollin me ç'rast me Bizantin ka lidhur marrëveshje të volitshme tregtare. Rusia e Kievit është bërë edhe faktor i rëndësishëm ndërkombëtar për arsye se atëherë ka mbajtur lidhje tregtare dhe diplomatike me Bizantin dhe me vendet tjera evropiane.

Në këtë kohë, në Rusinë e Kievit, nëpërmjet Bizantit është përhapur krishterimi. Në vitin 988, princi Vlladimir e ka pranuar krishterimin nga Bizanti, e ka pagëzuar popullin e vet dhe është martuar me motrën e mbretit bizantin. Në fillim të shekullit XI, në fronin e principatës në Rusinë e Kievit është ulur Jarosllav i Mençuri (1019-1054). Gjatë sundimit të vet, Rusia bashkë me Bizantin ka qenë shteti më i fuqishëm në Lindje. Gjithashtu, nën udhëheqjen e tij ka filluar puna dhe hartimi i përmbledhjes së parë të ligjeve ruse – Drejtësia ruse. Pas vdekjes së tij, shteti ka filluar të dobësohet. Në vitin 1240, mongolët kanë depërtuar në territorin e Rosisë së Kievit, e me këtë e ka humbur pavarësinë e vet.

Prej kujt e ka pranuar krishterimin princi Vlladimir?

EKSPEDITAT E KRYQËZATAVE

ARSYET DHE SHKAKU

Gjatë shekullit XI, ekonomia natyrale ka filluar të kalojë në ekonomi malli-monedhe. Atëherë, tregtarët nga Evropa Perëndimore kanë shkuar në Lindje dhe anasjelltas, duke blerë dhe duke shitur prodhime të ndryshme. Tregtarët evropianë dhe njerëzit kishtar të cilët kanë shkuar në lindje, kanë hasur në qytete të pasura dhe luksoze, kulturë më të zhvilluar, vende të pabanuara. Pas kthimit nga Lindja, atë që e shikan ua kanë treguar bashkëvendësve të tyre. Kjo ka shkaktuar te ata dëshirë dhe synim për pushtimin e vendeve të Lindjes. Pozita e Lindjes ka premtuar fitim të madh. Si shkak për ekspeditat e kryqëzatave ka shërbyer depërtimi i turqve selxhukë në Azinë e Parme dhe rënia e Jerusalemit nën pushtetin e tyre. Papa Urban II, në sinodin në Klermon i ka ftuar peshkopët, fisnikët dhe popullin e shumtë në ekspeditë kryqëzate. Kisha, në krye me papën ka shikuar mundësi për zgjerimin e ndikimit të vet në Lindje, që e ka humbur në vitin 1054, pas ndarjes së kishës. Prandaj e ka marrë iniciativën në duar të veta dhe kryqëzatave u ka dhënë karakter fetar.



Kryqëzatës

Cilat kanë qenë arsyet për luftërat e kryqëzatave?

FILLIMI DHE RRJEDHA E LUFTËRAVE TË KRYQËZATAVE

Përveç kishës, për pjesëmarrje në luftërat e kryqëzatave kanë qenë të interesuar edhe baronët me qëllim që të rrëmbejnë toka, kalorësit janë nisur pas pasurive dhe aventurës ndërsa fshatarët e varfër për të shpëtuar nga varfëria. Sipas kryqeve të qëndisur në veshjet, pjesëmarrësit janë emëruar kryqëzatës, ndërsa luftërat kryqëzata.

Kryqëzata e parë ka filluar në vitin 1096. Nën udhëheqjen e Petar Pustnik, ushtria e kryqëzatës e përbërë nga fshatarët e varfër nga Evropa Perëndimore, nëpërmjet Hungarisë dhe Gadishullit Ballkanik ka arritur në Stamboll. Në Azinë e Vogël, kryqëzatësit kanë përjetuar disfatë nga turqit-selxhukë. Vitin e ardhshëm, ushtri kryqëzatesh mirë të organizuara të feudalëve të mëdhenj dhe të kalorësve, të udhëhequr nga grofi francez Rajmond Tulluski,

nëpërmjet Maqedonisë dhe Trakisë kanë arritur në Stamboll. Pas luftërave disavjeçare, kryqëzatësit e kanë pushtuar Jerusalemin. Në territoret e pushtuara në Siri dhe në Palestinë, kryqëzatësit e kanë formuar mbretërinë e Jerusalemit dhe disa shtete më të vogla të kryqëzatave.

Për t'i mbrojtur dhe për t'i mbajtur përfitimet nga Kryqëzata e Parë, mbreti francez Lui VII dhe mbreti gjerman Konrad III, kanë organizuar Kryqëzatë të Dytë (1147-1149), e cila nuk ka dhënë pothuajse asnjë rezultat. Pas 90 viteve, turqit-selxhukë e kanë pushtuar Jerusalemin dhe e kanë shkatërruar Mbretërinë e Jerusalemit.

Kryqëzata e tretë (1189-1196), është bërë me qëllim që të çlirohet Jerusalemi. Në luftë kanë marrë pjesë ushtri nga Franca, Anglia dhe Gjermania, të udhëhequr nga sundimtarët e tyre. Pasi që perandori i Jerusalemit i ka transferuar kryqëzatësit në Azinë e Vogël, ata nuk kanë arritur ta çlirojnë Jerusalemin.

Si është bërë Kryqëzata e Parë?



Pushtimi i Jerusalemit në vitin 1099

KRYQËZATA E KATËRT

I pa pajtuar me disfatën, papa i atëhershëm romak, Inokentij III, ka organizuar Kryqëzatë të Katërt (1202-1204). Ajo, në vend të çlirimit të Varrezës së Zotit në Jerusalem, është drejtuar drejtpërdrejt kah pushtimi i fronit bizantin, Stambollit. Në vitin 1204, kryqëzatësit e kanë rrethuar me anije qytetin dhe pas luftërave të ashpra rrugore e kanë pushtuar. Njëkohësisht, kryqëzatësit e kanë pushtuar edhe një pjesë të madhe të Perandorisë Bizantine, ku është themeluar Mbretëria e Re Latine, me seli në Stamboll. Qyteti i Selanikut përsëri është bërë selia e Mbretërisë së Selanikut. Janë formuar edhe shtete të tjera më të vogla të kryqëzatave në Ballkan. Tek në vitin 1261, pas rënies së Mbretërisë Latine është ripërtërirë Perandoria Bizantine.



Ushtria e kryqëzatësve të Petar Pustinjak

Kisha katolike ka filluar ta përhapë mendimin se njerëzit mëkatarë asnjëherë nuk do të mundën t'i çlirojnë vendet e shenjta. Këtë do të mund ta bënin vetëm fëmijët e pafajshëm. Nën ndikimin e mendimit të atillë, në vitin 1212, në Gjermani dhe në Francë kanë filluar të organizojnë Kryqëzata fëmijësh. Edhe kjo fushatë ka përfunduar në mënyrë katastrofale për kryqëzatësit. Në shekullin XIII janë organizuar edhe disa ekspedita të cilat gjithashtu kanë përfunduar me disfatë dhe me pasoja të rënda.

Kundër kujt është drejtuar Kryqëzata e Katërt?



Shtete kryqëzatash të formuara me Luftën e parë të kryqëzatave

PASOJAT NGA LUFTËRAT E KRYQËZATAVE

Luftërat e kryqëzatave nuk e kanë arritur qëllimin e parashtruar. Kryqëzatësit nuk i kanë mbajtur vendet e pushtuara në Lindje. Megjithatë, ato janë të rëndësishme për atë se janë përforcuar lidhjet tregtare me Lindjen, janë zhvilluar më shumë qytete tregtare të Evropës perëndimore (Venediku, Xhenova etj.), me ç'rast është rritur numri i popullsisë qytetare. Mbretërit në shtetet e Evropës perëndimore, duke i përvetësuar vendet e feudalëve të vdekur dhe të kalorësve, kanë krijuar monarki unike feudale me pushtet të fuqishëm qendror. Kryqëzatësit janë njoftuar me kulturën bizantine dhe arabe dhe e kanë bartur në Evropë. Kanë bartur edhe shumë bimë dhe prodhime si: pambuku, orizi, limoni, shalqiri etj., pastaj mëndafshin, stolitë, mëlmesa, ngjyra dhe janë njoftuar me zeje të ndryshme. Në disa qytete në Lindje, tregtarët e Evropës perëndimore kanë themeluar koloni të veta tregtare dhe kanë zotëruar me tregtinë në Detin Mesdhe. Me zhvillimin e tregtisë, zhvillohet komunikacioni detar dhe tokësor. E gjithë kjo ka kontribuar për zhvillimin shoqëroro ekonomik dhe kulturor edhe më të madh në Evropë.

Cilat janë pasojat nga luftërat e kryqëzatave?



Pushtimi i Stambollit

HUMANIZMI DHE RENESANCA

PARAQITJA E HUMANIZMIT

Gjatë shekullit XIV, qytetet italiane-republika janë shndërruar në qendra më të zhvilluara ekonomike dhe kulturore në Evropë. Në to është zhvilluar me shpejtësi tregtia, prodhimtaria manufakturore, bankieria, ndërtimi i anijeve etj. Si rezultat i kësaj, ka ardhur deri në zhvillimin e përshpejtuar të banorëve italianë. Ata kanë jetuar në pallate luksoze, hapësirat dhe oborret e të cilave kanë qenë të mbushura me skulptura dhe me përmendore të tjera. Përveç kësaj, qytetarët e pasur italianë kanë qenë të rrethuar me profesorë, me shkencëtarë dhe me artistë. Ata kanë filluar gjithnjë e më shumë të çlirohen nga këndvështrimet e vjetra (feudale) ndaj botës, me të cilat njeriu orientohet kah arritja e lumturisë *në botën tjetër*. Qytetërimi i pasur italian, duke i shkëputur prangat e tilla feudale, ka filluar gjithnjë e më shumë të kthehet ndaj kultit të arsyes së njeriut dhe ndaj krijimtarisë së njeriut. Në këtë mënyrë, në gjysmën e dytë të shekullit XIV, në Itali është krijuar dhe gradualisht është bërë dominues këndvështrimi i ri i botës, i quajtur humanizëm (sipas fjalës latine humanus-njerëzor).



Petrarka

Pse humanizmi fillimisht është paraqitur në Itali?

RENE SANCA

Si rezultat i këndvështrimit të ri ndaj botës, është bërë kthesa kulturore epokale, që ka mundësuar që të zhvillohet një lëvizje kulturore e gjerë, e njohur si renesancë ose si rilindje. Ky lulëzim i artit dhe i letërsisë ndërmjet shekullit XIV dhe XVI, quhet renesancë. Me



Mikelanxhelo

paraqitjen e humanizmit në Itali, është rritur interesi ndaj studimit të veprave të helenëve të vjetër dhe të shkrimtarëve romakë, si edhe të artistëve dhe skulptorëve antikë.

Zhvillimi i renesancës në Itali ka kaluar nëpër tri etapa. Ai nuk ka qenë i barabartë në qytetet e caktuara dhe disiplinat shkencore dhe artistike. Që në fillim, qyteti i Firences është bërë qendra më e zhvilluar humaniste. Merita të mëdha për këtë ka pasur Universiteti i atjeshëm dhe e a.q. Akademia e Platonit. Në kuadër të universitetit ka ekzistuar edhe kurs për studimin e veprave të filozofit të famshëm helen Aristotelit. Si rezultat i kësaj, në gjysmën e dytë të shekullit XV, në Firenze kanë filluar me shpejtësi të zhvillohen shkencat humanitare. Në bazë të trashëgimisë antike janë krijuar më shumë vepra letrare dhe artistike, me përmbajtje nga jeta reale dhe në frymën e kohës së re rilindëse.

Prej Italie, renesanca është përhapur shpejt edhe

në shumicën e vendeve evropiane. Si rezultat i kësaj, ka ardhur deri në afrimin kulturor më të ngushtë të vendeve dhe popujve të caktuar evropianë.

Çfarë paraqet renesanca?

LETËRSIA, ARTI DHE SHKENCA E RENESANCËS

Zanafillë e renesancës në Itali ka qenë Dante Aligieri. Në veprën e tij kapitale *Komedia hyjnore*, e shkruar në gjuhën popullore italiane, përmbahen mjaft elemente humaniste, të cilat me të drejtë, këtë krijues të madh e ka numëruar në lajmëtarët e renesancës.

Themelues i renesancës konsiderohet Françesko Petrarka. Veprat e tij poetike dhe filozofike janë përplot me përmbajtje për njeriun dhe për jetën e tij. Mendimet e veta Petrarka i ka ndërtuar mbi veprat e shkrimtarëve antikë si Platoni, Aristoteli etj., duke e futur me atë rast frymën e shoqërisë së tij qytetare. Personalitet i rëndësishëm nga kjo periudhë është Xhovani Bokaço i cili ka shkruar përmbledhje me njëqind novela, të përmbledhura në veprën Dekameron.

Letërsia e renesancës përhapet edhe në vendet tjera evropiane, siç kanë qenë Ulrih fon Hutten (Gjermani), Fransoa Rable (Francë), Erazmo i Roterdamit (Holandë), Miguel Servanes (Spanjë), Shekspiri (Angli) etj. Rol të madh në formimin dhe në zhvillimin e humanizmit italian, përveç qytetit të Firences kanë pasur edhe qendrat kulturore Roma, Milanoja, Napoli, Venediku etj.

TEMA 3

Në këto qendra kanë krijuar dhe kanë lënë vepra të veta kapitale një numër i madh i veprimtarëve kulturorë. Ndërmjet tyre, vendin kryesor e kanë mbajtur Leonardo da Vinçi, Mikelnaxheloja, Rafael Santi, Ticiani etj.

Veprat artistike më të njohura të Leonardo da Vinçit janë *Mona Liza* (Xhokonda) dhe *Darka e fundit*. Mikelnaxheloja e ka vizatuar kompozitën në Kapelën Sistine në Vatikan.

Skulptorë të njohur të cilët veçanërisht e kanë studiuar anatominë e trupit, kanë qenë Donatelo dhe Mikelnaxhelo. Donateloja e ka përpunuar skulpturën e Davidit, ndërsa krijimtaria më e rëndësishme e Mikelnaxhelos është skulptura e Moisiut.

Bëni krahasimin ndërmjet pikturës së Mona Lizës dhe freskave të mesjetës.

ZHVILLIMI I SHKENCËS

Në epokën e humanizmit dhe renesancës, dukshëm është përshpejtuar edhe zhvillimi i shkencës. Xhovani Bokaço e ka krijuar romanin e parë psikologjik në letërsinë evropiane; shkrimtari Nikolla Makijaveli, në veprat e tij kapitale është angazhuar që çdo njeri t'i përmbahet realitetit; Tomas Mor, në veprën *Utopia* ka krijuar shtet të trilluar në njërin nga ishujt pa pronësi personale, më vonë për ndërtimin e shoqërisë në bazë të pronësisë kolektive, është angazhuar edhe italianin Tomazo Kampanella.

Pas vitit 1440, kur në qytetin Majnc gjermani Johan Gutenberg e ka zbuluar shtypshkronjën, shkenca dhe arti kanë fituar ecuri edhe më të përshpejtuar në zhvillimin e vet. Kanë filluar të shtypen jo vetëm vepra me përmbajtje bashkëkohore por edhe të shkrimtarëve, filozofëve dhe krijimtarive të tjerë antikë. Njëkohësisht, me këtë janë zbuluar edhe shpikje të reja: kompasit, harta gjeografike dhe të tjera.

Nën ndikimin e humanizmit është bërë depërtim i fuqishëm edhe në zhvillimin e astronomisë dhe fizikës, mbi të cilat shkenca natyrore ka vazhduar të ketë monopol të tërësishëm kisha. Në kundërshtim me qëndrimet kishtarë, shkencëtari polonez Nikolla Koperniku ka ardhur në përfundim se planeti Tokë së bashku me planetët tjerë në qiell lëvizin rrotull Diellit. Teza e atillë, më vonë me zbulimin e instrumenteve të reja astronomike është konfirmuar si e drejtë.

Cilat disiplina shkencore janë zhvilluar në epokën e humanizmit dhe renesancës?



Gutenbergu (shtypshkronja e Gutenbergut)

ZBULIMET E MËDHA GJEOGRAFIKE

ARSYET PËR ZBULIMET GJEOGRAFIKE

Kah fundi i shekullit XV dhe fillimi i shekullit XVI, vjen deri te zbulime të mëdha gjeografike. Ato kanë qenë të kushtëzuar nga përparimi i konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor të Evropës Perëndimore. Atëherë edhe tregtarët evropianë e kanë rritur tregtinë me Lindjen e Afërme, kanë blerë mallra që nga India dhe Kina (mëlmesa, stoli, mëndafsh etj.). Mirëpo, ato nuk kanë shkuar në Indi dhe në Kinë, por mallin e kanë riblerë nga tregtarët arabë shumë shtrenjtë. Me qëllim që ta evitojnë ndërmjetësimin, tregtarët dhe sundimtarët nga vendet mesdhetare veç më kanë menduar se si të vijnë në Indi me rrugë detare. Kërkimi i rrugës detare për në Indi veçanërisht është përshpejtuar kur Turqit-Osmanli e kanë pushtuar Lindjen e Afërme dhe Gadishullin Ballkanik dhe e kanë ndërprerë rrugën nëpërmjet Azisë së Vogël dhe Sirisë.

Përparimi teknik asokohe ka dhënë mundësi për ndërmarrjen e udhëtimeve të largëta detare. Detarët veç më e kanë përdorur kompasin dhe anijet më të mëdha karavele. Asokohe, Toskaneli, gjeografi nga Firencja ka mësuar se Toka ka formën e topit dhe ka përpiluar hartë



Zbulimet e mëdha gjeografike



Njëra nga karavelet e Kristofer Kolumbos

të botës. Në të Indinë e ka zhvendosur në anën tjetër të Oqeanit Atlantik. Kjo e ka nxitur Kristofer Kolumbon të nisët në rrugë për në Indi.

Cilat kanë qenë arsyet për zbulimet gjeografike?

ZBULIMI I AMERIKËS

Kristofer Kolumbo ka qenë i biri i një endësi nga Xhenova. Që nga djalëria është bërë detar dhe ka besuar se Toka ka formën e topit. Kur është njoftuar me hartën e re të botës, Kolumboja ka vendosur ta zbulojë rrugën e re për në Indi, duke lundruar në drejtimin perëndimor. Me ndihmën e mbretëreshës spanjolle Izabela, Kolumboja mori tre karavela dhe 90 detarë dhe në verën e vitit 1492 ka lundruar nga Spanja dhe pas 43 ditëve të udhëtimeve të gjata dhe të rënda, ekspedita ka mbërritur deri në ishullin San Sallvador. Pas zbulimit të ishujve Haiti dhe Kuba, Kolumboja është kthyer në Spanjë me bindjen se e ka zbuluar rrugën e re për në Indi. Kolumboja nuk ka ditur se ndërmjet Evropës dhe Azisë gjendet kontinenti i ri. Ai ka organizuar edhe tre udhëtime, por deri në fund të jetës së vet ka besuar se e ka zbuluar bregun lindor të Indisë. Prandaj edhe banorët lokal në vendet e zbuluara i ka quajtur indianë.

Më vonë udhëpërshkruesi italian Amerigo Vespuçi, duke udhëtuar nëpër vendet e njëjta, ka konstatuar se Kolumboja ka zbuluar kontinent të ri të pazbuluar deri atëherë. Kontinenti i ri e ka fituar emrin e tij Amerika.

Si ka ardhur deri te zbulimi i Amerikës?

ZBULIMI I RRUGËS DETARE PËR NË INDI

Kristofer Kolumbo

Derisa Kolumboja e ka kërkuar rrugën e re për në Indi, duke lundruar në drejtimin perëndimor, detarët portugezë kanë pasur qëllim të njëjtë - ta gjejnë Indinë, por duke lundruar në drejtimin lindor. Në gjysmën e dytë të shekullit XV, lundërtari portugez Diaz, duke lëvizur përreth Afrikës ka ardhur deri në pjesën e saj jugore dhe ka ndaluar në kepin e atjeshëm i cili është quajtur Kepi i Shpresës së Mirë. Me këtë nuk ka pushuar interesi i Portugezëve për Indinë. Në vitin 1498, lundërtari Vasko de Gama është nisur në rrugën e Diazit, i ka shkuar përreth Afrikës, ka kaluar nëpër Oqeanin e Indisë. Kështu, ai i pari nga lundërtarët ka arritur ta zbulojë rrugën detare për në Indi.

Si është zbuluar rruga detare për në Indi?

UDHËTIMI I PARË RRETH BOTËS

Pas zbulimit të Amerikës dhe rrugës detare për në Indi, lundërtarët nuk kanë pushuar me eksplorime të reja të botës së panjohur. Kështu, në vitin 1519, lundërtari portugez Fernando Magelani, i cili ka qenë me shërbim në Spanjë, e ka filluar udhëtimin e vet të parë rreth botës. Me ekspeditën e përbërë prej pesë anijeve dhe ekipit prej 265 detarëve është nisur për në Spanjë. Në fillim, ka lundruar nëpër Oqeanin Atlantik nëpër rrugën e Kolumbos, mandej nëpër bregun e Amerikës Jugore dhe ka mbërritur deri në pjesën e saj më jugore duke hyrë përmes tij në Oqeanin Paqësor. Pas disa muajsh udhëtimi në det të hapur, duke duruar etje dhe uri, kanë arritur deri në Ishujt Filipine. Këtu, Magelani është vrarë në një përleshje me vendasit. Ekspedita e tij e ka vazhduar rrugën rreth Azisë dhe Afrikës. Pas tre vitesh të udhëtimit (1519-1522), me ekipin e mbetur prej vetëm një anije dhe 18 detarë, është kthyer prapa në Spanjë. Kështu ka përfunduar udhëtimi i parë rreth Tokës. Me këtë, edhe në mënyrë praktike është konfirmuar interpretimi shkencor se Toka ka formë të rrumbullakët.

Përshkruaje udhëtimin e parë rreth botës?



Fernando Magellan



Vasko de Gama

PASOJAT NGA ZBULIMET GJEOGRAFIKE DHE RËNDËSIA E TYRE

Që nga fillimi i shekullit XVI, ka filluar kolonizimi i vendeve dhe popujve të botës së re. Shumë njerëz nga Evropa, a veçanërisht kalorësit e varfëruar spanjollë, lakmues për pasurim të shpejtë, kanë organizuar ekspedita pushtuese. Ata kanë ndërhyrë në Amerikën Qendrore dhe Jugore, në vendet që i ka zbuluar Kolumboja. Pushtuesi spanjollë, Fernando Kortezi, në vitin 1521 e ka pushtuar Meksikën dhe e ka shkatërruar shtetin e Actekëve. Një pushtues tjetër spanjoll, Francisko Pizaro në vitin 1531, e ka pushtuar Perunë dhe e ka pushtuar shtetin e Inkëve të atjeshëm. Pushtuesit spanjollë, popullsinë vendase e kanë shndërruar në robër, ndërsa vendet e porsazbuluara janë shndërruar në koloni.

Pas zbulimit të rrugës detare për në Indi, Portugezët të parët kanë filluar të formojnë koloni të veta në Indi dhe në Kinë. Portugezët, pushtime koloniale kanë bërë edhe në Amerikën Jugore. Pronarët kolonialë kanë sjellë nga kolonitë e pushtuar ar, argjend dhe gurë të tjerë të çmuar. Spanjollët dhe Portugezët nga Amerika dhe nga Evropa kanë sjellë edhe kultura të reja të panjohura: patate, misër, duhan, groshë dhe të tjera. Nga ana tjetër, në Amerikë janë çuar më shumë shtazë shtëpiake: kuaj, lopë, dhen dhe të tjera, si edhe disa bimë të cilat nuk kanë ekzistuar atje, siç janë : pambuku, frutat e ndryshme dhe të tjera.

Zbulimet gjeografike kanë kontribuar që të zhvillohet më shpejt tregtia dhe ekonomia me mall – para. Qytetet përreth bregut të Evropës perëndimore janë bërë qendra të mëdha tregtare. Procesi i akumulimit fillestar të kapitalit dhe zhvillimi i borgjezisë janë zhvilluar me ritëm më të shpejtë.

Si pasojë e zbulimeve të mëdha gjeografike ka qenë edhe zhvendosja e rrugës tregtare detare prej Detit Mesdhe deri në Oqeanin Atlantik. Kjo ka shkaktuar rënie të vendeve në Evropën Jugore, veçanërisht qytezat italiane Venediku dhe Xhenova.

Çfarë rëndësie kanë zbulimet e mëdha gjeografike për Evropën?



Kolumbon në tokë e mirëpresin vendasit

ROLI I KISHËS NË EVROPËN PERËNDIMORE**ROLI I KISHËS NË EVROPËN PERËNDIMORE**

Deri në fillim të shekullit IV shteti romak ka pasur marrëdhënie armiqësore me komunat krishtere. Në vitin 313, Konstantini i Madh I, e ka lëshuar Ediktin e Milanos me të cilin religjioni krishterë është bërë i barabartë me të tjerat dhe ka fituar liri legale. Prej atëherë, kisha krishtere ka filluar gradualisht të shndërrohet në institucion të privilegjuar dhe si rezultat i kësaj, deri në fund të shekullit IV, krishterimi është shndërruar në religjion shtetëror i Perandorisë Romake. Për shkak se kisha krishtere i ka mbrojtur interesat e shtetit, prej kishës dhe nga titullarët e lartë ka fituar prona të mëdha tokësore dhe me privilegje, ndërsa kleri është liruar nga tatimet. Në përhapjen e krishterimit, ipeshkvi i qytetit të Romës ka fituar autoritet të lartë ndërmjet klerit dhe ka filluar të emërohet papë, respektivisht baba ose krye e kishës. Duke u shpallur për trashëgimtar të apostullit Pjetër, papa ka filluar t'i nënshtrojë ipeshkvijtë tjera. Në këtë mënyrë, papa romak është bërë kryetari suprem i krishterëve të Evropës perëndimore.

Përhapja e krishterimit ndërmjet popujve barbarë ka luajtur rol progresiv, për arsye se ka sjellë civilizim më të zhvilluar në raport me paganizmin (politeizmin). Manastiret kanë qenë qendrat e vetme dhe vatrat e shkrim leximit mesjetar, ndërsa murgjit njerëzit e vetëm që dinin shkrim-lexim. Te disa popuj, kisha ka luajtur rol të rëndësishëm edhe në organizimin e rezistencës dhe lëvizjes për çlirim kombëtar. Mirëpo, në vende të caktuara të Evropës Perëndimore kisha ka qenë organizator i fushatave pushtuese dhe luftërave pushtuese, siç kanë qenë për shembull kryqëzatat.

*Murgj*

Pse kisha krishtere ka pasur pozitë të privilegjuar në shtet?

THEMELIMI I SHTETIT TË PAPËS



Shitja e indulgjencave

Gjatë shekullit VIII kisha romake ka qenë e eksponuar në sulme dhe në grabitje nga ana e Langobardëve. Majordomi i shtetit frank Pipin i Shkurti, në thirrje të papës ka ardhur në Itali dhe i ka mundur Langobardët. Në territoret që u janë marrë Langobardëve, në Italinë e Mesme, me qendër në qytetin e Romës, në vitin 756 është themeluar shteti i papës. Pjesa e mbetur nga shteti i shenjtë i papës sot paraqet Vatikani. Shteti i papës ka pasur vend shumë të rëndësishëm në historinë evropiane, për shkak se papa si

kreu suprem i krishterimit perëndimor, ka ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve kontestuese ndërmjet shteteve.

Përshkruani themelimin e shtetit të papës.

NDARJA E KISHËS KRISHTERE

Me ndarjen e Perandorisë Romake, së shpejti është ndarë edhe kisha krishtere. Ndërmjet papëve në perëndim dhe patriarkëve në lindje ka ekzistuar armiqësi dhe padurim për mbisundimin e kishës. Armiqësia, veçanërisht është përforcuar kur papat haptazi e kanë theksuar të drejtën e vet në pushtet mbi tërë kishën krishtere. Kundër pretendimeve të këtilla të papës kanë qenë edhe perandorët bizantinë, të cilët kanë qenë kundër përzierjes së papëve në punët e tyre të brendshme. Papët dhe patriarkët janë përleshur edhe gjatë përhapjes së krishterimit ndërmjet popujve sllavë. Lufta e tyre është thelluar edhe për shkak të mospajtimit për disa çështje dhe ceremoni fetare. Rivaliteti ndërmjet kishës lindore dhe perëndimore është përforcuar aq shumë që në vitin 1054 ka ardhur deri në përçarjen e tërësishme. Kishat, njëra tjetrës i kanë lëshuar anatema - mallkim. Prej atëherë, kisha perëndimore fillon të emërohet *rimo katolike* në krye me papën me seli në Romë, ndërsa kisha lindore fillon të emërohet *ortodokse* në krye me patriarkun me seli në Stamboll.

Cilat janë arsyet për ndarjen e kishës krishtere?

LUFTA NDËRMJET MBRETËRISË DHE PAPANATIT

Me përforsimin e kishës, ka filluar edhe lufta e hapur ndërmjet Papatit dhe Mbretërisë, e cila ka zgjatur disa shekuj. Konflikti i parë ka ndodhur në shekullin XI në kohën e mbretit Henrih IV dhe papës Gërgur VII. Duke e marrë parasysh fuqinë e madhe financiare me të cilën kanë disponuar, papët kanë pasur përparësi në raport me mbretërit. Në fillim të shekullit XIII, në kohën e papës Inocentij III, Papati e ka arritur fuqinë më të madhe. Atëherë papa ka filluar të përzihet në politikën e shteteve në Evropë. Disa sundimtarë evropianë kanë qenë bile edhe vasalë të papës dhe i kanë paguar tatim vjetor.

Me përforsimin e shteteve evropiane në shekullin XIII dhe XIV, ndikimi i Papatit ngadalë është zvogëluar. Edhe krahas kësaj, akoma ka paraqitur faktor të rëndësishëm në historinë e Evropës.

Cilat kanë qenë arsyet për luftën ndërmjet Mbretërisë dhe Papatit?

REFORMIMI DHE KUNDËRREFORMIMI

Reformimi është lëvizje sociale, ideologjike dhe politike prej fillimit të shekullit XVI që është drejtuar kundër Kishës katolike. Kjo lëvizje do të sjellë deri në ndarjen e Kishës katolike dhe deri në formimin e Kishës luteriane (Protestante).

Reformimi është shkaktuar nga më shumë arsye. Njëra nga arsyet është pozita ekonomike e kishës e cila nëpërmjet detyrimeve të ndryshme financiare ka grumbulluar mjete financiare të mëdha.



Martin Luter

Motiv tjetër i rëndësishëm për pakënaqësinë ka qenë mënyra e jetës së klerit.

Shumica e titullarëve të lartë kishtarë kanë jetuar jetë luksoze dhe skandaloze. Pakënaqësia ka kulminuar kur Kisha rimo katolike ka filluar të shesë të ash.q. indulgjenca. Atyre të cilët kanë blerë indulgjenca u janë falur të gjitha mëkatet.

Pakënaqësia më e madhe kundër Kishës rimo katolike dhe personalisht kundër papës është shprehur në Gjermani. Reformimi ka filluar në vitin 1517, kur Martin Luteri në derën e katedrales në Vitenberg i ka



Theksimi i 95 tezave të Martin Luterit



Papa Inocentij III

publikuar 95 tezat e veta. Ai, publikisht i ka kritikuar keqpërdorimet e kishës dhe ka kërkuar të zbatohen reforma në kishë. Luteri e ka shpallur Librin e Shenjtë për burim të vetëm të fesë. Mësimi i tij është përhapur shpejtë dhe e ka përfshirë pjesën më të madhe të Gjermanisë.

Pas luftërave shumëvjeçare ndërmjet ithtarëve dhe kundërshtarëve të reformimit në Gjermani, në të cilat nuk ka fituar asnjëra prej palëve në vitin 1555 në Augsburg është lidhur paqe fetare ndërmjet katolikëve dhe protestantëve. Me paqen, protestantëve në Gjermani u është pranuar barazia me besimtarët katolikë.

Prej Gjermanisë, reformimi është përhapur në më shumë vende katolike: Francë, Zvicër, Angli etj. Me qëllim që të parandalohet përhapja e mëtutjeshme e reformimit dhe t'i kthejë besimtarët në radhët e veta, kisha katolike

ka ndërmarrë masa të vrazhda dhe energjike. Kjo lëvizje emërohet kundër reformim ose reaksion katolik. Përkrahje të madhe në luftën kundër reformimit, kisha katolike ka fituar me themelimin e rendit të murgjve jezuitë në krye me fisnikun spanjoll Ignacio Llojolla. Edhe pse kundër reformimi ka arritur rezultate të konsiderueshme, ai përsëri nuk ka pasur sukses ta shkatërrojë lëvizjen reformatore në më shumë vende në Evropë.

Hulumto dhe mëso! Veçoni dhe shpjegoni kërkesat më të rëndësishme të Martin Luterit. Çka paraqet kundër reformimi?

SHTETI OSMAN**THEMELIMI I SHTETIT OSMAN**

Turqit kanë qenë popull blegtor aziatikë me prejardhje mongole, të cilët kanë jetuar në territoret stepe në lindje të Liqenit Kaspik. Ata, kryesisht janë marrë me blegtori, ndërsa kanë qenë të organizuar në organizim të fuqishëm ushtarak. Një pjesë e tyre të quajtur selxhukë, qysh në shekullin XI e kanë sulmuar Kalifatin e Bagdadit dhe kanë ardhur deri në brigjet e Detit Mesdhe. Këtu e kanë themeluar shtetin e vet dhe njëkohësisht edhe janë islamizuar.

Në shekullin XIII, nën presionin e Mongolëve, në territorin e sulltanateve të selxhukëve është vendosur një masë tjetër e turqve, të quajtur Osmanli. Njëri nga udhëheqësit e tyre Osmani (1288-1326), ka formuar shtet të pavarur, i cili sipas emrit të tij është emërtuar Osman ose Osmanli. Njëri nga trashëguesit, Orhani ka arritur ta zgjerojë shtetin në llogari të Bizantit të dobësuar. Në gjysmën e dytë të shekullit XV, Osmanlinjtë kanë ndërhyrë në Ballkan, me ç'rast kanë vendosur pushtet vetjak në Bullgari, në Maqedoni, në Serbi, në Shqipëri, në Bosnje e Hercegovinë etj. Në vitin 1453 turqit osmanli, të udhëhequr nga sulltani Mehmet Pushtuesi II, e kanë pushtuar Stambollin me ç'rast ka pushuar së ekzistuari Perandoria Bizantine.

Gjatë sundimit të sulltanit turk Sulejmani II Madhështor, shteti osmanli e ka arritur zhvillimin e vet më të madh. Por, atëherë fuqia e shtetit ka filluar të dobësohet me shpejtësi.

Si është krijuar shteti osmanli?



Osman

ORGANIZIMI I SHETIT

Sulejmani II Madhështor

Shteti osmanli ka qenë shtet i centralizuar në krye me sundimtarin suprem - sulltanin. Ai ka pasur pushtet absolut politik dhe fetar. Në udhëheqjen me shtetin sulltanit i kanë ndihmuar nëpunës shtetërorë të lartë, të cilët e kanë përbërë këshillin shtetëror, të quajtur Divan. Ndhmësi kryesor i sulltanit ka qenë veziri i madh. Ai e ka ruajtur vulën shtetërore ndërsa gjatë luftës ka qenë komandanti kryesor i të gjitha forcave ushtarake në shtet. Të gjithë nëpunësit e lartë së bashku me sulltanin e kanë përbërë Portën e Lartë (qeverinë). Gjykimi në shtet ka qenë në duart e gjykatësve spiritualë - kadive. Kaditë kanë gjykuar sipas rregullave fetare (të shariatit) dhe dispozitave ligjore të lëshuara nga sulltani. Tërë shteti ka qenë i ndarë në krahina të mëdha dhe të vogla, me të cilat kanë udhëhequr pronarë të mëdhenj feudalë të cilët njëkohësisht kanë qenë drejtues administrativ dhe komandantë ushtarakë.

Njësi më të mëdha administrative kanë qenë bejlerbejllukët në krye me bejlerbenjtë, të cilët i ka emëruar sulltani. Bejlerbejllukët janë ndarë në njësi më të vogla administrative të quajtura sanxhakë kurse sanxhakët janë ndarë në vilajete dhe në nahije etj. Të gjithë popujt e nënshtuar, Osmanlinjtë i kanë quajtur rajë.

Si ka qenë i organizuar pushteti në Shtetin osman?

USHTRIA OSMANE

Në Shtetin Osmanli ka qenë vendosur organizim i fortë ushtarak, i cili ka mundësuar zhvillimin e luftërave pushtuese dhe zgjerim të territorit shtetëror. Ushtria e tyre ka qenë e përbërë nga spahinj (kalorës) dhe jeniçerë (këmbësoria e rregullt).

Spahinjtë kanë qenë kalorës - feudalë, të cilët kanë fituar feud (leno-spahillëk), me obligim që në thirrje të sulltanit të shkojnë në luftë, dhe me vete të marrin numër të caktuar të ushtarëve dhe të pajisjes në varësi nga madhësia e lenos. Në rast se nuk e kanë përmbushur obligimin ushtarak, spahinjtë kanë mundur ta humbin lenon - spahillëkun.

Ushtria jeniçeri është formuar në shekullin XIV. Në fillim, kjo ushtri ka qenë e përbërë nga robër të rinj luftime, por më vonë, në jeniçerë janë shndërruar fëmijët e marrur të krishterë nëpërmjet të a.q. tatim në gjak. Jeniçerët janë edukuar në frymën myslimane, nuk kanë pasur të drejtë të martohen dhe detyra e tyre kryesore ka qenë të jenë besnik ndaj sulltanit dhe të marrin pjesë guximshëm në operacionet ushtarake. Jeniçerët kanë përfaqësuar fuqi goditëse të ushtrisë së osmanlinjve dhe kanë kontribuar shumë për zgjerimin territorial të Perandorisë së Osmanlinjve.

Turqit - Osmanlinj kanë pasur edhe flotë të fuqishme, e cila u ka mundësuar të bëjnë operacione ushtarake edhe në det.

Kohë të gjatë, në ushtrinë e osmanlinjve ka dominuar arma e ftohtë. Ushitari turk ka qenë i armatosur me hark dhe me shigjeta, me jatagan, me shtizë të shkurtër, me mburojë, e ë raste të caktuara kanë mbajtur edhe jelek mbrojtës.

Më vonë, kanë përdorur armë zjarri dhe topa, të cilat kanë demonstruar efikasitet të veçantë gjatë pushtimit të Stambollit.

Çfarë kanë përfaqësuar spahinjtë?

Sqaroni rëndësinë e ushtrisë së jeniçerëve në zgjerimin territorial të Perandorisë Osmane?



Spahi



Mbretëria osmane kah mesi i shekullit të XVI

BALLKANI NË MESJETË

DYNDJA E SLLAVËVE NË BALLKAN

Sllavët bëjnë pjesë në rendin e banorëve më të vjetër të Evropës. Deri në mesin e shekullit I të e.s., sllavët kanë qenë të njohur si Venetë (Venedë), Andë dhe Skllavë. Ata kanë jetuar në territorin që shtrihej ndërmjet Detit Baltik, Karpateve dhe luginave të lumenjve Dnjestër dhe Dnjepër. Nën ndikimin e Dyndjes së Madhe të Popujve, sllavët kanë filluar të shpërngulen në tre drejtime: në lindje, në perëndim dhe në jug. Sllavët jugorë i kanë banuar krahinat në Panoni dhe në Luginën Vllahë. Lumi Danub ka qenë kufiri jugor me Perandorinë Bizantine. Sllavët, shpesh e kanë kaluar lumin Danub për shkak të organizimit të fushatave grabitqare në Bizant. Në gjysmën e dytë të shekullit VI dhe fillimit të shekullit VII, kanë filluar të vendosen në Gadishullin Ballkanik. Kur sllavët kanë ardhur në Ballkan, kanë hasur në numër të madh të vendasve: keltë, maqedonas, trakë dhe ilirë. Një pjesë janë asimiluar me sllavët ndërsa pjesa tjetër kanë arritur t'i mbajnë zakonet, gjuhën dhe kulturën e vet.

Me ndihmën e hartës ndiqni vendosjen e sllavëve në Ballkan.



Fiset sllave në Ballkan

SHTETI BULLGAR

Bullgarët kanë qenë fise nomade me prejardhje turko-tatare. Kanë jetuar në territorin rreth Liqenit Kaspik. Në shekullin VII nën udhëheqjen e kanit Asparuh janë vendosur në hapësirën ndërmjet malit Ballkan dhe lumit Danub. Në vitin 681 kanë formuar shtet të vet me kryeqytet në Pliska. Në atë hapësirë kanë jetuar tetë fise sllave, të cilat e kanë pranuar pushtetin suprem të Bullgarëve. Për arsye se kanë qenë më pak në numër se sllavët, ata janë shkrirë me ta, e kanë pranuar gjuhën sllave por e kanë mbajtur emrin Bullgarë. Në vitin 864, në kohën e kanit Boris, bullgarët e kanë pranuar krishterimin nga Bizanti.

Kah fundi i shekullit IX dhe fillimin e shekullit X, gjatë sundimit të mbretit Simeon, Bullgaria është bërë shteti më i fuqishëm në Ballkan. Pas vdekjes së tij, Bullgaria ka filluar të dobësohet me shpejtësi ndërsa në vitin 971 ka rënë nën pushtetin bizantin. Një kohë të caktuar me Bullgarinë ka sunduar mbreti maqedonas Samoili.

Kah fundi i shekullit XII, me kryengritjen e Petrit dhe Asenit (viti 1185), bullgarët janë çliruar nga pushteti i Bizantit, me ç'rast është themeluar Mbretëria e Dytë Bullgare. Pas vdekjes së mbretit Ivan Asen, Bullgaria ka filluar të dobësohet.

Përshkruani zhvillimin e shtetit bullgar.



Vula dhe vizatim në monedhën e Ivan Asen II

ZETA (DUKLA)

Shteti Dukla është themeluar në shekullin X në territoret rreth lumenjve Zeta dhe Moraça, Liqenin e Shkodrës dhe Gjirin e Kotorit. Gjatë luftërave pushtuese të mbretit maqedonas Samoil, knezi Vlladimir e ka njohur pushtetin maqedonas dhe është bërë dhëndër i mbretit maqedonas. Pas shkatërrimit të Mbretërisë së Samoilit, Dukla përkohësisht ka hyrë në përbërjen e Bizantit.

Në mesin e shekullit XI, Dukla është çliruar nga Bizanti dhe është bërë shtet i pavarur. Knezi Mihajllo ka arritur ta bashkojë Rashkën me çka Dukla është bërë shtet i pavarur. Mihajlli e ka ndihmuar kryengritjen e Gjorgji Vojteh në Maqedoni, ndërsa ka pasur raporte të mira edhe me papën. Në vitin 1077, Mihajlli nga papa ka pranuar kurorë mbretërore, ndërsa Dukla është bërë mbretëri. Pas vdekjes së tij, në shekullin XII, shteti është dobësuar dhe ka rënë nën pushtetin e Bizantit.

Hulumto dhe mëso! Çfarë ka qenë ndihma që kinezi Mihajllo ua ka dërguar kryengritësve maqedonas në krye me Gjorgji Vojtehun?

RASHKA (SERBIA)

Serbët i kanë banuar krahinat në rrjedhën e lumenjve Lim, Ibër, Drina dhe Morava Perëndimore. Në mesin e shekullit IX, fiset serbe e kanë formuar shtetin Rashkë, i cili emrin e ka fituar sipas qytetit Ras. Kah fundi i shekullit X, Rashka ka hyrë në përbërjen e shtetit maqedonas ndërsa pas rënies së Mbretërisë së Samoilit, e ka pranuar pushtetin suprem të Bizantit.

Kah fundi i shekullit XII, prifti i lartë serb i famullisë, Stefan Nemanja e ka braktisur pushtetin bizantin dhe e ka ripërtërirë shtetin serb. Gjatë kohës së sundimitarit Stefan Nemanjiq, reputacioni i Serbisë është rritur, ndërsa shteti ka përfutur territore të reja. Në vitin 1217, prifti i lartë i famullisë Stefani ka pranuar nga papa kurorë mbretërore dhe e ka fituar emrin i Kurorëzuari i Parë. Dy vite më vonë, është formuar edhe kisha e pavarur serbe, në rangun e kryepeshkopatës, në krye me peshkopin e parë Savën.



Mbreti Dushan

TEMA 3

Fuqinë më të madhe shteti serb e ka arritur në kohën e mbretit Dushan (1331-1355), i cili ka udhëhequr më shumë luftëra pushtuese, me ç'rast i ka pushtuar: Maqedoninë, (pa Selanikun), Thesalinë, Epirin dhe Shqipërinë. Në vitin 1346, në Shkup, Dushani është kurorëzuar mbret ndërsa Serbia është bërë mbretëri. Pas vdekjes së tij, shteti serb ka filluar të dobësohet, gjë që ka sjellë deri në shpërbërjen e saj në më shumë sundime feudale të pavarura.

Në kohën e kujt shteti serb ka përjetuar fuqi më të madhe?

SUNDIMTARËT E PAVARUR NË SHQIPËRI

Një pjesë e fiseve sllave u ngulit edhe në Shqipëri, ku e kanë gjetur popullsinë e lashtë të romanizuar, kryesisht ilire. Shqipëria shpesh ka rënë nën pushtetin e shteteve fqinje: Bullgarisë, Mbretërisë së Samoilit, Bizantisë etj. Prej shekullit XI kanë filluar të veçohen familjet fisnike shqiptare: Arianitë, Mëzakë, Zigurë etj. Është formuar edhe principata Arbëria e cila fuqinë më të madhe e ka arritur në gjysmën e parë të shekullit XIII, në kohën e princit Dimitër.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIV, pas vdekjes së mbretit Dushan, disa fisnike shqiptarë kanë formuar principata të pavarura. Në krahinën Durrës dhe Krujë, principatë ka themeluar Karl Topia. Në pjesën veriore të Shqipërisë, janë pavarësuar Balshajt. Më vonë, edhe feudale të tjerë janë pavarësuar në Shqipëri, prej të cilëve më të njohur janë familja e Arianitëve, Dukagjinëve, Kastriotëve etj.



Fortesa e Beratit

Si ka qenë gjendja e Shqipërisë pas vdekjes së mbretit Dushan?

RËNIA E SHTETEVE BALLKANIKE NËN PUSHTIMIN OSMANLI

Në mesin e shekullit XIV, shtetet ballkanike kanë qenë të dobësuara në masë të madhe nga luftërat e ndërsjella. Duke i shfrytëzuar këto rrethana, osmanlinjtë kanë kaluar në Ballkan dhe relativisht lehtë i kanë pushtuar këto territore. Ngjarjet vendimtare për sukseset e osmanlinjve kanë qenë beteja në Maricë (1371) dhe beteja në Fushë Kosovë (1389). Së shpejti, e para në goditje ka qenë Bullgaria, e cila në vitin 1396 ka rënë nën pushtetin

e osmanlinjve. Pas betejës së Kosovës, Serbia e ka pranuar pushtetin suprem të osmanlinjve, ndërsa në vitin 1459, përfundimisht e ka humbur pavarësinë. Kah fundi i shekullit XIV, osmanlinjtë kanë filluar të depërtojnë në Shqipëri. Në betejën në Fushën e Saurit (1385), osmanlinjtë e kanë mundur ushtrinë e Balshës II dhe e kanë pushtuar një pjesë të madhe të Shqipërisë. Bizanti, në këtë periudhë i ka humbur pothuajse të gjitha territoret e veta përveç Stambollit. Përfundimisht, në vitin 1453, sulltan Mehmeti II e ka pushtuar Stambollin me çka ka pushuar së ekzistuari Perandoria Bizantine.

Pse vendet ballkanike kanë rënë lehtë nën pushtetin e osmanlinjve?



Rrethimi i Stambollit nga osmanlinjtë

Pushtimet e osmanlinjve të vendeve ballkanike

**TEMA 4.
SHEKULLI I RI**

ZHVILLIMI I PËRSHPEJTUAR EKONOMIK

SHPIKJET TEKNIKE

Gjatë shekullit XVI dhe XVII, shtetet e Evropës Perëndimore kanë shënuar përparim të fuqishëm shoqëroro-ekonomik. Në vend të sistemit të vjetruar feudal, gjithnjë e më shumë janë zhvilluar marrëdhëniet e reja kapitaliste. Ndryshimet shoqërore të cilat janë vendosur në vendet e Evropës Perëndimore, kanë shkaktuar zhvillimin e bujqësisë, të komunikacionit, të tregtisë etj.

Në këtë periudhë bujqësia ende ishte degë kryesore e ekonomisë. Me kultivimin e kulturave të reja bujqësore dhe paraqitjen e makinave të para bujqësore, në mënyrë të konsiderueshme janë rritur rendimentet nga prodhimtaria bujqësore. Me paraqitjen e revolucionit agrar, pronat e vogla bujqësore gradualisht janë zhdukur dhe janë formuar prona gjithnjë më të mëdha, ferma të mëdha të tipit kapitalist.

Përparim të madh në këtë periudhë është bërë në industrinë. Në vend të punishteve të vogla, të cilat janë zhdukur gradualisht, në shekullin XVIII dhe XIX paraqiten fabrikat në të cilat përdoren shpikjet e reja teknike. Prodhimtaria manuale zëvendësohet me prodhimtarinë mekanike. Makinat e para janë përdorur në industrinë tekstile. Kështu, Xhejms Hargrejvs e ka përkryer makinën për tjerre ndërsa Edmund Kartrajd e ka shpikur makinën për endje. Në vitin 1784, anglezi Xhejms Vat e ka shpikur dhe e ka përsosur makinën me avull dhe ka filluar aplikimi i saj në prodhimtari. Me këto zbulime dhe me ndryshimet në prodhimtarinë



Xhejms Vati dhe makina e tij me avull

TEMA 4

industriale, në Angli, në mesin e shekullit XVIII filloi revolucioni industrial, përkatësisht zëvendësimi i prodhimtarisë manufakturore me prodhimtarinë makinore në fabrikë.


Makina me avull ka gjetur zbatim praktik edhe në transport. Në vitin 1803 Xhorxh Stivenson e ka konstruktuar lokomotivën e parë. Kjo ka mundësuar që të ndërtohet linja e parë hekurudhore Stokton - Darlington. Në SHBA, shkencëtari Robert Fulton e ka konstruktuar anijen e parë me avull.

Përparimi teknik ka vazhduar me tempo të pa zvogëluar në shekullin XIX. Me përdorimin e energjisë elektrike si fuqi motorike, ka filluar revolucioni i dytë industrial. Në këtë fushë, kontribut të madh kanë dhënë Tomas Edisoni, i cili e ka përsosur llambën elektrike, ndërsa Simensi e ka konstruktuar tramvajin elektrik. Shkencëtari Nikolla Teslla ka punuar në konstruktimin e motorëve për rrymën alternative. Telefoni i parë është konstruktuar nga shkencëtari amerikan Graham Bell. Shkencëtari italian Gilermo Markoni e ka dërguar radiomesazhin e parë prej Britanisë së Madhe deri në Francë.

Në këtë periudhë, kanë ndodhur ndryshime në komunikacionin lumor dhe detar. Anijet me konstruksion hekuri janë zëvendësuar me atë të çelikut. Për zhvillimin e komunikacionit detar dhe tregtisë botërore janë gërmuar kanali i Suezit, i Kilit dhe Panamasë. Me zhvillimin e tregtisë botërore, janë realizuar profite të mëdha që kanë mundësuar që shtetet të pasurohen, e me këtë të orientojnë investime të reja në prodhimtarinë, shkencën dhe kulturën.

Sqaroni paraqitjen e revolucionit industrial.

Çfarë nënkuptoni me nocionin revolucioni industrial?



Lokomotiva me avull e Stivensonit



Lokomotiva e parë me avull



Makina e parë për tjerrje, 1764



Kanali i Suezit

RRITJA E POPULLSISË QYTETARE

Revolucioni industrial ka ndikuar pozitivisht edhe në zhvillimin e qyteteve. Me rritjen e prodhimit, qendra e jetës ekonomike është transferuar prej fshatrave nëpër qytetet. Ka filluar migrimi prej fshati në qytet. Janë zhvilluar qytete të reja si Londra, Parisi, Amsterdami, Berlini, Nju Jorku etj. të cilat kanë fituar pamje të re dhe kanë pasur më shumë se një milion banorë.

Me zhvillimin e industrisë, tregtisë dhe bankierisë është rritur edhe popullsia qytetare. Shtresat e pasuruara të tregtarëve, bankarëve, pronarëve të ndërmarrjeve kanë futur risi në mënyrën e jetesës në ambientet qytetare. Qytetarët më të pasur i kanë shkolluar fëmijët e vet në shkolla më të mira. Në masë të konsiderueshme është rritur numri i studentëve.

Me qëllim që ta zmadhojnë ndikimin e vet në shoqëri, qytetarët kanë kërkuar të drejta dhe liri më të mëdha, siç janë: barazi para gjyqit, liri të shtypit, të bindjeve fetare, barazi gjatë pagimit të tatimeve, të drejtë të përgjithshme në votë etj. Kundërshtimet ndërmjet politikanëve dhe disa pallateve mbretërore në njërin anë dhe klasës qytetare në anën tjetër, gjithnjë e më shumë janë ashpërsuar, që ka sjellë deri në luftë të ashpër politike. Me këtë, qytetarët gjithnjë e më shumë e kanë rritur ndikimin e vet në shoqëri ashtu që krahas fuqisë ekonomike, do ta marrin edhe fuqinë politike.

Cilat kanë qenë kërkesat e qytetarëve?

Pse qytetarët e kanë nxitur zhvillimin e arsimit?

REVOLUCIONI I MADH BORGJEZ NË FRANCË**ARSYET PËR REVOLUCIONIN**

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, Franca ka qenë monarki absolute me përfaqësim klasor. Në krye të shtetit ka qenë mbreti Lui XVI i cili ka pasur pothuajse pushtet absolut. Popullsia është ndarë në tri klasa: kleri dhe fisnikëria kanë qenë të privilegjuar, ndërsa ka ekzistuar edhe klasë e tretë në të cilën kanë bërë pjesë pjesëtarë të ndryshëm të qytetarëve, të fshatarëve dhe të punëtorëve. Klasa e tretë, edhe pse i ka paguar detyrimet e veta ndaj shtetit, nuk ka pasur pozitë vendimmarrëse në shtet.

Në këtë periudhë Franca ka rënë në krizë të rëndë financiare. Kriza e ka rritur pakënaqësinë e klasës së tretë nga sundimi absolut i mbretit. Nën presion të klasës së tretë, mbreti Lui XVI (1774-1792) më 5 maj të vitit 1789, në Versajë e ka mbledhur kuvendin e klasave shtetërore.

Kur mbreti shpalli se vendosen tatime të reja të cilat do të duhet t'i paguajnë klasa e tretë, përfaqësuesit e kësaj klase e kanë kundërshtuar menjëherë këtë propozim dhe shpallën Kuvendin popullor. Në korrik vitin e njëjtë, Kuvendi popullor është shpallur Kuvend kushtetues me qëllim që të miratohet Kushtetuta në shtet.

Shpjegoni sistemin klasor në Francë.




Lui XVI

FILLIMI, RRJEDHA DHE NGADHNJIMI I REVOLUCIONIT*Nënshtrimi i fshatarit*

Edhe pse mbreti është pajtuar me punën e Kuvendit, fshehurazi është përgatitur që me ushtri t'i shpërndajë. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi te populli, për të ç'arsye më 14 korrik të vitit 1789, është marrë burgu i Bastiljes - simboli i absolutizmit mbretëror. Kjo e ka shënuar fillimin e Revolucionit borgjez francez. Sipas shembullit të Parisit, revolucioni ka fituar edhe në pjesët tjera të Francës. Fitoren e ka shfrytëzuar borgjezia e madhe dhe e ka marrë pushtetin. Nëpërmjet Kuvendit popullor është miratuar Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Në vitin 1791, Kuvendi kushtetues ka miratuar Kushtetutë me të cilën Franca është shpallur monarki kushtetuese dhe është hequr ndarja e qytetarëve në klasa.

Detyrë: Lexoni Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit. Çfarë rregullimi shoqëror është përforcuar në Francë sipas saj?

*Sulmi në Bastilje*

SHPALLJA E REPUBLIKËS

Frika nga përhapja e revolucionit në vitin 1792 ka shkaktuar intervenim të disa shteteve feudale kundër Francës. Lufta kundër Koalicionit feudal e ka përkeqësuar pozitën e popullit. Ushtria franceze në frontet ka pësuar disfata. Në muajin gusht të vitit 1792, populli i Parisit e ka sulmuar pallatin mbretëror Tiljeri dhe e ka mbyllur mbretin. Pas këtyre ngjarjeve është thirrur Kuvend i ri popullor, i quajtur Konvent, i cili e ka shpallur Francën republikë.

Konventi ka punuar në atmosferë mosbesimi ndërmjet dy rrymave politike. Zhirondistët kanë konsideruar se revolucioni ka përfunduar dhe kanë dashur ta shpëtojnë mbretin. Jakobinët kanë konsideruar se revolucioni duhet të vazhdojë deri në shkatërrimin e sistemit feudalo-absolut. Nën presionin e jakobinëve, Konventi i ka dënuar me vdekje mbretin dhe mbretëreshën, të cilët pastaj janë ekzekutuar.



Ekzekutimi i mbretit Lui XVI

Shpjegoni dallimet ndërmjet Zhirondistëve dhe Jakobinëve.

DIKTATURA JAKOBINE

Pas ekzekutimit të mbretit, Koalicioni feudal e ka përforcuar luftën kundër republikës borgjeze, ndërsa në brendinë e Francës ka shpërthyer edhe kundërrevolucioni. Për shkak të pakënaqësisë nga sundimi i zhirondistëve, pushtetin e kanë ndërmarrë jakobinët të cilët të udhëhequr nga Maksimilian Robespjeri kanë vendosur diktaturë të njohur si Diktatura jakobine. Pas ndërmarrjes së pushtetit edhe te jakobinët janë paraqitur përçarje. Këtë e kanë shfrytëzuar kundërshtarët e tyre të cilët e kanë vrarë Robespjerin me ç'rast në vitin 1794, diktatura jakobine është abroguar ndërsa pushtetin në Francë e ka ndërmarrë borgjezia e madhe.

Revolucioni borgjez francez e ka përmbysur rregullimin shoqëror feudal dhe paraqet uverturë në një periudhë të re të zhvillimit shoqëror në të cilën do të sundojë liria dhe barazia e të gjithë qytetarëve. Ai e ka përshpejtuar zhvillimin e ekonomisë kapitaliste në Francë dhe në vendet tjera, ndërsa gjithashtu e ka mundur zhvillimin e demokracisë.

Cila është rëndësia e Revolucionit borgjez francez?

NAPOLON BONAPARTA



Napolon Bonaparta

Në vitin 1795 u miratua Kushtetuta e re e Francës sipas së cilës, pushtetin ligjvënës e ka pasur Konventi ndërsa pushtetin ekzekutiv Direktoriumi. Në të njëjtën kohë, është bërë luftë me armiqtë e jashtëm, në të cilën veçanërisht është dalluar gjenerali i ri Napolon Bonaparta (1769-1821). Duke e shfrytëzuar pakënaqësinë nga sundimi i Direktoriumit, në vitin 1799, Napoloni ka bërë grusht shteti dhe në vendin e Direktoriumit ka vendosur trup të ri ekzekutiv të quajtur Konsullatë. Përveç Napolonit, ka pasur edhe dy konsuj, por Napoloni ka pasur pothuajse pushtet të pakufizuar. Në vitin 1804, Napoloni është kurorëzuar perandor i Francës.

Pas shpalljes për mbret, Napoloni ka vazhduar të luftojë kundër Austrisë, Anglisë, Prusisë, Spanjës, Rusisë dhe vende të tjera. Në vitin 1812, me ushtri të madhe e ka sulmuar Rusinë. Në betejën e Borodinit, Napoloni e ka mundur ushtrinë ruse dhe e ka pushtuar Moskën. Për shkak të rezistencës së madhe që e kanë dhënë rusët, së shpejti ka qenë i detyruar të tërhiqet nga Rusia. Pas disfatës së ushtrisë së tij në betejën te Lajpcigut (v. 1813), nga forcat e bashkuara pruse, austriake dhe suedeze, Napoloni kthehet në Paris. Ai ka qenë

i detyruar ta braktisë fronin pas së cilës është burgosur në ishullin Elba. Në Francë është kthyer pushteti feudal, ndërsa mbret i Francës është vënë Lui XVIII, vëllai i Lui. Në vitin 1815 Napoloni është liruar dhe për afat të shkurtër e ka ndërmarrë pushtetin, por vitin e njëjtë ka përjetuar disfatë të re në betejën në Vaterlo. Mandej është burgosur përsëri në ishullin Shën Elena ku edhe ka vdekur në vitin 1821.

Pas disfatës së Napolon Bonapartës, në Francë dhe në Evropë ka mbisunduar reaksioni feudal. Shtetet të cilat kanë luftuar kundër Napolonit, në vitin 1814 kanë konvokuar kongres paqësor në Vjenë. Janë marrë vendime sipas të cilave në të gjitha shtetet është dashur të kthehen në pushtet sundimtarët e ligjshëm. Me këtë kongres është bërë restaurimi i feudalizmit në shtetet evropiane dhe janë eliminuar përfitimet nga Revolucioni borgjez francez.

Hulumtoni në internet: Napolon Bonaparta dhe luftërat e tij.

Bëni projekt: Revolucioni borgjez francez.

SHTETET E REJA NACIONALE NË EVROPË

BASHKIMI I ITALISË

Në shekullin XIX, Italia ka qenë akoma ekonomikisht dhe politikisht e shpërndarë në më shumë shtete të vogla të pavarura, ndërsa pjesa e konsiderueshme e Italisë Veriore ka qenë nën pushtetin e Monarkisë Habsburge (Austriës). Në Italinë e Mesme ka ekzistuar shteti i Papatit (Austria), në Italinë Jugore mbretëria e Napolonit, ndërsa në Sardenjë dhe në një pjesë të Italisë Veriore ka ekzistuar Mbretëria Sardenje (Piemonti). Shpërndarja politike dhe pushteti i huaj kanë paraqitur pengesë për zhvillimin e saj. Gjatë revolucionit nga viti 1848, italianët kanë bërë përpjekje që ta bëjnë bashkimin e tyre por nuk kanë pasur sukses në këtë.



Evropa në vitin 1815

Me zhvillimin e kapitalizmit në Itali, është paraqitur edhe lëvizja kombëtare për bashkimin e Italisë. Rreth bashkimit të Italisë ka pasur dy këndvështrime. Këndvështrimin e parë e kanë paraprirë Xhuzepe Macini dhe Xhuzepe Garibaldi, të cilët kanë konsideruar se bashkimi i Italisë duhet të bëhet nëpërmjet luftës revolucionare në të cilën do të inkuadrohet borgezia e imët, inteligjenca, punëtorët dhe fshatarët.

Këndvështrimin e dytë e ka përfaqësuar politikani i dalluar piemont, profi Kamilo Kavur. Ai ka konsideruar se bashkimin duhet ta bëjë Mbretëria e Sardenjës (Piemonti), por me ndihmën e fuqisë së madhe e cila do të ndihmojë të mundet Monarkia Habsburge.

Pasi që Kavuri është bërë kryetar i qeverisë së Piemontit, ka filluar ta realizojë idenë e vet. Me ndihmën e Francës, në vitin 1860, Monarkia Habsburge ka pësuar disfatë dhe ka qenë e detyruar të pranojë të heqë dorë prej një pjese të Italisë Veriore në favor të Mbretërisë së Piemontit. Menjëherë pas kësaj, Piemontit i janë bashkëngjitur më shumë shtete të vogla në Italinë e Mesme: Parma, Modena, Romanja dhe Toskana. Në të njëjtën kohë, në Mbretërinë e Napolit është ngritur kryengritje e udhëhequr nga Xhuzepe Garibaldi. Me këtë Mbretëria e Napolit është shkatërruar dhe i është bashkëngjitur Piemontit. Në vitin 1861, është bërë bashkimi i Italisë dhe është shpallur Mbretëria Italiane. Me depërtimin e ushtrive italiane në shtetin e Papatit në vitin 1870 ka përfunduar bashkimi politik i Italisë me çka populli italian për herë të parë në historinë e vet ka qenë i bashkuar.

Si është realizuar bashkimi i Italisë?

Hulumto dhe mëso! Si është zhvilluar karriera politike e Kamilo Kavurit?



Kamilo Kavur



Xhuzepe Macini

BASHKIMI I GJERMANISË

Gjermania, në gjysmën e parë të shekullit XIX ka qenë e ndarë në më shumë shtete të pavarura dhe shtete të vogla. Disa prej tyre, si Bavaria dhe Prusia, kanë qenë shtete të fuqishme. Pas revolucionit në vitin 1848, në shtetet gjermane janë paraqitur regjime reaksionare të cilat kanë ardhur në shprehje më të madhe në Austri dhe në Prusi. Shpërndarja politike ka paraqitur pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të ekonomisë kapitaliste.

Çdo shtet i vogël gjerman i ka pasur kufijtë e vet doganorë, paratë e veta dhe masat

matëse. Me kalimin e kohës, ndërmjet shteteve të caktuara janë arritur marrëveshje të ndërsjella për tregti, ndërsa në vitin 1834 është formuar Federata doganore. Me formimin e saj, doganat e brendshme ndërmjet shteteve janë hequr. Këto masa kanë kontribuar për zhvillimin e përsheptuar ekonomik dhe industrial të Gjermanisë. Federata doganore ka kontribuar për rritjen e industrisë së madhe.



Oto fon Bizmark

Rreth çështjes së bashkimit të shteteve gjermane, ka ekzistuar rivalitet ndërmjet Prusisë dhe Austrisë. Rivaliteti i tyre ka sjellë deri në luftën e ndërsjellë në vitin 1866. Pasi që Austria ka pësuar disfatë, Prusia ka filluar që vetë ta bëjë bashkimin e Gjermanisë.

TEMA 4

Kontributin më të madh në procesin e bashkimit të vendeve gjermane e ka pasur kancelari prus Oto fon Bizmark. Si diplomat i shkathët dhe strateg, ai e ka formuar Federatën veriore gjermane, në të cilën rolin kryesor e ka pasur Prusia. Jashtë Federatës kanë mbetur vetëm disa shtete jugore gjermane për bashkimin e të cilave me Federatën veriore gjermane ka kundërshtuar Franca. Në luftën e cila është bërë në vitin 1870, Franca ka pësuar disfatë. Fitorja e Prusisë e ka mundësuar bashkimin definitiv të Gjermanisë. Në janar të vitit 1871, në Versajë është shpallur Mbretëria Gjermane (Rajhu Gjerman), me kryeqytetin Berlin. Me këtë, në skenën evropiane do të paraqitet një fuqi e re dhe e madhe - Gjermania.

Si është bërë bashkimi i Gjermanisë?

Hulumto dhe mëso! Oto fon Bizmark - burrshtetas dhe diplomat.

PASOJAT NGA BASHKIMI I ITALISË DHE GJERMANISË PËR MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Me bashkimin e Italisë dhe të Gjermanisë, në Evropë ka përfunduar procesi i formimit të shteteve të mëdha kombëtare. Zhvillimi i tyre kombëtar u ka mundësuar qeverive të këtyre dy shteteve të fillojnë politikë të jashtme progresive dhe ekspansioniste. Duke e marrë parasysh faktin se bota ka qenë e ndarë ndërmjet shteteve më të vjetra kapitaliste, në radhë të parë Anglia, Franca dhe Rusia, shtetet e reja Gjermania dhe Italia kanë kërkuar ndarje të botës dhe të kolonive. Për realizimin e këtyre kërkesave, Gjermania dhe Italia së bashku me Austro-Hungarinë, në vitin 1882 kanë formuar aleancë ushtarake, të njohur si aleanca Trepalëshe ose Aleanca e fuqive qendrore, e cila ka paraqitur një nga dy blloqet imperialiste para Luftës së Parë Botërore.

Si është bërë bashkimi i Gjermanisë?



Shpallja e Uilhelm I perandor i Gjermanisë në Versajë?

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS FUQIA E RE BOTËRORE

KOLONIZIMI I AMERIKËS VERIORE DHE LUFTA PËR PAVARËSI



Ameroindianë

Pas zbulimit të Amerikës Veriore, atje filluan të vendosen evropianë, ndërmjet të cilëve më së shumti nga Anglia, si edhe nga Holanda, Franca, Gjermania dhe Irlanda edhe atë kryesisht fshatarë të varfër. Me kalimin e kohës, nga përzierja e ardhacakëve evropianë është krijuar populli amerikan ndërsa gjuha zyrtare është bërë gjuha angleze. Në shekullin XVIII Anglia, pasi e ka mundur Francën dhe Holandën, ka formuar 13 koloni në të cilat kryesisht kanë jetuar fermerë - ardhacakë të cilët kanë pasur prona të veta. Lumi Potomak i ka ndarë këto dy koloni në Veriore dhe Jugore. Në kolonitë veriore në të cilat kanë ekzistuar kushte më të mira për jetë, pjesa më e madhe e banorëve kanë qenë fermerë pronarë të imët të tokës. Përveç kësaj, atje është zhvilluar shpejt edhe industria dhe

tregtia. Në kolonitë jugore kanë ekzistuar prona të mëdha - plantacione, në të cilat kanë punuar robër - zezakë të sjellur nga Afrika.

Kolonitë e reja janë zhvilluar shpejt ekonomikisht, por zhvillimi i tyre ekonomik ka qenë i kufizuar nga Parlamenti anglez nga i cili kolonialët kanë qenë të pakënaqur. Kolonialët e kanë pasur të ndaluar të hapin ndërmarrje që do t'u konkurreninin mallrave angleze, nuk kanë pasur të drejtë në tregti të lirë dhe kanë qenë të detyruar të paguajnë tatime të shumta.

Në vitin 1774 është caktuar kongresi në Filadelfia në të cilin është shqyrtuar gjendja e krijuar. Kongresi, ka kërkuar nga mbreti anglez t'i abrogojë të gjitha kufizimet në tregti dhe industri dhe të mos u imponojë tatim pa pëlqimin e tyre. Por, në vend të plotësimit të kërkesave të tyre, mbreti i ka shpallur për rebelë. Për këtë arsye, në vitin 1775, kolonialët e udhëhequr nga pronari i pasur i plantacionit nga Virxhinia dhe patrioti i madh Xhorxh Uashingtoni, kanë filluar luftë të armatosur për liri dhe pavarësi. Gjatë luftës, më 4 korrik të vitit 1776, kongresi amerikan e ka miratuar Deklaratën e Pavarësisë, me të cilën kolonitë e mëparshme angleze në Amerikën Veriore janë shpallur për shtet të pavarur me

TEMA 4

emrin Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Pas disfatës së ushtrisë angleze, në vitin 1783 në Versajë janë bërë negociata dhe është lidhur paqe me të cilën Anglia e ka njohur pavarësinë e SHBA-ve.

Cilat kanë qenë arsyet për luftën amerikane për pavarësi?



Xhorxh Uashingtoni

RREGULLIMI SHTETËROR I SHBA

Në vitin 1781 është miratuar Kushtetuta e parë e SHBA-ve. Sipas kushtetutës, fillimisht shteti paraqiste konfederatë, me ç'rast çdo shtet ka pasur armatën e vet, financat dhe kufijtë doganor. Rregullimi i këtillë shtetëror është treguar jopraktik, për të ç'arsye në vitin 1787 u miratua Kushtetutë e re sipas së cilës shteti shpallet bashkësi federative me sistem presidencial. Pushteti ekzekutiv i takon Presidentit të Republikës, i cili zgjidhet çdo katër vite dhe ka autorizime të mëdha. Pushteti ligjvënës i takon Kongresit (Senatit dhe Parlamentit). Në Senat zgjidhen nga dy deputetë prej çdo shteti amerikan ndërsa në Parlament, deputetët zgjidhen në varësi nga numri i popullsisë në shtetin përkatës. Pushteti gjyqësor suprem i takon Gjykatës Supreme. Robërit - zezakët dhe indianët nuk kanë pasur të drejta qytetare.

Si është rregullimi shtetëror i SHBA-ve?

LUFTA CIVILE NË SHBA (1861-1865)

Ekonomia në SHBA është zhvilluar gjithnjë e më tepër, por jo njësoj dhe në mënyrë të barabartë në të gjitha shtetet. Shtetet veriore e kanë zhvilluar industrinë dhe bujqësinë fermere ndërsa në jug të shtetit janë mbajtur marrëdhëniet skllavopronare. Pothuajse 4 milionë robër zezakë kanë punuar në plantacionet e mëdha. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX është paraqitur një lëvizje e fuqishme për heqjen e robërisë, e njohur në histori si Lëvizje e abolicionizmit.

Kur President i SHBA-ve u zgjodh Abraham Linkoln, ithtari i abolicionizmit dhe për ndarjen falas të tokës bujqësore në Perëndim për fermerët e varfër, në vitin 1861, shtetet jugore kanë vendosur të ndahen nga SHBA dhe kanë formuar shtet të ri me kryeqytetin Riçmond. Vitin e njëjtë, shtetet jugore kanë filluar luftë kundër atyre veriore. Gjatë luftës, Abraham Linkoln nëpërmjet Kongresit i ka kaluar Ligjin për ndarjen e tokës falas në Perëndim dhe

Ligjin për abrogimin e robërisë. Kjo ka qenë shkas që numër i madh i vullnetarëve fermerë, punëtorë dhe zezakë të hyjnë në radhët e ushtrisë së shteteve veriore e cila ka arritur disa fitore, me ç'rast shtetet jugore kanë qenë të detyruar të kapitullojnë në vitin 1865. Me këtë ka përfunduar Lufta civile në SHBA, në dobi të shteteve veriore.

Pasojat nga Lufta civile kanë qenë me rëndësi të madhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të SHBA-ve. Është ripërtërirë uniteti politik. Është abroguar robëria dhe zezakët kanë fituar të drejtë vote, por nuk kanë fituar tokë.

Përshkruaje rrjedhën e Luftës civile në SHBA.

SHBA ZHVILLOHEN NË FUQI IMPERIALISTE BOTËRORE

Pas Luftës civile, SHBA kanë arritur rritje të shpejtë ekonomike. Janë ndërtuar rrugë të reja dhe vija hekurudhore, është zhvilluar bujqësia, është rritur popullsia me emigracion evropian të ri. Në vitin 1860 SHBA kanë pasur vetëm 30 milionë banorë, ndërsa pas Luftës së Parë Botërore mbi 100 milionë njerëz. Veçanërisht zhvillohet industria (çeliku), xehetaria, industria e naftës etj. Formohen korporata të mëdha industriale (Morgan, Rokfeler). Në vitin 1900, SHBA kanë pasur rrjetin më të zhvilluar hekurudhor në botë. Me rritjen e madhe ekonomike, SHBA kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, bëhet fuqia e parë ekonomike në botë.

Në këtë periudhë SHBA ka filluar të udhëheqë edhe politikë të jashtme globale. Kështu, SHBA e ka zgjeruar ndikimin e vet në Amerikën Qendrore dhe Jugore. Pas Luftës amerikano-spanjolle (1898), SHBA e ka zgjeruar ndikimin e vet në Filipinet, në Kubë, në Portoriko dhe në Havaje. Mirëpo, orientimi pacifist i SHBA-ve është ndeshur me interesat imperialiste të Japonisë në këtë rajon.

Çfarë pasojash ka pasur Lufta civile për zhvillimin e mëtutjeshëm shoqëroro - ekonomik në SHBA?



BOTA NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XIX DHE FILLIMIN E SHEKULLIT XX

RRITJA E DEMOKRACISË NË EVROPË

Zhvillimi i shpejtë i marrëdhënieve shoqërore-ekonomike dhe përforcimi i qytetërimit, ka krijuar nevojën për vendosjen e të drejtave shumë më të mëdha dhe të lirive politike në shtetet në Evropë. Procesi i demokratizimit kah fundi i shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, realizohet nëpërmjet parlamentarizmit si sistem i sundimit dhe formë e rregullimit politik të shoqërisë civile. Rritja më e madhe në respektimin e të drejtave civile dhe lirive është realizuar në Angli, me vendosjen e parlamentarizmit si formë e sundimit. Edhe pse me shumë rezistime, rregullimi parlamentar gradualisht vendoset edhe në shtetet tjera siç janë Franca, SHBA etj. Në shtetet parlamentare, Parlamenti është organi më i lartë i pushtetit ligjvënës. Ai i miraton ligjet, e miraton buxhetin e shtetit, e zgjedh qeverinë dhe e përcakton politikën e brendshme dhe të jashtme.

Në punën e Parlamentit marrin pjesë deputetët e zgjedhur me mandat 4 vjeçar ndërsa jetën politike e udhëheqin partitë politike. Tipar i këtij sistemi të sundimit është ekzistimi i më shumë partive politike të cilat bëjnë luftë të ndërsjellë politike për marrjen e pushtetit.

Çka paraqet parlamentarizmi si sistem i sundimit?



Lulëzimi i industrisë gjermane

LUFTA E FUQIVE TË MËDHA PËR PRESTIGJ NË EVROPË, NË AZI DHE AFRIKË

Çështja e pushtimeve koloniale dhe ndarja e sërishme e botës ndërmjet fuqive të mëdha kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, gjithnjë e më shumë i kanë ashpërsuar marrëdhëniet politike ndërkombëtare. Luftërat e para për ndarjen e sërishme të botës kanë pasur karakter lokal. Në fillim të shekullit XX në Kinë, sfera të veta të interesit kanë realizuar Anglia, Franca, Rusia dhe Gjermania. Në ndarjen e Kinës është përzier edhe Japonia me pushtimin e ishullit Formoza-Tajvan dhe Kore, ndërsa pas luftës me Rusinë ka mbisunduar edhe në Manxhuri. Pas disfatës së Spanjës, SHBA-të i kanë fituar kolonitë spanjolle Filipinet, Haiti, Guam dhe kanë dominuar në Detin e Karaibeve dhe Gjirin Meksikan. Lufta koloniale është zhvilluar edhe në Afrikën Jugore ndërmjet Anglisë dhe Burëve, shtetet e të cilëve, Oranzh dhe Transvall janë bërë koloni angleze.

Me bashkimin e Gjermanisë dhe Italisë, Austro-Hungaria e ka humbur ndikimin vet në marrëdhëniet politike ndërkombëtare. Por ajo nuk ka hequr dorë nga planet e saj pushtuese. Interesat strategjikë të Austro-Hungarisë kanë qenë të orientuara kah Ballkani, me ç'rast e ka pasur përkrahjen pa rezervë të Gjermanisë. Realizimi i politikës së këtillë nuk ka shkuar pa vështirësi për shkak se aty ka ardhur deri te konflikti i interesave me Rusinë, e cila ka qenë jetësisht e interesuar për zgjerimin e ndikimit të vet në Ballkan.

Pse Kina ka paraqitur sfidën më të madhe për realizimin e sferave të veta të interesit për Fuqitë e mëdha?

Kah cila krahinë ka qenë orientuar Austro-Hungaria në realizimin e planeve pushtuese?



Ndërtimi i hekurudhës në SHBA

TEMA 4

KRIJIMI I BLOQEVE IMPERIALISTE

Duke marrë parasysh se shtetet e reja kapitaliste nuk kanë qenë të kënaqura me ndarjen ekzistuese të botës, ato kanë kërkuar ndarje të re territoriale të botës. Pakënaqësia, veçanërisht është ndjerë në Gjermani, e cila në vitin 1879 ka lidhur aleancë me Austro-Hungarinë. Kësaj aleance në vitin 1882 i është bashkëngjitur Italia. Kështu është krijuar Aleanca Trepalëshe.

Krijimin e Aleancës Trepalëshe në Evropën e Mesme, Franca e ka vlerësuar si rrezik për interesat e veta shtetërorë. Për këtë arsye në vitin 1893, ka lidhur aleancë me Rusinë. Aleancës, pak më vonë i është bashkëngjitur edhe Anglia pasi që ka vlerësuar se prej Gjermanisë i kanoset rrezik. Kështu është krijuar aleanca ndërmjet Francës, Anglisë dhe Rusisë, e njohur me emrin Antanta. Marrëdhëniet ndërmjet blloqeve antagoniste, gjithnjë e më shumë janë ashpërsuar dhe haptazi janë përgatitur për luftë.

Mendoni: Cilat kanë qenë arsyet për formimin e Aleancës Trepalëshe dhe Antantës?



Eksplotimi i drurëve të kauçikut në Brazil

KRIZAT DHE KONFLIKTET NDËRKOMBËTARE USHTARAKE DHE POLITIKE



Mbreti rus Nikollaj II

Krijimi i blloqeve në Evropë ka shkaktuar krizë të thellë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Edhe para fillimit të Luftës së Parë Botërore, në rajone të ndryshme të botës ka ardhur deri te konflikti i fuqive të cilat u kanë takuar blloqeve të kundërta. Konflikti i interesave ndërmjet Gjermanisë dhe Francës në Marok e ka shkaktuar Krizën marokene të Parë (1905-1906) dhe të Dytë (1911). Ashpërsimi i marrëdhënieve ndërkombëtare është paraqitur edhe në Ballkan me aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës nga ana e Austro-Hungarisë (1908) dhe Luftërat ballkanike (1912-1913).

Të gjitha këto konflikte kanë paraqitur rrezik potencial për shpërthimin e luftës botërore. Gara për armatosje e fuqive të mëdha ka vazhduar. Industria e fuqive të mëdha është riorientuar kryesisht në prodhimtari ushtarake. Vetëm është pritur momenti i volitshëm për fillimin e luftës, e cila ka marrë përmasa botërore.

Numëroni krizat dhe konfliktet më të mëdha ndërkombëtare të cilat kanë mundur ta shkaktojnë Luftën e Parë Botërore?



Nënshkrimi i Marrëveshjes paqësore të Londrës (1913)

ARRITJET SHKENCORE DHE KULTURORE**SHKENCA DHE TEKNIKA DHE APLIKIMI I TYRE**

Zhvillimi i shkencave natyrore dhe teknike kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, ka nxitur paraqitjen e zbulimeve dhe shpikjeve të shumta teknike. Aplikimi i energjisë elektrike si forcë lëvizëse, ka bërë ndryshime revolucionare në fuqitë prodhuese.

Në vitin 1870, Simensi e ka konstruktuar tramvajin elektrik, me çka ka filluar përdorimi i tij në komunikacionin në qytetet më të mëdha në botë. Me ndërtimin e hidrocentralit të parë në botë në vitin 1890, në Gjermani janë krijuar kushte për shfrytëzimin e hidroenergjisë. Shkencëtari Nikolla Teslla në SHBA e ka konstruktuar makinën me rrymë shumëfazëshe. Kjo shpikje ka mundësuar transferimin e energjisë elektrike në distanca të mëdha. Në vitin 1879,

*Luj Paster**Maria dhe Pjer Kiri*

shkencëtari amerikan Tomas Edison e ka zbuluar llambën e parë elektrike.

Me zhvillimin e shkencës, kah fundi i shekullit XIX është zhvilluar edhe industria kimike. Përdorimi i motorëve me djegie të brendshme e ka zmadhuar prodhimtarinë e naftës. U zbuluan plehu artificial, ngjyrat artificiale, amoniaku, benzina etj. Shpikjet në këtë fushë kanë pasur përdorim të gjerë në prodhimtarinë, e veçanërisht në bujqësinë. Në zhvillimin e kimisë, vend i veçantë i ka takuar shkencëtarit Ivan Mendeleev, i cili e ka përpiluar sistemin periodik të elementeve kimike. Alfred Nobel në vitin 1867 e ka zbuluar dinamitin, ndërsa më vonë është përsosur përpunimi i barutit pa tym. Në vitin 1868, Pjer dhe Maria Kiri kanë zbuluar radiumin dhe i kanë studiuar cilësitë e tij, me çka janë vendosur themelet shkencore të radioaktivitetit.



Robert Koh

Me hulumtimin e rrezeve – X, gjermani Rentgen ka mundësuar incizim në thellësi të organeve të caktuara njerëzore, që edhe sot përdoret në medicinë. Shkencëtari francez Luj Paster ka zbuluar se bakteret janë shkaktues të sëmundjeve dhe në këtë mënyrë e ka hapur rrugën për parandalimin dhe shërimin e infektiveve. Për zhvillimin e shkencës rëndësi të veçantë paraqet emri Çarlls Darwin i cili në librin e tij *Prejardhja e llojeve* e ka zhvilluar teorinë e evolucionit. Vend të rëndësishëm në zbulimin kanë pasur mjetet për ndërlidhje dhe kinematografia. Kështu, fizikani amerikan Morze e ka përsosur telegrafin, Bell dhe Grej e kanë zbuluar ndërsa Mihajllo Pupin e ka përsosur telefonin. Lidhjet janë avancuar me zbulimin e telegrafisë pa tela dhe të radios. Me zbulimin e fotografisë, është zhvilluar edhe kinematografia.

Mendoni: Si energjia elektrike ka bërë ndryshime revolucionare në fuqitë prodhuese kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX?

Bëni projekt: Jeta dhe vepra e shkencëtarit Mihajlo Pupin, rrënjët e të cilit e kanë prejardhjen nga Maqedonia.

ARSIMI DHE KULTURA

Me zhvillimin e ekonomisë, shkencës dhe teknikës kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, në shumë vende evropiane dhe në Amerikën Veriore janë futur ndryshime në arsim. Në arsimin fillor janë shkolluar numër më i madh i nxënësve. Numri i shkollave të mesme është rritur, ndërsa janë hapur edhe shkolla profesionale në të cilat janë fituar njohuri nga teknika, tregtia, bujqësia, medicina etj. Shkollat kanë qenë të pajisura edhe me laboratorë në të cilat janë bërë eksperimente të llojllojshme. Gjithashtu, arsimi i lartë shënon përparim të madh. U rrit numri i universiteteve, e me këtë edhe i fakulteteve.

Me zhvillimin e arsimit, janë zhvilluar edhe institucionet e tjera kulturore, të cilat kanë mundësuar zhvillim të kulturës. Me qëllim që të jepet pasqyrë sa më autentike mbi jetën, në letërsi dhe në art do të zhvillohet realizmi. Përveç realizmit, janë zhvilluar edhe natyralizmi dhe simbolizmi. Përfaqësuesit më të njohur të letërsisë së asaj kohe janë: Ipolit Ten, Gi de Mopasan, Henrih Ibzeni, Emil Zola (natyralizëm), Llav Tolstoj, Fjodor Dostojevski, Mark Tveni, Romen Rolan, Xhek London, Bernard Sho, Maksim Gorki, Onore de Balzak (realistë).



Dostoevski



Llav Tolstoj

Në artin figurativ janë paraqitur më shumë drejtime: romantizmi, realizmi, natyralizmi dhe impresionizmi. Për dallim nga realizmi në artin figurativ, impresionizmi më shumë ka synuar ta shprehë mjedisin ashtu siç e kanë përjetuar artistët e jo siç ka qenë në të vërtetë. Piktorët më të njohur, pjesëtarë të impresionizmit kanë qenë: Klod Mone, Alfred Sisle, Poll Sezan, Kamij Pisaro, Ogist Renoar, Edgar Dega etj.

Në këtë periudhë, zhvillim të fuqishëm përjetojnë teatri dhe opera. Në muzikë janë paraqitur më shumë drejtime: klasicizmi (Bramsi), neoromantizmi (Çajkovski, Grig.), impresionizmi (Debisi), kurse në fillim të shekullit XX, janë paraqitur kompozitorët, paraprijësit e rrymave bashkëkohore në muzikë: Rihard Shtraus, Stravinski, Bella Bartok dhe të tjerë.

Baleti, si pjesë e artit, kulminacionin e vet e ka përjetuar menjëherë para Luftës së Parë Botërore me paraqitjen e një baleti rus në kryeqytetin francez Parisin.


Vëmendje të madhe në këtë periudhë i është përkushtuar dukjes së qyteteve evropiane. Atëherë, në Londër është rindërtuar Pallati Vestminster ndërsa në Paris, i cili është emëruar qyteti i dritës, është ndërtuar Kulla e Afelit - simboli i Francës bashkëkohore. Në qytetet më të mëdha evropiane kanë filluar të projektohen edhe shfaqje kinematografike.

Bëni projekt për pamjen e qyteteve të mëdha evropiane kah fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX.

Zbulo dhe mëso! Paraqitja e impresionizmit në artin figurativ në Evropë.



*Portreti i Zhana Mari,
Pjer Ogist Renoar*



Kulla e Afelit

**BALLKANI PREJ FUNDIT TË SHEKULLIT XVIII
DERI NË LUFTËN E PARË BOTËRORE****DOBËSIMI I SHTETIT OSMAN**

Dobësimi i shtetit Osman ka vazhduar edhe në shekullin XVIII dhe fillimin e shekullit XIX. Pas luftërave të shumta të pasuksesshme, Perandoria Otomane ka humbur pjesë të territorit të vet, me çka është keqësuar pozita e popujve të nënshtruar jomysliman. Popujt e nënshtruar e kanë shfrytëzuar dobësinë e shtetit dhe gjithnjë e më shumë e kanë përforcuar lëvizjen e tyre nacional-çlirimtare.

Që të vendosë rregull të brendshëm dhe që ta shpëtojë shtetin nga dobësimi i mëtutjeshëm, Sulltani Selim III (1789-1807) ka zbatuar reforma. Për ta përforcuar pushtetin qendror, ka formuar ushtri të re të rregullt, ndërsa ka insistuar ta përmirësojë edhe pozitën



Sulltani reformator Selimi III



Hatisherifi i Gilhanit viti 1839

e popujve të nënshtruar. Reformat e tij kanë hasur në rezistencë të fuqive reaksionare, pas së cilës sulltani është vrarë ndërsa reformat janë ndërprerë. Trashëgimtari i tij Mahmut II e ka suprimuar ushtrinë e jeniçerëve dhe ka formuar ushtri të rregullt.

Në vitin 1839, sulltani Abdull Mexhit e ka shpallur Hatisherifin e Gilhanit. Me të, të gjithë banorët e Perandorisë Otomane, pa dallim në religjion dhe përkatësi nacionale, janë barazuar para ligjit. Fillimi i Luftës së Krimesë (1853-1856) e ka penguar zbatimin e reformave.

Në vitin 1856, pushteti otoman ka shpallur akt të ri reformues i njohur si Hatihumajun. Me të, është proklamuar barazia fetare dhe nacionale e të gjithë popujve në shtet.

Cili ka qenë qëllimi i zbatimit të reformave në shtetin Otoman?

LËVIZJET NACIONALÇLIRIMTARE TË POPUJVE BALLKANIKË

Revolucioni borgjez francez kah fundi i shekullit XVIII ka pasur ndikim të fortë mbi zgjimin nacional të popujve ballkanikë: grekët, serbët, bullgarët, maqedonasit, shqiptarët, malazezët etj. Fillimi i shekullit XIX për popujt ballkanikë ka shënuar edhe fillim të luftës për çlirim nga pushteti shumëshekullor otoman.

Luftërat nacionalçlirimtare, më së pari i kanë filluar populli serb dhe grek. Kryengritjet serbe të vitit 1804 dhe 1815, kanë qenë lajmëtarët e fillimit të luftës për çlirim kombëtar të popujve ballkanikë. Pas popullit serb në vitin 1821, luftën çlirimtare e ka filluar edhe populli grek. Falë organizimit më të mirë të kryengritjes, grekët do të jenë populli i parë në Ballkan i cili do të fitojë shtet të pavarur. Një vit më vonë, atyre u është bashkëngjitur edhe populli maqedonas i cili e ka ngritur kryengritjen e Negushit, mandej, në vitin 1876 atë të Razllovit dhe në vitin 1878, kryengritjen e Kresnenit. Në vitin 1876 në Bullgari ka shpërthyer kryengritje e madhe antiturke e njohur në histori si Kryengritje e prillit. Në luftërat për çlirimin nga osmanlinjtë, pjesëmarrje aktive kanë marrë edhe malazezët, të cilët edhe para se ta fitojnë pavarësinë në pjesën më të madhe të Malit të Zi kanë pasur vetëqeverisje të brendshme. Në periudhën e njëjtë, edhe në Shqipëri është përforcuar lëvizja nacionalçlirimtare.



Pjesëmarrësit e Kongresit të Berlinit

Rëndësi të madhe në zhvillimin e mëtutjeshëm të Ballkanit ka pasur Kryengritja në Bosnjë dhe Hercegovinë (1875) e cila e ka shkaktuar Krizën e madhe Lindore e cila e ka përfshirë pothuajse tërë Ballkanin.

Cilat kanë qenë kryengritjet e mëdha të popujve ballkanikë kundër pushtetit osman në shekullin XIX?

LUFTA RUSO-TURKE NË VITIN 1877/78


Pas shpërthimit të kryengritjes në Bosnjë dhe Hercegovinë, qeveria serbe dhe malazeze janë përpjekur ta shfrytëzojnë pozitën e dobësuar të Osmanlinjve për çlirimin e vendeve të veta të cilat kanë qenë nën pushtetin otoman. Për këtë arsye, në vitin 1876, ka filluar lufta kundër Perandorisë Otomane.

Kryengritja e ka tërhequr vëmendjen edhe të fuqive të mëdha. Pasi që Porta e ka refuzuar planin e tyre për reforma, Rusia, e cila ka qenë e interesuar ta zgjerojë ndikimin e vet në Ballkan, e ka shfrytëzuar këtë dhe i ka shpallur luftë Turqisë në vitin 1877. Ushtria ruse e ndihmuar nga vullnetarët romanë, bullgarë, serbë dhe maqedonas, e ka kaluar Danubin dhe ka depërtuar në Bullgarinë Veriore. Pas ofensivës së suksesshme, ajo ka mbërri para Konstantinopojës. Më 3 mars të vitit 1878, Turqia e cila ka pësuar disfatë, në Shën Stefan ka nënshkruar paqe me Rusinë.

Me dispozitat e Marrëveshjes paqësore të Shën Stefanit, është paraparë që të shpallen të pavarura: Serbia, Mali i Zi dhe Romania, ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë të vendosen reforma. Është parashikuar edhe themelimi i një shteti të ri autonom vasal bullgar. Në përbërjen e të a.q. Bullgarisë së Shën Stefanit, përveç vendeve bullgare është parashikuar të hyjnë edhe tërë Maqedonia (pa Selanikun dhe Halkidikin), pjesë të Serbisë juglindore dhe pjesë të Shqipërisë dhe Greqisë.

Fuqitë e mëdha kanë konsideruar se me Bullgarinë e Shën Stefanit, e cila praktikisht asnjëherë nuk është realizuar, shumë është përhapur ndikimi rus dhe prandaj kanë kërkuar revizion. Në Berlin (13 qershor -13 korrik 1878) është mbajtur kongresi në të cilin janë ndryshuar zgjidhjet e Shën Stefanit.

Kongresi i Berlinit i ka ndryshuar kufijtë e vendeve ballkanike. Serbia, Mali i Zi dhe Romania janë shpallur shtete të pavarura. Austro Hungaria ka fituar të drejtë ta okupojë Bosnjën dhe Hercegovinën. Prej të a.q. Bullgarisë Shën Stefane ka mbetur vetëm një principatë e vogël autonome Bullgari me obligim t'i paguajë tatim Turqisë,



Logori ushtarak serb në Shkup (1913)

ndërsa në jug të Malit të Vjetër është formuar krahina autonome Rumelia Lindore, e cila ka mbetur nën pushtetin suprem të Turqisë. Sipas nenit 23 të marrëveshjes, Maqedonia dhe territoret tjera ballkanike kanë mbetur nën pushtetin otoman, janë parashikuar reforma.

Cilat kanë qenë zgjidhjet e marrëveshjes së Shën Stefanit? Pse është mbajtur Kongresi i Berlinit?

LUFTËRAT BALLKANIKE

Në fillim të shekullit XX, Maqedonia, Kosova, Odrini, Sanxhaku dhe Shqipëria akoma kanë qenë nën pushtetin osman. Duke e shfrytëzuar pakënaqësinë e popullsisë nga regjimi i xhonturqve, shtetet fqinje ballkanike kanë paraqitur pretendime për okupimin e territoreve të caktuara nga Shteti otoman. Në përpjekjet e tilla e kanë pasur përkrahjen e Rusisë, e cila ka qenë e interesuar për ta përforcuar ndikimin e vet në Ballkan.

Në vitin 1912 Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi kanë lidhur Aleancë Katërpalëshe, e njohur si Aleanca Ballkanike. Pas përfundimit të përgatitjeve ushtarake, e pas refuzimit të Turqisë që të bëjë reforma në pjesën evropiane të vendit, më 9 tetor të vitit 1912, shtetet ballkanike i kanë shpallur luftë. Pasi që është mundur, Turqia ka kërkuar paqe. Konferenca paqësore është mbajtur në Londër. Sipas marrëveshjes paqësore të lidhur më 30 maj të vitit 1913, Turqia ka qenë e detyruar që t'i lirojë pothuajse të gjitha territoret që i ka mbajtur në Ballkan. Është formuar shteti autonom i Shqipërisë ndërsa Maqedonia është ndarë ndërmjet Serbisë, Bullgarisë, Greqisë.

Bullgaria, e cila nuk ka qenë e kënaqur nga zgjidhjet e Konferencës së Londrës, më 29 qershor të vitit 1913 u ka shpallur luftë Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi. Kjo luftë është e njohur si Lufta e Dytë Ballkanike. Gjatë luftës, Bullgaria në veri ka qenë e atakuar nga Rumunia ndërsa në jug nga Turqia. E mundur nga të gjitha anët, Bullgaria ka qenë e detyruar të kërkojë paqe. Paqja është lidhur më 10 gusht të vitit 1913 në Bukuresht. Me Marrëveshjen Paqësore të Bukureshtit, është konfirmuar ndarja e Maqedonisë: pjesa e Vardarit i ka takuar Serbisë, pjesa e Egjeut Greqisë ndërsa pjesa e Pirinit Bullgarisë. Një pjesë e vogël e Maqedonisë jugperëndimore ka mbetur nën Shqipërinë. Rumunia e ka fituar Dobrukhën Jugore ndërsa Turqia e ka kthyer pjesën e Odrinit. Me këtë janë vizatuar kufijtë e rij në Ballkan.

Cilat kanë qenë pasojat e luftërave ballkanike?



*Gadishulli Ballkanik
Pas luftërave Ballkanike*

**TEMA 5.
KOHA MË E RE**

LUFTA E PARË BOTËRORE

ARSYET, SHKAKU DHE FILLIMI I LUFTËS



Arrestimi i Gavrillo Principit

Antagonizmi ndërmjet fuqive qendrore dhe Antantës nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, gjithnjë e më shumë është zmadhuar. Në atë periudhë ka filluar lufta e intensifikuar ndërmjet shteteve të mëdha kapitaliste për mbisundim në botë. Shtetet kapitaliste më të vjetra si Anglia, Franca dhe Rusia, kanë mbisunduar me pjesën më të madhe të kolonive, të cilat kanë disponuar me burime të pasura të lëndëve të para dhe me tregje të mëdha. Përkundër atyre, shtetet më të reja kapitaliste - Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia janë përpjekur që me dhunë të grabisin nga

burimet e pasura të lëndëve të para në kolonitë.

Mospajtimet ndërmjet dy aleancave janë bërë aq të mëdha që nuk kanë mundur të zgjidhen me rrugë të qetë. Për këtë arsye, edhe njëra palë edhe pala tjetër, janë përgatitur në mënyrë intensive për luftë. Gjermania, në mënyrë ushtarake është përgatitur më herët se kundërshtarët e saj dhe ka kërkuar shkas për fillimin e luftës.

Shkas për fillimin e Luftës së Parë Botërore ka qenë atentati mbi trashëguesin e fronit të Austro-Hungarisë Franc Ferdinandi, në Sarajevë më 28 qershor të vitit 1914. Atentatin e ka kryer Gavrillo Principi, anëtar i organizatës revolucionare të fshehtë Bosnja e Re. Austro-Hungaria, e ka akuzuar Serbinë se e ka organizuar atentatin, dhe ka dërguar ultimatum me kërkesa të papranueshme. Austro-Hungaria, me përkrahjen e Gjermanisë i ka shpallur luftë Serbisë më 28 korrik të vitit 1914. Lufta menjëherë është shndërruar në luftë imperialiste botërore. Gjatë luftës, operacionet luftarake janë zhvilluar në më shumë fronte: Fronti Perëndimor, Lindor, i Kaukazit, fronti Ballkanik dhe Maqedonas (i Selanikut).

Cilat kanë qenë arsyet për Luftën e Parë Botërore?



Shtetet e Aleancës Trepalëshe dhe Antantës

FRONTI BALLKANIK

Së shpejti, pas shpalljes së luftës, forcat ushtarake të Austro-Hungarisë kanë ndërhyrë në Serbi. Edhe pse e lodhur nga Luftërat Ballkanike, ushtria serbe në vitin 1914 ka arritur disa fitore në malin Cer dhe në lumin Kollubarë. Në vjeshtë të vitit 1915, Austro-Hungaria, me ndihmën e Gjermanisë ka bërë ofensivë të re në Serbi. Pasi që në tetor të vitit të njëjtë Serbisë i ka shpallur luftë edhe Bullgaria, ushtria serbe ka qenë e detyruar që nëpërmjet Shqipërisë të tërhiqet në ishullin e Korfuzit. Atëherë, ushtritë e Aleancës Trepalëshe e kanë okupuar Serbinë dhe Malin e Zi.



Ushtarët gjerman në Shkup

Përshkruani rrjedhën e operacioneve në Frontin Ballkanik në vitin 1914 dhe 1915?

**LUFTA NË FRONTIN PERËNDIMOR DHE
LINDOR NË VITIN 1914 DHE 1915**

Në Frontin Perëndimor, operacionet ushtarake janë zhvilluar ndërmjet ushtrive franceze dhe gjermane. Në betejën te lumi Marna në vitin 1914, është ndaluar përparimi gjerman në Francë. Lufta në këtë front, një kohë të gjatë është zhvilluar nëpër llogore, pa ndonjë ndryshim të madh.

Pasi ka kuptuar se nuk mund ta realizojë planin e vet në Frontin Perëndimor, Gjermania e ka përforcuar luftën në Frontin Lindor kundër Ruisë. Megjithatë, edhe në këtë front, ushtria gjermane dhe austro-hungareze kanë qenë të detyruara të bëjnë luftë afatgjate nëpër llogore.

Pas fillimit të luftës, të dy blloqet janë përpjekur që t'i përfitojnë shtetet neutrale në anën e vet. Antanta, ka arritur që ta përfitojë Italinë - e cila ka qenë anëtare e Aleancës Trepalëshe, duke ia premtuar vendet nëpër bregdetin Adriatik. Kështu, në muajin maj të vitit 1915, Italia, i ka shpallur luftë aleates së saj të mëparshme Austro-Hungarisë. Në ndërkohë, Aleanca Trepalëshe e ka përfituar Bullgarinë me premtim se pas fitores, do t'ia japë tërë Maqedoninë dhe Serbinë Lindore.

Pse ka kaluar Italia në Antantë?

RRJEDHA E LUFTËS NË VITIN 1916

Gjatë vitit 1916, në frontin Perëndimor, ushtritë gjermane janë ndaluar te fortesa Verdun. Gjermania, duke parë se nuk ka fitore në tokë, është përpjekur të fitojë në det. Në maj të vitit 1916, është zhvilluar beteja më e madhe detare te gadishulli Jutland në Detin Baltik.

Lufta, ka marrë përmasa më të ashpra. Për herë të parë në histori janë përdorur tanket, aeroplanët dhe nëndetëset, me çka, numri i viktimave njerëzore është bërë gjithnjë e më i madh.

Nga fundi i vitit 1915, Antanta ka hapur front të ri në Selanik, të njohur si fronti i Selanikut (maqedonas), i cili ka kaluar nëpër mjedisin e territorit maqedonas. Pas luftës njëjavore, ushtria anglo-saksone dhe ushtria serbe e kanë shkatërruar ushtrinë bullgaro-gjermane dhe e kanë pushtuar Manastirin. Por, përparimi i mëtutjeshëm është ndaluar.

Hulumto dhe mëso! Fronti i Selanikut (i Maqedonisë).

FUNDI I LUFTËS DHE PASOJAT

Operacionet ushtarake që i ka bërë Rusia në frontin Lindor, kanë shkaktuar proteste masovike te populli. Në vitin 1917, kjo pakënaqësi është shndërruar në revolucion të madh. Republika e porsashpallur Sovjetike, në krye me V.I.Lenin, ka lidhur paqe me Gjermaninë dhe ka dalë nga Lufta e Parë Botërore.

Në vitin 1917, SHBA kanë hyrë në luftë në anën e Antantës. Ushtritë e Antantës kanë ndërmarrë ofensivë në të gjithë frontet. Në frontin e Selanikut (të Maqedonisë), në shtator të vitit 1918, Antanta e ka shkatërruar ushtrinë bullgaro-gjermane dhe e ka çarë frontin. Bullgaria, ka qenë e detyruar të nënshkruajë kapitullim, ndërsa pas saj të njëjtën e ka bërë edhe Turqia. Më 3 nëntor të vitit 1918, kapitullim ka nënshkruar edhe Austro-Hungaria.

Edhe në Frontin Perëndimor, fuqitë e Antantës pa ndalë e kanë ndjekur ushtrinë gjermane. Më 11 nëntor të vitit 1918, Gjermania ka nënshkruar kapitullim me çka edhe ka përfunduar Lufta e Parë Botërore.

Lufta e Parë Botërore, ka pasur karakter imperialist. Sipas përmasave të saj, i ka tejkaluar të gjitha luftërat e mëparshme në historinë e njerëzimit. Në fushën e luftës, kanë vdekur mbi 10 milionë njerëz ndërsa numri i të plagosurve ka qenë dyfish më i madh. Edhe përkaj kësaj, gjatë dhe menjëherë pas luftës, nga uria dhe nga sëmundjet kanë vdekur 20 milionë njerëz në botë. Lufta e Parë Botërore, i ka shkaktuar dëm material të jashtëzakonshëm njerëzimit.

Si ka përfunduar Lufta e Parë Botërore?

Cilat kanë qenë pasojat nga Lufta e Parë Botërore?

BOTA NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

ANTAGONIZMAT NË BOTË NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Me zgjidhjet e konferencës paqësore të Versajës, jo vetëm që nuk janë zgjidhur kundërthëniet prej para luftës, por janë krijuar edhe të reja. Kështu, janë thelluar antagonizmat ndërmjet të mundurve ose shteteve revizioniste (Gjermania, Bullgaria, Hungaria, Austria dhe Turqia) dhe fitimtarëve ose shteteve antirevizioniste (Anglia, Franca dhe aleatët e tyre). Shtetet revizioniste kanë synuar t'i revidojnë Marrëveshjet Paqësore të Parisit dhe me këtë t'i kthejnë territoret e humbura ndërsa shtetet antirevizioniste kanë dashur që me çdo çmim t'i ruajnë territoret që i kanë fituar.

Në këtë periudhë, vjen në shprehje gara dhe lufta gjithnjë më e fuqishme për mbisundim dhe zotërim në botë. Në këtë kuptim, kanë ekzistuar kundërshtime të mëdha ndërmjet Francës dhe Anglisë në raport me Gjermaninë dhe kolonitë e saj. Franca e cila ka dashur të realizojë hegjemoni në Evropë, ka qenë e interesuar që Gjermanisë të mos i mundësohet të zhvillohet në fuqi botërore. Politikës së këtyllë të Francës për hegjemoni evropiane i është kundërvënë Anglia, e cila ka dashur që ta mbajë rolin e arbitrit në Evropë.

Antagonizma të ngjashme ka ekzistuar edhe ndërmjet SHBA dhe Japonisë, për dominim në Oqeanin e Qetë (Pacifik). Ashpërsimi i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy shteteve ka kulminuar me luftë në periudhën e Luftës së Dytë Botërore.

Qëndrim unik, shtetet kapitaliste kanë pasur në raport me Bashkimin Sovjetik. Ato kanë synuar që ta shkatërrojnë pushtetin sovjetik dhe t'i shuajnë lëvizjet revolucionare dhe



Frenklin Dellano Ruzvellt

TEMA 5

nacionalçlirimtare në botë. Me dëshirë që të ruhet fryma e marrëveshjeve paqësore të Parisit, Anglia dhe Franca kanë synuar të formojnë sistem të aleancave për siguri kolektive evropiane, të orientuar kryesisht kah Gjermania, Hungaria dhe Bullgaria. Kështu, në vitin 1921, është formuar aleanca franceze-belge, pastaj në vitin 1920-1921 Çekosllovakia, Mbretëria SKS dhe Rumunia e kanë formuar Antantën e Vogël, të drejtuar kryesisht kah Hungaria. Përveç kësaj, Franca e ka formuar edhe Antantën Baltike (Polonia, Letonia, Estonia dhe Finlanda), ndërsa në vitin 1934 është formuar Antanta Ballkanike në të cilën kanë hyrë Jugosllavia, Rumunia dhe Turqia. Në vitin 1925, me nismë të Anglisë, në Llokarno (Zvicër), është nënshkruar pakt për sigurinë e kufijve.

Anglia, Japonia dhe vende të tjera e kanë nënshkruar Paktin Briant-Kellog. Me këtë marrëveshje, nënshkruesit janë obliguar se nuk do të përdorin fuqi ushtarake si mjet për zgjidhjen e çështjeve kontestuese.

Cilat kanë qenë antagonizmat ndërmjet dy luftërave botërore?

LIDHJA E KOMBEVE

Për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në botë, me propozim të presidentit të SHBA-ve Vudro Uillson, në prill të vitit 1919, është formuar organizata ndërkombëtare Lidhja e Kombeve, me seli në Gjenevë. Organet kryesore të Lidhjes së Kombeve kanë qenë: Asambleja e Përgjithshme, ku kanë bërë pjesë përfaqësues të të gjithë anëtarëve dhe Këshilli i Lidhjes së Kombeve, i përbërë prej 15 anëtarëve prej të cilëve 5 kanë qenë anëtarë të përhershëm. Ka ekzistuar edhe Sekretariati në krye me Sekretariatit e Përgjithshëm.

Lidhja e Kombeve është pranuar me shpresa të mëdha për ruajtjen e paqes botërore. Por, Lidhja nuk i ka arsyetuar të priturat për arsye se është shndërruar në mjet të fuqive të mëdha- fituese në Luftën e Parë Botërore (Anglia dhe Franca). Shumë shtete nuk kanë qenë anëtare të Lidhjes së Kombeve ndërsa për shkak të ca joefikasiteteve në zgjidhjen e problemeve, e kanë braktisur atë. Jo efikasiteti i kësaj organizate ka ardhur veçanërisht në shprehje gjatë agresioneve fashiste. Duke mos mundur ta parandalojë Luftën e Dytë Botërore, Lidhja ka pushuar së ekzistuari.



Seancë e Lidhjes së Kombeve (1926)

Pse Lidhja e Kombeve nuk ka pasur sukses t'i realizojë qëllimet e veta?

KRIZA E MADHE EKONOMIKE



Radha për ushqim falas në Çikago (SHBA)

Nga fundi i viteve të njëzeta, botën e ka tundur Kriza e madhe ekonomike e cila ka zgjatur në periudhën prej 1929 deri 1933. Kriza ka filluar në SHBA dhe me shpejtësi të vetëtimës i ka përfshirë të gjitha degët e ekonomisë: bujqësinë, industrinë, tregtinë dhe financat. Prodhimtaria ka rënë në gjysmë në raport me vitin 1928. Shumë fabrika dhe banka kanë pushuar me punë. Që të mbahen çmimet në nivel të kënaqshëm, janë shkatërruar sasi tejmasë të drithit, të mishit, të sheqerit, kafes etj. Mbi 30 milionë punëtorë kanë mbetur pa punë. Kriza ekonomike prej SHBA-ve shpejt është përhapur edhe në Evropë. Prej krizës më së shumti kanë qenë të goditur SHBA-të dhe Gjermania.

Rrugët për dalje nga kriza kanë qenë të ndryshme. Me fitoren në zgjedhjet presidenciale në SHBA, Frenklin Ruzvellt ka përpiluar program të njohur me emrin Nju Dill (Kurs i Ri). Për ta zvogëluar papunësinë, shteti ka organizuar punë publike - ndërtim të kanaleve, të rrugëve, të hidrocentraleve etj. Janë miratuar ligje sociale, sindikatat kanë fituar të drejta më të mëdha, ndërsa mëditjet e punëtorëve janë rritur. Në Gjermani, dalja nga kriza është zgjidhur me vendosjen e diktaturës fashiste dhe me militarizimin e ekonomisë.

Në cilën mënyrë SHBA kanë dalë nga kriza e madhe ekonomike?



Fëmijët në radhë për bukë falas

DEMOKRACIA QYTETARE

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, bota ka qenë e përfshirë nga një krizë politike serioze. Në disa vende, për shkak të krizës ekonomike, sistemet demokratike me ideologjitë e tyre liberale kanë hyrë në krizë të thellë. Ideologjitë totalitare kanë qenë gjithnjë e më të pranishme në jetën politike evropiane. Konflikti ndërmjet totalitarizmit dhe liberalizmit ka qenë një nga kontradiktat kryesore në jetën politike në Evropë. Regjimet klasike të para totalitare janë vendosur në Itali dhe në Gjermani.

Përkundër ideologjisë totalitare, në shumicën e vendeve evropiane dhe në SHBA ka vazhduar zhvillimi i demokracisë. Funksionimi i demokracisë parlamentare është siguruar nëpërmjet pjesëmarrjes së barabartë në jetën politike të të gjitha partive legale politike. Zhvillimi i demokracisë e ka arritur kulmin më të madh në Francë dhe në Zvicër si shtete me rregullim civil republikan. Por, edhe në monarki të caktuara parlamentare, si për shembull në Angli, gjithashtu janë garantuar dhe janë zgjeruar të drejtat dhe liritë civile. Në këto vende, sindikatat kanë pasur rol të madh në mbrojtjen e të drejtave dhe në mbrojtjen e punëtorëve.

Hulumto dhe mëso! Cili është dallimi ndërmjet regjimeve totalitare dhe sistemeve demokratike?



Radhë për punë (Nju Jork 1931)

BASHKIMI SOVJETIK FAKTOR NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

REVOLUCIONI I TETORIT

Me hyrjen në Luftën e Parë Botërore, Rusia ka hyrë në krizë të thellë ekonomike dhe politike. Të gjitha shtresat sociale, përveç mbretit dhe bashkëpunëtorëve të tij, kanë kërkuar ndërprerje të luftës. Pakënaqësia e popullatës është shndërruar në demonstrata të mëdha popullore në kryeqytetin e Ruisë, në Petrograd. Më 25 shkurt të vitit 1917, demonstratat janë shndërruar në Revolucionin e shkurtit. Mbreti Nikollaj II Romanov ka qenë i detyruar të abdikojë.

Pas revolucionit në Rusi pushteti është ndarë ndërmjet Qeverisë së përkohshme në krye me Aleksandar Kerenski dhe Këshillat e punëtorëve dhe ushtarëve. Kjo ka qenë periudha e dualizmit politik në historinë e Ruisë.

Së shpejti më 24 tetor (6 nëntor) të vitit 1917, ka shpërthyer Revolucionin e tetorit në krye me Vlladimir Iliç Lenin. Me pushtimin e Pallatit dimëror në Petrograd, ku ka qenë e vendosur Qeveria e Përkohshme, pushtetin e kanë marrë Këshillat dhe në këtë mënyrë i është vënë fund pushtetit dualist.

Natën e 25 tetorit (7 nëntori) të vitit 1917, ka filluar me punë Kongresi i Dytë i Këshillave. Pushteti i ri bolshevik (komunist) ka marrë më shumë vendime (dekrete): Dekret për pushtetin, sipas të cilit tërë pushteti ka kaluar në duart e këshillave, Dekret për paqen, sipas të cilit është parashikuar lidhja e paqes dhe Dekret për tokën, sipas të cilit toka është shpallur si gjithpopullore dhe u është ndarë për shfrytëzim fshatarëve.

Gjithashtu, është miratuar edhe Deklarata për të drejtat e popujve në Rusi, me të cilën është pranuar e



V.I.Lenin flet para popullit



Mbreti Nikollaj II Romanov

TEMA 5

drejta për vetë përcaktim të popujve në shtet. Në fund të punës së vet, Kongresi e ka formuar qeverinë e parë sovjetike në krye me V.I.Lenin.

Sqaroni vendimet më të rëndësishme të marra në Kongresin e Dytë të Këshillave?

LUFTA CIVILE



Sulmi i Pallatit dimëror

bërë bashkimi i të gjitha republikave sovjetike në një shtet federal të quajtur Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS). Së shpejti pastaj është zgjedhur edhe qeveria e parë në krye me V.I.Lenin.

Pse ka shpërthyer lufta civile në Rusi?

ZHVILLIMI EKONOMIK I BRSS

Pas fitores në Revolucionin e tetorit, situata ekonomike në Rusi ka qenë skajshëm e keqësuar. Për ta përmirësuar gjendjen e përgjithshme në shtet, pushteti që në periudhën e Luftës civile e ka zbatuar politikën e të a.q. komunizëm ushtarak. Është vendosur puna e detyrueshme për të gjithë qytetarët dhe është vendosur grumbullimi i detyrueshëm i produkteve bujqësore.

Megjithatë, politika e komunizmit ushtarak ka shkaktuar pakënaqësi të madhe te fshatarët. Me qëllim që ta nxisë popullin ta rrisë prodhimtarinë, qeveria sovjetike ka filluar të zbatojë një Politikë të re ekonomike. (PRE). Me të, pushteti ka

*Llav Troicki*

lejuar kthim të disa elementeve të ekonomisë tregtare, ashtu që teprica e prodhimeve bujqësore ka mundur të shitet lirshëm në treg.

Në vitin 1928, në BRSS është miratuar plani i parë pesëvjeçar (PETOLETKA) i cili ka parashikuar industrializim dhe elektrifikim, si edhe kolektivizim të bujqësisë me formimin e kooperativave të quajtura kolkoze dhe sovkoze.

Pse është vendosur Politika e re ekonomike (PRE)?

DIKTATURA E STALINIT

Në vitin 1924, pas vdekjes së V.I.Leninit pushtetin e ka ndërmarrë Josif Visarionoviç Stalin. Ai ka arritur ta mënjanojë dhe ta likuidojë të a.q. majtistët në krye me Llav Trocki dhe të a.q. djathtistët në krye me Nikollaj Ivanoviç Buharin dhe të vendosë diktaturë personale me politikë të terrorit të bardhë. Si pasojë e kësaj politike, janë paraqitur deformime, kufizime të demokracisë, paraqitje e burokracisë dhe e kultit në person. Të gjithë kundërshtarët politikë kanë qenë nën represion dhe të dërguar në llogoret siberiane (gullazë).

Revolucioni i Tetorit ka pasur ndikim të madh në botë. Në Gjermani dhe në Hungari kanë shpërthyer revolucione proletare të cilat janë shuar shpejt. Në vitin 1918 në Moskë është formuar Internacionalja e tretë (komuniste) -Kominterni, me qëllim që ta udhëheqë lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe ta realizojë idenë për revolucionin proletar botëror.

Në vitin 1939, Stalini ka lidhur pakt për mos atakim me Hitlerin. Në këtë mënyrë, BRSS ka dashur ta evitojë luftën me Gjermaninë, e cila ka qenë gjithnjë më e sigurt.

Cilat kanë qenë pasojat e sundimit të Stalinit për BRSS dhe më gjerë?

*Josif Visarionoviç Stalin*

FASHIZMI DHE NACIONALSOCIALIZMI

PARAQITJA E FASHIZMIT

Menjëherë pas përfundimit të Luftës së Parë botërore, në disa vende evropiane dhe në botë ka filluar periudhë e ashpërsimit të marrëdhënieve ekonomike, politike dhe shoqërore. Në kushte të atilla, borgjezia revolucionare duke u frikësuar nga ndryshimet revolucionare, a që t'i ruajë interesat e veta ekonomike dhe politike, e ka braktisur demokracinë dhe parlamentarizmin dhe e ka pranuar fashizmin, si llojin më të vrazhdë të totalitarizmit. Në disa vende, fashizmi është përforcuar si sistem politik i pushtetit, ndërsa në vende tjera është paraqitur si lëvizje politike.

Ideologjia fashiste ka përhapur urrejtje nacionale dhe racizëm dhe është shërbyer me premtime boshe se do t'i zgjidhë problemet në shoqëri dhe do t'i shpëtojë të varfrit nga pozita e tyre e vështirë.

Fashizmi, në fillim është paraqitur në Itali e mandej edhe në vendet tjera si për shembull Austri, Spanjë, Portugali, Rumuni, Hungari kurse veçanërisht ka ardhur në shprehje në Gjermani dhe në Japoni. Qëllimi i fashizmit në politikën e jashtme ka qenë të realizojë dominim botëror ndërsa në politikën e brendshme të vendosë pushtet diktatorial. Në këto sisteme shteti dhe udhëheqësi i saj duhet të jenë mbi të gjitha.



Benito Mussolini - Duçë

Cilat kanë qenë arsyet për paraqitjen e fashizmit? Në cilat vende është paraqitur fashizmi?

PARAQITJA E FASHIZMIT NË ITALI

Pas Luftës së Parë Botërore Italia ka qenë e pakënaqur nga zgjidhjet territoriale të marrëveshjeve paqësore të Parisit dhe ka qenë e përfshirë me krizë ekonomike të rëndë, e cila ka shkaktuar lëvizje të fuqishme punëtore, veçanërisht në Italinë Veriore. Komunistët italianë janë bërë fuqi e rëndësishme në shoqëri. Në kushte të atilla, është paraqitur fashizmi, në krye me Benito Musolinin. Prej vitit 1919 Musolini ka formuar njësi fashiste fasho. Në vitin 1922, fashistët në Napoli e kanë mbajtur kongresin e tyre të parë ku me ndihmën e bashkëmendimtarëve të vet Musolini e ka realizuar të a.q. Marsh në Romë dhe e ka ndërmarrë pushtetin. Mbreti italian Emanuel III ia ka dorëzuar pushtetin Musolinit i cili është bërë udhëheqës - duçe i popullit italian me ç'rast ka vendosur diktaturë fashiste. Musolini ka formuar njësi fashiste këmisha të zeza, polici të fshehtë, ndërsa i ka ndaluar partitë dhe shoqatat partiake.

Në planin e jashtëm, Italia ka vendosur politikë pushtuese ndaj Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë dhe shndërrimin e Detit Mesdhe në Detin Italian. Ideja e Musolinit ka qenë ta shndërrojë Italinë në Perandori, sipas shembullit të Perandorisë Romake të dikurshme.

Sqaroni paraqitjen e fashizmit në Itali.

Hulumto dhe mëso! Si gazetar i mëparshëm, si ka qenë sjellja e Musolinit ndaj shtypit italian?



„Marshi në Romë“

NAZIZMI NË GJERMANI

Pas Luftës së Parë Botërore, Gjermania ka hyrë në krizë të rëndë nacionale, politike dhe ekonomike. Në kushte të atilla në vitin 1919, në Munih është themeluar Partia nacional - socialiste (naziste) në krye me Adolf Hitlerin. Anëtarët e saj janë emëruar nazistë ndërsa ideologjia e saj fashiste - nazizëm. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 1932, partia nacional - socialiste e ka fituar numrin më të madh të vendeve të deputetëve në Rajstag (parlament). Në vitin 1933, Hitleri e ka shpërndarë parlamentin, i ka suprimuar të gjitha partitë politike përveç asaj naziste dhe e ka shpallur veten për udhëheqës - firer të popullit gjerman.

Karakteristikat kryesore të nazizmit kanë qenë: nacionalizmi, antisemitizmi, racizmi, antikomunizmi dhe ekspansionizmi. Menjëherë pas ardhjes në pushtet të nazistëve në Gjermani, antisemitizmi është bërë politikë shtetërore oficiale. Në vitin 1935, janë miratuar të a.q. Ligjet e Nurembergut me të cilat hebrenjtë në Gjermani janë diskriminuar dhe nuk kanë qenë të barabartë para ligjit. Hebrenjtë janë shpallur për armiq të popullit gjerman ndërsa sinagogat e tyre, dyqanet dhe varrezat janë shkatërruar.

Karakteristikë tjetër e nazizmit ka qenë racizmi. Sipas teorisë raciste, është provuar se raca gjermane është superiore dhe se ajo duhet të sundojë me botën, dhe se gjoja racat inferiore siç janë hebrenjtë, sllavët, romët, të likuidohen ose të shndërrohen në robër.

Me politikën antikomuniste në Gjermani është bërë përpjekje të ndalohej çdo aktivitet komunist i cili është konsideruar si rreziku më i madh për nazistët. Prandaj, komunistët janë represuar dhe janë dërguar nëpër llogore. Rol të veçantë në këtë politikë në Gjermani ka pasur policia sekrete gjermane Gestapo.

Karakteristikë e rëndësishme e nazizmit ka paraqitur edhe ekspansionizmi. Pasi që e ka ndërmarrë pushtetin, A. Hitler menjëherë ka filluar të bëjë politikë aktive për revizionin e Marrëveshjeve paqësore të Parisit.

Sqaroni karakteristikat themelore të nazizmit në Gjermani.



Takimi Hitler dhe Musolini (1938)



Adolf Hitler në paradë ushtarake

AGRESIONET E PARA TË SHTETEVE FASHISTE

Shteti i parë i cili është nisur në politikë të jashtme agresive ka qenë Italia fashiste. Në vitin 1923, ajo e ka aneksuar qytetin jugosllav Rjekë dhe ishullin grek Korfuz. Në vitin 1935, Italia e ka atakuar shtetin afrikan Etiopinë (Abisininë) dhe e ka shndërruar në koloni të vet. Duke e shfrytëzuar sjelljen pasive të shteteve demokratike, katër vite më vonë, Italia e ka okupuar Shqipërinë.

Edhe më agresive se politika italiane ka qenë politika e Gjermanisë naziste. Ajo, në vitin 1935 e ka bashkuar krahinën e Sarit ndërsa vitin e ardhshëm edhe krahinën e Rajnës që pas Luftës së Parë Botërore i janë marrë dhe i janë bashkëngjitur Francës. Në vitin 1938 e ka bërë të a.q. anshllus - bashkëngjitjen e dhunshme të Austrisë kah Gjermania. E inkurajuar nga kjo, i ka filluar përgatitjet për pushtimin e Çekosllovakisë. Vitin e njëjtë është nënshkruar Marrëveshja e Munihut ndërmjet Hitlerit, Musolinit, Çemberlenit dhe Dalladie. Me marrëveshjen, i është mundësuar Gjermanisë ta kthejë krahinën Sudete të banuar me gjermanë por vitin e ardhshëm Gjermania e ka okupuar Çekosllovakinë.

Në vitin 1936, Gjermania, Italia dhe Japonia e kanë formuar boshtin Romë-Berlin-Tokio me qëllim që më lehtë t'i realizojnë qëllimet e tyre pushtuese për imponimin e rendit të ri në botë.

Për ta ndaluar politikën agresive të shteteve fashiste, fuqitë demokratike në botë kanë paraqitur rezistencë kundër fashizmit. Rol shumë të rëndësishëm ka luajtur Fronti popullor i krijuar me nismë të Kominternës në krye me sekretarin gjeneral Georgi Dimitrov. Rezistim i fuqishëm ndaj politikës fashiste është organizuar në Spanjë ku është zhvilluar Lufta civile spanjolle në të cilën fuqitë nacionaliste, të ndihmuara nga Gjermania dhe Italia, kanë arritur t'i mundin mbrojtësit republikan në radhët e të cilëve ka pasur 35.000 vullnetarë të ardhur nga 69 vende nga tërë bota.



Georgi Dimitrov



Olimpiada në Berlin 1936

BALLKANI NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

MBRETËRIA E SERBËVE, KROATËVE DHE SLLOVENËVE

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore më 1 dhjetor të vitit 1918 është formuar shteti i ri në Ballkan - Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (SKS). Në shtet janë pranuar të drejtat nacionale vetëm të tre popujve të theksuar, duke e mohuar me atë rast të drejtën për vetëpërcaktim dhe vetëqenie nacionale të popujve të tjerë (maqedonasit, malazezët etj.). Deri në vitin 1929, shteti ka qenë monarki parlamentare me rol të madh të mbretit në pushtetin ligjvënës. Në zgjedhjet e para parlamentare në vitin 1920, më së shumti vota kanë fituar Partia Demokratike Jugosllave, Partia Radikale Popullore dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë.

Mosdurimi etnik në shtet ka kulminuar në vitin 1928 kur në Parlament është vrarë lideri i Partisë Fshatare Kroate Stjepan Radiq. Duke u përpjekur ta stabilizojë monarkinë, ta ruajë rendin borgjez dhe hegjemonizmin e borgjezisë serbe, mbreti



Mbreti Aleksandër I



Atentati mbi mbretin Aleksandër Karagjorgjeviq

Aleksandër Karagjorgjeviq, më 6 janar të vitit 1929, e ka suprimuar parlamentarizmin dhe ka vendosur diktaturë. Shtetin e ka ndarë në 9 banovina ndërsa emrin e shtetit e ka ndërruar në Mbretërinë e Jugosllavisë.

Në vitin 1934, në Marsejë në Francë është vrarë në atentat mbreti Aleksandër Karagjorgjeviq nga ana e Vançomihajllivistëve. Për shkak të presionit gjithnjë më të madh që ka ardhur nga Gjermania dhe Italia, faktorët politik serb janë marrë vesh për një zgjidhje kompromisi me lëvizjen nacionale kroate. Me atë rast, në vitin 1939 është nënshkruar marrëveshja Cvetkoviq-Maçek, sipas së cilës është formuar njësi e veçantë territoriale Banovina e Kroacisë. Por, me këtë çështja nacionale në Jugosllavi nuk është zgjidhur.

Fashizimi i vendit ka vazhduar dhe si kulm i asaj politike, më 25 mars të vitit 1941, në Vjenë është nënshkruar bashkëngjitja e Jugosllavisë kah Pakti Trepalësh.

Si ka qenë pozita politike e Mbretërisë së SKS (Jugosllavisë)?

BULLGARIA PAS LUFTËS SË PARË BOTËRORE



Aleksandër Stamboliski

Disfatat e Bullgarisë në Luftërat Ballkanike dhe në Luftën e Parë Botërore kanë shkaktuar pakënaqësi të madhe në vend dhe jostabilitet të madh politik. Mbreti Ferdinand ka qenë i detyruar të abdikojë. Në favor të djalit të tij Borisit.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1919, Partia Bujqësore, në krye me Aleksandër Stamboliskin ka arritur fitore. Kursi i ri i politikës së jashtme dhe të brendshme bullgare ka shkaktuar pakënaqësi të madhe të borgjezia e madhe. Më 9 qershor të vitit 1923, partitë politike me orientim djathtistë, në krye me Aleksandar Cankov, kanë bërë grusht shteti. Në ngjarjet tragjike, ka vdekur edhe A. Stamboliski.

E pakënaqur nga ngjarjet, PKB në krye me Georgi Dimitrov, në shtator të vitit 1923, ka organizuar kryengritje, e cila është mbytur me gjak, ndërsa PKB është ndaluar.

Në vitin 1934, lideri i organizatës Zveno Kimon Georgiev, ka bërë grusht shteti dhe e ka ndërmarrë pushtetin në vend. Qeveria e re e ka ndaluar aktivitetin e VMRO-së në krye me Vanço Mihajllavin, gjë që ka ndikuar negativisht në marrëdhëniet në Ballkan dhe e ka rrezikuar edhe integritetin e shtetit bullgar. Pas vitit 1935, në planin e jashtëm, Bullgaria është orientuar kah Gjermania dhe Italia dhe ka shprehur pretendime territoriale ndaj vendeve fqinje.

Si ka qenë gjendja politike në Bullgari pas Luftës së Parë Botërore?

GREQIA PAS LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Pas Luftës së Parë Botërore, Greqia është zgjeruar në masë të madhe në llogari të Bullgarisë dhe Turqisë. Duke e marrë parasysh se Turqia nuk i ka respektuar dispozitat e Marrëveshjes paqësore të Sevrit, në vitin 1920 Greqia ka filluar luftë kundër Turqisë. Pas disfatës në luftë, Greqia ka qenë e detyruar të nënshkruajë marrëveshje paqësore në Lozanë.

Disfata në luftën greko-turke, në Greqi është përjetuar si katastrofë nacionale. Mbreti ka qenë i detyruar të abdikojë ndërsa në vitin 1924 Greqia është shpallur republikë. Një vit më vonë gjenerali Teodoros Pangallos ka vendosur diktaturë në Greqi por pa sukses t'i zvogëlojë pasionet politike në vend ndërmjet partive politike më të mëdha, Partinë Liberale dhe Popullore.

Më 4 gusht të vitit 1936, për shkak të jostabilitetit të madh në vend, gjenerali Joanis Metaksas, me afinitetin e mbretit ka vendosur diktaturë në Greqi. Sundimin e vet Metaksas e ka filluar me djegien e librave të shkrimtarëve antikë ndërsa vrazhdësi të veçantë ka treguar ndaj fuqive politike të orientuara majtë dhe maqedonasit me të cilët kanë qenë stërbushur burgjet dhe llogoret greke.

Çfarë karakteri ka pasur diktatura e Joanis Metaksas?

THEMELIMI I REPUBLIKËS SË TURQISË

Pas luftës greko-turke të përfunduar me sukses, Kemal Mustafa ka arritur ta shpëtojë Turqinë nga shpërbërja dhe t'i vendosë themelet e shtetit nacional civil modern. Në vitin 1923, Kemal Mustafa i quajtur Ataturk - babai i Turqisë, e ka shpallur shtetin republikë.

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, Kemal Ataturku është përpjekur ta modernizojë shoqërinë turke dhe ta fusë Turqinë në rrjedhat civilizuese evropiane. Falë autoritetit të tij personal dhe karakterit të



Metaksas



Mustafa Kemal Ataturk

fortë, Ataturku ka arritur ta ndajë religjionin nga shteti, ta reformojë sistemin juridik në vend sipas modelit evropian, është vendosur latinishtja, janë zgjeruar të drejtat e grave dhe është vendosur moda evropiane e të veshurit. Pas vdekjes së Kemal Ataturk, në krye të Turqisë ka ardhur Ismet Ineni. Ai e ka vazhduar politikën e Kemal Ataturkut.

Çfarë rëndësie kanë pasur reformat në Turqi në modernizimin e shtetit?

SHQIPËRIA PAS LUFTËS SË PARË BOTËRORE



Mbreti Ahmet Zogu I

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, Shqipëria ka përjetuar jostabilitet të madh politik. Në jetën politike ka ekzistuar rivaliteti ndërmjet Partisë Progresive dhe Popullore. Këto rrethana i ka shfrytëzuar koloneli Ahmet Zogu dhe në vitin 1921 e ka ndërmarrë pushtetin.

Në vitin 1928, Ahmet Zogu dhe ithtarët e tij kanë filluar të ndërmarrin masa për ta ndryshuar sistemin shoqëror në mbretëri, për çka ka qenë e interesuar edhe Italia. Atëherë Shqipëria është shpallur monarki ndërsa Ahmet Zogu mbret.

Në periudhën prej vitit 1929-1935, Shqipëria si edhe tërë bota ka qenë e përfshirë nga kriza e madhe ekonomike.

Në vitin 1939, Italia e ka okupuar Shqipërinë. Qeveria e Ahmet Zogut nuk ka organizuar asnjë rezistencë por e ka braktisur vendin. Pas bombardimit nga ajri dhe deti, trupat italiane e kanë pushtuar Durrësin, Tiranën dhe qytetet tjera, me ç'rast agresorët italianë e kanë pushtuar tërë Shqipërinë.


Si ka qenë gjendja politike në Shqipëri ndërmjet dy luftërave botërore?

LUFTA E DYTË BOTËRORE

ARSYET PËR LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Arsyet për Luftën e Dytë Botërore kanë qenë antagonizmat ndërmjet shteteve të zhvilluara kapitaliste. Ato kanë qenë të shkaktuara nga zhvillimi i tyre i pabarabartë. Paraqitja dhe përforcimi i fashizmit i ka ashpërsuar edhe më shumë ato kundërthënie, ndërsa dëshira e shteteve fashiste-militariste për ndarjen e sërishme të botës, ka sjellë deri në konfliktin e paevitueshëm me përmasa botërore. Marrëveshjet paqësore të Parisit, pas Luftës së Parë Botërore kanë sjellë zgjidhje të cilat nuk u kanë konvnuar Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë. Prandaj, në vitin 1936, Gjermania dhe Italia kanë formuar aleancë ushtarake ndërsa atyre u është bashkëngjitur edhe Japonia. Kështu është formuar blloku i fuqive fashiste Romë-Berlin-Tokio, e njohur me emrin Pakti Trepalësh.

Shtetet fitimtare nga Lufta e Parë Botërore, para së gjithash Anglia dhe Franca, të kënaqura me ndarjen, nuk kanë dashur ndryshime, por kanë kërkuar respektim të sistemit të



Versajës. Këto dy vende kanë çuar politikë lëshuese, kapitulluese ndaj Gjermanisë fashiste, e cila ka kulmuar me nënshkrimin e Marrëveshjes së Munihut në vitin 1938. Politika e tyre ka qenë edhe ta izolojnë BRSS dhe shtetet fashiste t'i drejtojnë kundër tij. SHBA-të, për shkak të mosmarrëveshjes me partnerët evropianë, gradualisht janë tërhequr në të a.q. politikë izoluese dhe nuk e ka garantuar sistemin e Versajës.

Sqaroni shkaqet për Luftën e Dytë Botërore.

FILLIMI I LUFTËS (1939-1941)



Hyrja e gjermanëve në Poloni

Shkas për fillimin e Luftës së Dytë Botërore ka qenë kërkesa gjermane që qyteti Dancig (Gdanjsk) dhe korridori i ngushtë polonez i cili e ka ndarë Prusinë Lindore nga pjesa e mbetur e Gjermanisë, t'i lirohen Gjermanisë. Polonia, duke llogaritur në ndihmën e vendeve perëndimore, e ka refuzuar kërkesën gjermane, dhe kjo ka qenë shkas që më 1 shtator të vitit 1939 Gjermania ta atakojë Poloninë. Kështu ka filluar Lufta e

Dytë Botërore. Polonia, nga lindja është atakuar edhe nga BRSS, që është parashikuar me marrëveshjen gjermano-sovjetike prej vitit 1939. Edhe përkaj rezistencës së guximshme të popullit polonez, Polonia për një kohë të shkurtër është okupuar.

Pas pushtimit të Polonisë, Gjermania ka vazhduar me pushtimin e vendeve tjera evropiane. Në prill të vitit 1940 e ka sulmuar dhe e ka okupuar Danimarkën, dhe mandej e ka sulmuar Norvegjinë. Populli norvegjez, i ndihmuar nga ushtritë aleate, ka dhënë rezistencë të fuqishme por, edhe përkaj kësaj, Norvegjia është okupuar pas tre muajsh. Për kapitullimin e Norvegjisë, rol të veçantë kanë luajtur tradhtarët vendorë nën udhëheqjen e ministrit të ushtrisë Vidkun Kuislingu, emri i të cilit është bërë sinonim për tradhtarët e vendit të vet gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në maj të vitit 1940, Gjermania i ka sulmuar dhe i ka okupuar Belgjikën, Holandën dhe Luksemburgun. Muajin e njëjtë, ushtritë gjermane kanë hyrë në Francë, duke e anashkaluar linjën mbrojtëse franceze Mazhino. Ushtritë gjermane kanë përparuar shpejtë, dhe nga fundi i qershorit të vitit 1940 Franca ka kapitulluar. Lufta, mandej është transferuar në Afrikën Veriore, ku janë pushtuar Tunizia, Algjeria dhe Maroku, ndërsa është atakuar edhe Egjipti. Pas fitores mbi Francën, Gjermania e ka sulmuar Britaninë e Madhe, e cila i është nënshtruar bombardimeve intensive ajrore.

TEMA 5

Populli britanik ka luftuar me guxim dhe i ka refuzuar sulmet gjermane. Pas sulmit të pasuksesshëm mbi Britaninë, Gjermania ka filluar përgatitje për sulm mbi BRSS.

Në këtë periudhë, Paktit Trepalësh i janë bashkëngjitur Hungaria, Rumunia dhe Bullgaria. Pasi që paraprakisht e ka okupuar Jugosllavinë, më 22 qershor të vitit 1941, Gjermania e ka atakuar BRSS dhe përsëri paktit të lidhur për mos atakim. Duke e shfrytëzuar mos përgatitjen e ushtrisë sovjetike, ushtria gjermane për një kohë të shkurtër ka depërtuar thellë në territorin e BRSS me qëllim që t'i pushtojë qytetet Moskë dhe Leningrad.

Nga fundi i vitit 1941, lufta është përhapur edhe në Lindjen e Largët. Më 7 dhjetor të vitit 1941, Japonia e ka sulmuar bazën amerikane Perll Harbur. SHBA-të mandej i kanë shpallur luftë Japonisë.



Ushtarë gjerman para Moskës

Cilat vende i ka pushtuar Gjermania gjatë vitit 1940?

RRJEDHA E LUFTËS 1942-1943

Operacionet më të mëdha gjatë vitit 1942 janë bërë në Frontin Lindor. Në ofensivën e madhe në BRSS, forcat gjermane kanë arritur deri në Stalingrad dhe Kaukaz. Lufta të mëdha janë zhvilluar te lumi Vollga, ndërsa posaçërisht e rëndësishme është Beteja e Stalingradit e cila ka zgjatur prej nëntorit të vitit 1942 deri në mars të vitit 1943 dhe në të cilën kanë marrë pjesë 2 milionë ushtarë nga të dyja palët. Beteja e Stalingradit ka përfunduar me fitore të madhe të armatës sovjetike (të kuqe). Kjo betejë e ka shënuar kthesën në Luftën e Dytë Botërore, në favor të Koalicionit antifashist. Prej atëherë, ushtria gjermane ka qenë në tërheqje të përhershme nga Fronti Lindor.

Në Frontin Afrikan (1942-1943) janë zhvilluar lufta të mëdha ndërmjet ushtrive gjermano-italiane dhe ushtrive anglo-amerikane. Me ofensivën e re aleate në pranverë të vitit 1943, ushtritë gjermano-italiane janë dëbuar nga Afrika. Në korrik të vitit 1943, ushtritë aleate kanë bërë invadim në Sicili, ndërsa pak më vonë edhe në Italinë Jugore. Pastaj, më 8 shtator të vitit 1943, Italia ka kapitulluar.

Në Frontin Pacifik, koalicioni antifashist ka radhitur suksese dhe ka kaluar në kundërofensivë. Ushtritë japoneze kanë pësuar disfata ndërsa këto ofensiva kanë shkaktuar kthesë në luftën në Pacifik.

Si janë zhvilluar operacionet në Frontin Lindor në vitin 1942-1943?

RRJEDHA E LUFTËS NË VITIN 1944 DHE 1945 DHE FUNDI I LUFTËS*Nënshkrimi i kapitullimit të Japonisë*

Në fillim të vitit 1944, në Frontin Lindor armata sovjetike ka kaluar në ofensivë në tërë linjën e frontit prej Detit të Zi deri në Detin Barents. Deri në fund të shtatorit të vitit 1944, i ka dëbuar ushtritë fashiste nga territori sovjetik dhe ka depërtuar në Poloni dhe në Çekoslovakia, mandej edhe në Rumuni, Hungari dhe Bullgari, ku janë përmbysur regjimet fashiste dhe janë formuar qeveri antifashiste të cilat i kanë shpallur luftë Gjermanisë. Me 6 qershor të vitit 1944, ushtritë aleate perëndimore kanë bërë desant në Francën Veriore në krahinën e Normandisë, dhe e kanë hapur të a.q. Front Perëndimor në Evropë. Me ndihmën e lëvizjes franceze të rezistencës, deri në shtator të vitit 1944, ushtritë aleate e kanë çliruar Francën, Belgjikën, Holandën dhe Luksemburgun dhe kanë ardhur deri në territorin e Gjermanisë.

Në pranverë të vitit 1945, ushtritë aleate pa ndalesë kanë depërtuar në Gjermani. Më 30 prill të vitit 1945, i ballafaquar me disfatën, Hitleri ka bërë vetëvrasje. Më 9 maj Gjermania ka kapitulluar. Me këtë ka përfunduar lufta në Evropë. Në ndërkohë, lufta në Lindjen e Largët kundër Japonisë ka vazhduar. Në gusht të vitit

1945 edhe BRSS i ka shpallur luftë Japonisë. Me qëllim që ta përshpejtojë fundin e luftës, Amerikanët kanë përdorur edhe bomba atomike në Hiroshimë dhe në Nagasaki. Me kapitullimin e Japonisë më 2 shtator 1945, ka përfunduar Lufta e Dytë Botërore.

Lufta e Dytë Botërore ka pasur pasoja të rënda mbi njerëzimin. Më shumë se 50 milionë njerëz e kanë humbur jetën, ndërsa rreth 35 milionë janë plagosur. Gjatë luftës e cila është

*Bomba atomike e hedhur në Hiroshimë*

zhvilluar në territorin e 40 shteteve, janë shkaktuar dëme të paçmueshme materiale. Lufta e Dytë Botërore ka pasur karakter antifashist dhe çlirues.

KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE

FORMIMI I KOALICIONIT ANTIFASHIST

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, fuqitë e mëdha, në radhë të parë SHBA, BRSS dhe Britania e Madhe, kanë filluar negociata për formimin e aleancës me të cilën do t'i kundërvihen fashizmit. Pas sulmit gjerman mbi BRSS më 22 qershor të vitit 1941, Britania e Madhe dhe BRSS, në vjeshtën e vitit të njëjtë e kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunim të ndërsjellë dhe për ndihmë ekonomike, me çka është bërë hapi i parë në formimin e Koalicionit antihitlerian. Në formimin e tij, rol të madh ka luajtur takimi ndërmjet presidentit të SHBA, Ruzveltit dhe kryeministrit britanik, Vinston Çerçilli, më 14 gusht të vitit 1941, me ç'rast është nënshkruar Karta Atlantike. Në Kartën Atlantike janë theksuar qëllimet politike të luftës, ndër të cilat përparësi i është dhënë mundjes së fashizmit dhe të gjithë popujve t'u jepet e drejta që pas luftës ta zgjedhin lirshëm rregullimin e tyre shtetëror.

Koalicioni antifashist, zyrtarisht është formuar më 1 janar të vitit 1942, kur 26 shtete të botës e kanë nënshkruar në Uashington Deklaratën, me të cilën janë pajtuar për luftë të përbashkët deri në fitoren përfundimtare kundër fashizmit.

Si është krijuar Koalicioni antifashist?

KONFERENCA E TEHERANIT

Fitoret e mëdha të aleatëve gjatë vitit 1943, e kanë imponuar nevojën për mbajtjen e një takimi të shefave të tri fuqive antifashiste, SHBA, Britania e Madhe dhe BRSS. Kështu, prej 28 nëntor deri më 1 dhjetor të vitit 1943, është mbajtur Konferenca e Teheranit në të cilën kanë marrë pjesë Çerçilli, Ruzveltiti dhe Stalini. Në Konferencën e Teheranit, është debatuar për aksionet e mëtutjeshme të përbashkëta kundër Gjermanisë dhe Japonisë, veçanërisht rreth hapjes së Frontit të ri Perëndimor. Përveç këtyre çështjeve, pjesëmarrësit në konferencë e kanë shqyrtuar edhe çështjen e qëndrimit ndaj të mundurve, për sigurinë pas luftës dhe bashkëpunimin si edhe për ndarjen e fushave të ndikimit.



Treshi i Madh në Konferencën e Teheranit

KONFERENCA E KRIMESË

*Treshi i madh Çerçill, Ruzvellt, Stalin
në Konferencën e Krimesë*

Pas fitoreve të mëdha të aleatëve në betejat kundër Gjermanisë, prej 4 deri në 12 shkurt në Jaltë në Gadishullin e Krimesë u mbajt Takimi i dytë i shefave të tre fuqive të mëdha SHBA, Britania e Madhe dhe BRSS - Ruzvellti, Çerçilli dhe Stalini.

Pjesëmarrësit në konferencë janë marrë vesh për kapitullim të pakushtëzuar, okupim dhe udhëheqje me Gjermaninë. Përveç kësaj, është parashikuar edhe ndarja e Gjermanisë në katër zona okupimi: zona britanike, sovjetike, amerikane dhe franceze. Është parashikuar të shkatërrohen forcat e armatosura gjermane, operacionet

ta përfshijnë tërë pasurinë nacionale gjermane dhe t'u gjykohej kriminelëve ushtarakë.

Në konferencën në Jaltë në fakt Evropa është ndarë në sfera të ndikimit ndërmjet fuqive të mëdha SHBA, Britania e Madhe dhe BRSS.

Për sigurimin e paqes botërore, janë përpiluar plane për themelimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Çfarë rëndësie ka Konferenca e Krimesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve ndërkombëtare?

KONFERENCA E POTSDAMIT

Pas kapitullimit të Gjermanisë, me iniciativë të kryeministrit britanik Vinston Çerçill, është caktuar konferenca në Potsdam, afër Berlinit, e cila është mbajtur në korrik të vitit 1945. Përveç Çerçillit, në konferencë kanë marrë pjesë edhe Hari Truman (në vend të të ndjerit Ruzvellt) dhe presidentit rus Josif V. Stalin. Gjatë konferencës, pas zgjedhjeve në Britaninë e Madhe, Çerçilli është zëvendësuar me kryeministrin e ri britanik Klemant Atli. Në konferencën në Potsdam, fuqitë e mëdha kanë vendosur të bëhet çarmatimi i tërësishëm dhe demilitarizimi i Gjermanisë dhe të ndalohet ekzistimi i Partisë nacionalsocialiste.



Procesi i Ninbergut

TEMA 5

Përveç kësaj, janë miratuar zgjidhje për ndarjen e Gjermanisë në zona okupimi, si edhe formimi i gjykatës ndërkombëtare për gjykimin e kriminelëve të luftës në Nurnberg.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, bota ka hyrë në prova të reja politike dhe rivalitete.

Cilat zgjidhje janë miratuar në Konferencën në Potsdam?

KONFERENCA NË PARIS

Konferenca paqësore në Paris është mbajtur prej korriku deri në tetor të vitit 1946. Në të kanë qenë të pranishëm përfaqësues nga 21 vende të cilat kanë marrë pjesë në luftën kundër Gjermanisë dhe Italisë. Në Konferencën paqësore në Paris ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet fuqive të mëdha për çështje të caktuara. Më 10 shkurt të vitit 1947, është nënshkruar teksti final i marrëveshjeve paqësore i njohur si Marrëveshja paqësore e Parisit.

Me zgjidhjet në konferencën, Italisë i janë marrë të gjitha kolonitë dhe rajonet që i ka okupuar në bregdetin lindor të Detit Adriatik. Pas luftës, Shqipëria përsëri është bërë shtet i pavarur. Finlanda ka mbetur në kufijtë e vitit 1940. Rumunia i ka kthyer BRSS-së Besarabinë dhe Bukovinën Veriore. Bullgaria është detyruar t'i kthejë territoret e marra prej Rumanisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Austria është ndarë në katër zona okupimi. Gjermania ia ka kthyer Francës Alzasin dhe Lorenin. Shtetet Belgjike, Holandë, Luksemburg, Danimarkë dhe Norvegji, përsëri janë bërë të pavarura. Polonisë i janë kthyer territoret - pjesë e Prusisë Lindore dhe në lindje të lumenjve Odra - Nisa. Gjermania është ndarë në katër zona okupimi: amerikane, sovjetike, britanike dhe franceze. Me Gjermaninë nuk është nënshkruar marrëveshja paqësore. Marrëdhëniet diplomatike të SHBA me Gjermaninë, janë vendosur tek në vitin 1951, ndërsa me BRSS në vitin 1955.

Në vitin 1951, është organizuar Konferenca paqësore me Japoninë, pa pjesëmarrjen e BRSS. Me zgjidhjet në këtë konferencë, Japonisë i është pranuar pavarësia dhe sovraniteti, ndërsa ajo është obliguar të bëjë politikë të jashtme paqësore.

Cila është rëndësia historike e Konferencës paqësore të Parisit?



Konferenca në Potsdam

BALLKANI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

JUGOSLLAVIA NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE



Hitleri, pas sulmit e viziton Jugosllavinë

vendim për sulm mbi Jugosllavinë dhe Greqinë. Më 6 prill të vitit 1941, Italia dhe Gjermania e kanë sulmuar Jugosllavinë. Mbreti dhe qeveria pas disa ditëve kanë ikur jashtë vendit, ndërsa më 17 prill armata jugosllave ka kapitulluar. Pas kapitullimit, Jugosllavia është

Në periudhën e sukseseve të mëdha të Gjermanisë gjatë vitit 1940, qeveria jugosllave e Cvetković - Mačekut, për t'i ruajtur interesat e veta dhe mbijetesën e vendit, më 25 mars të vitit 1941, në Vjenë ka nënshkruar marrëveshje për aderim në Paktin Trepalësh. Marrëveshja ka shkaktuar demonstrata masovike në vend dhe grusht shteti. Është formuar qeveri e re në krye me gjeneralin Dushan Simović. Duke konsideruar se grushti i shtetit ka karakter antigjerman, Hitleri ka marrë

përçarë dhe ndarë ndërmjet Italisë dhe Gjermanisë, Hungarisë dhe Bullgarisë. Partia komuniste e Jugosllavisë dhe fuqitë tjera antifashiste, i janë kundërvënë okupimit dhe i kanë udhëhequr popujt e Jugosllavisë në luftë kundër okupimit fashist. Pas atakut gjerman mbi BRSS, në Jugosllavi ka filluar rezistenca antifashiste nën udhëheqjen e PKJ-së, në krye me Josip Broz Tito.

Që në vitin 1941, janë formuar territoret e reja të lira. Beteja të mëdha janë zhvilluar në vitin 1943 në lumenjtë Neretvë dhe Sutjeskë. Më 25 maj të vitit 1944, forcat gjermane e kanë ndërmarrë operacionin Kërcimi i kalit, i njohur si Desanti mbi Dërvar, me qëllim që të kapet udhëheqësi i lëvizjes antifashiste, Tito. Pas luftërave të përfunduara me sukses në Frontin e Sremit, ku ka marrë pjesë edhe korpusi XV maqedonas, fuqitë fashiste



Josip Broz Tito

gjermane në Jugosllavi kanë qenë të mundura. Më 15 maj të vitit 1945, Jugosllavia është çliruar nga okupatori fashist.

Gjatë sukseseve të mëdha të Ushtrisë çlirimtare kombëtare të Jugosllavisë, më 29 dhe 30 nëntor të vitit 1943, në qytezën Jajce, është mbajtur Kuvendi i Dytë i KAÇKJ-së. Në kuvend është vendosur që Jugosllavia e pasluftës të rregullohet mbi parimet federative, e konstituuar nga 6 republika. Më 7 mars të vitit 1945, është formuar qeveria e përkohshme e Jugosllavisë Demokratike Federative në krye me Josip Broz Titon, e cila ishte e njohur nga shtetet aleate.

Si është zhvilluar Lufta nacionalçlirimtare në Jugosllavi? Hulumto dhe mëso! Për personalitetin dhe veprën e Josip Broz Titos.

GREQIA NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Italia fashiste, pas okupimit të Shqipërisë, në vitin 1940, e ka sulmuar edhe Greqinë. Pas sukseseve të para të ushtrisë italiane, ushtria greke ka kaluar në kundërofensivë dhe ushtritë italiane kanë qenë të detyruara të tërhiqen në territorin e Shqipërisë.

Që ta zgjidhë problemin ballkanik, më 6 prill të vitit 1941, Gjermania e ka sulmuar Greqinë. Pas disfatës, Greqia është ndarë ndërmjet Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë ndërsa mbreti dhe qeveria kanë shkuar jashtë vendit.

Në vitin 1941, ka filluar rezistenca antifashiste. Rezistencën e ka paraprirë PKG, me iniciativën e së cilës është formuar EAM (Fronti nacionalçlirimtar grek) dhe ELAS (Ushtria nacionalçlirimtare greke). Këto fuqi e kanë përbërë të majtën greke. Më vonë janë formuar EDEC (Liga demokratike dhe nacionale greke) dhe EKKA (Komiteti grek për çlirimin nacional dhe social), që e kanë përfaqësuar të djathtën greke.



Partizanë të ELAS

Gjatë vitit 1942-1943, mosmarrëveshjet ndërmjet ELAS dhe EAM, janë shndërruar në konflikte të armatosura. Edhe përkaj kësaj, rezistenca antifashiste është zhvilluar gjithnjë e më shumë, duke e përfshirë Greqinë kontinentale dhe ishujt. Në territoret të cilat kanë qenë nën kontrollin e EAM dhe ELAS, janë organizuar territore të lira.

Për t'i evituar konfliktet ndërmjet majtistëve dhe djathtistëve, në maj të vitit 1944, në Liban është formuar Qeveria për bashkimin nacional, e përbërë nga përfaqësuesit edhe të majtistëve edhe të djathtistëve. Pas çlirimit të Greqisë, në dhjetor të vitit 1944, njësitë e ELAS janë ndeshur me njësitë e qeverisë greke, të ndihmuar nga Anglia. Në vitin 1945,

ndërmjet PKG - ELAS dhe qeverisë Greke është nënshkruar marrëveshje në Varkizë sipas së cilës, janë çarmatosur njësitë e ELAS, ndërsa pushtetin e kanë marrë partitë civile greke.

Cilat forca të armatosura kanë qenë bartës të rezistencës antifashiste në Greqi? Hulumto dhe mëso! Pse maqedonasit janë kyçur në mënyrë masovike në radhët e PKG, ELM dhe ELAS?

BULLGARIA NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Me dëshirë që t'i realizojë pretendimet e veta territoriale ndaj vendeve fqinje, më 1 mars të vitit 1941, Bullgaria, ka aderuar në Paktin Trepalësh. Pas disfatës së Jugosllavisë dhe Greqisë, Bullgaria ka okupuar një pjesë të territoreve të këtyre shteteve.



*Ushtarë bullgar dhe gjerman në
Drama*

Pas sulmit gjerman në BRSS, PKB e ka thirrur popullin në rezistencë antifashiste, me ç'rast janë formuar aradhet partizane në Razllog dhe në Dupnik. Pas Betejës së Stalingradit, janë formuar aradhet: Çavdar, Anton Ivanov, Hristo Botev, aradhja Rile-Pirine etj. Paralelisht me rezistencën e armatosur, PKB në vitin 1943 ka formuar edhe Komitet nacional të Frontit Atdhetar. Vitin e njëjtë mbreti bullgar Boris III ka vdekur, kurse e ka trashëguar i biri i tij i mitur Simeon II Sakskoburgotski.

Pas ndërhyrjes së Armatës së Kuqe në Bullgari, më 9 shtator të vitit 1944, është bërë grusht shteti dhe është formuar qeveri në krye me liderin e organizatës Zveno Kimon Georgiev. Pas grushtit të shtetit Bullgaria i është bashkëngjitur Koalicionit antifashist. Pas luftës, pushtetin e ka marrë Partia Komuniste Bullgare (PKB) dhe Bullgaria ka rënë nën ndikimin rus.

Si është zhvilluar lëvizja antifashiste në Bullgari?

SHQIPËRIA NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE

Në vitin 1939, forcat fashiste italiane e kanë sulmuar dhe e kanë okupuar Shqipërinë. Pas kapitullimit të Jugosllavisë dhe Greqisë nën okupimin italian ka rënë pjesa më e madhe e Kosovës, si edhe krahina në Malin e Zi dhe pjesë të Maqedonisë, me çka është formuar e a.q. Shqipëria e Madhe. Në territoret e pushtuara, autoritetet shqiptare kanë çuar politikë të denacionalizimit dhe të asimilimit të popullsisë joshqiptare.

Lëvizja antifashiste dhe nacionalçlirimtare në Shqipëri ka filluar në vitin 1941, ndërsa iniciatorët e saj kanë qenë komunistët. Pas sulmit gjerman në BRSS, me ndihmën e Kominternës dhe PKJ-së, është organizuar konferencë me grupet komuniste shqiptare, në të cilën është zgjedhur Komiteti i përkohshëm në krye me Enver Hoxhën.

Në vitin 1942, janë formuar njësi më të vogla partizane - çeta, ndërsa në vitin e ardhshëm njësite më të mëdha dhe batalione. Në vitin 1942 është formuar Fronti për çlirimin kombëtar, kurse paralelisht me të është formuar edhe organizata nacionaliste shqiptare Balli Kombëtar, në krye me Mithat Frashërin, që ka luftuar për mbrojtjen e Shqipërisë së Madhe. Pas kapitullimit të Italisë, forcat nacionaliste gjermane e kanë okupuar Shqipërinë. Nga fundi i vitit 1944, Shqipëria është çliruar ndërsa në shtet është vendosur regjimi komunist dhe Shqipëria ka rënë nën zonën sovjetike të ndikimit.

Cilat kanë qenë rrethanat politike në Shqipëri pas okupimit të Italisë?



Formimi i PKSH (8.IV.1941)

KOHA E KRIZAVE, E NDRYSHIMEVE DHE E ANTAGONIZMAVE

RENDITJA E RE E FUQIVE NË BOTË

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe fitorja mbi fashizmin kanë qenë nxitje e fuqishme e forcave progresive në botë për ta ruajtur paqen e vendosur dhe për t'i çuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Por, së shpejti pas përfundimit të konfrontimeve ushtarake në pah kanë dalë antagonizmat e shumta të interesave ndërmjet fuqive të mëdha, para së gjithash ndërmjet SHBA dhe BRSS, si dy shtete më të fuqishme në botë. Aleatët e deridjeshëm janë kontestuar në lidhje me më shumë çështje, siç është përcaktimi i kufijve, rregullimi i vendeve të caktuara si edhe ndikimi në botë. Veçanërisht kanë ardhur në shprehje dallimet në lidhje me Gjermaninë e mundur dhe ardhmërinë e saj.

Falë sukseseve të mëdha në Luftën e Dytë Botërore, BRSS, edhe pse ekonomikisht e dobësuar, është afirmuar si fuqi e madhe botërore dhe e ka zgjeruar ndikimin e vet në Evropën Lindore. Me ndihmën e Armatës së Kuqe, janë çliruar më shumë vende në Evropën Lindore, siç janë: Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Rumunia, Gjermania Lindore, Bullgaria). Këto shtete më vonë kanë mbetur nën sferën sovjetike të ndikimit dhe nën ndikimin e BRSS është vendosur rregullimi shtetëror socialist.

Vendet evropiane perëndimore dhe SHBA-të nuk kanë qenë të kënaqura me ndryshimet që kanë ndodhur në vendet evropiane lindore, të cilat kanë synuar kah rregullimi socialist dhe komunist. SHBA dhe forcat tjera nuk kanë qenë të kënaqura për shkak të përforcimit ushtarak dhe dominimit në Evropën Lindore. Ato janë përpjekur ta parandalojnë zhvillimin e socializmit për arsye se kanë konsideruar se ai është sistem jodemokratik në të cilin mohohen të drejtat dhe liritë e njeriut. Njëkohësisht, ndërmjet veti janë afruar ekonomikisht. Për këtë qëllim, nga ana e SHBA është përpiluar Plani i Mareshalit, i cili ka pasur për qëllim që ta ndihmojë luftën kundër komunizmit. Përveç kësaj, në SHBA është paraqitur edhe e a.q. Doktrina e Trumanit, sipas të cilës u sigurohej ndihmë vendeve të rrezikuara nga komunizmi. Përkundër vendeve kapitaliste, edhe vendet socialiste të Evropës Lindore janë organizuar kundër kapitalizmit dhe imperializmit.



Evropa e ndarë me vendet e reja socialiste

TEMA 5

Në vitin 1947, partitë komuniste të këtyre vendeve kanë themeluar Byro Informative (Informbyro), me qëllim të ndihmës së ndërsjellë dhe bashkëpunimit.

Kështu, bota ka hyrë në fazë të luftës së ftohtë me kërcënime të ndërsjella dhe bllokada ekonomike. Kjo periudhë ka zgjatur disa dekada, në të cilat ka dominuar politika e fuqisë dhe e presionit, dhe e garës së përhershme në armatosjen më bashkëkohore. Lufta e ftohtë ka filluar në vitin 1946, me fjalimin e Winston Çerçill të mbajtur në Fullton (Misuri, SHBA), kur i ka thirrur vendet perëndimore që së bashku të luftojnë kundër komunizmit dhe të parandalohet përhapja e tij e mëtutjeshme.

Pse është miratuar Plani i Mareshalit?

Me çfarë qëllimi është formuar Byroja Informative?

NDARJA NË BLOQE

Në vitin 1949 është formuar Republika Federative e Gjermanisë (RFGJ) me bashkimin e tri zonave të okupuara perëndimore (amerikane, angleze dhe franceze), ndërsa nga zona sovjetike është formuar Republika Demokratike Gjermane.

Vitin e njëjtë, dymbëdhjetë vende perëndimore evropiane, të paraprirra nga SHBA e kanë formuar Paktin Veriatlantik (NATO). Ai është dashur t'i mbrojë interesat e vendeve nga agresioni i mundshëm i vendeve tjera. Për kryerjen e detyrave është themeluar Këshilli i Paktit Atlantik. Këshilli ka qenë organi më i lartë për çështje ushtarake dhe civile.



Si përgjigje në formimin e NATO-s, vendet socialiste kanë formuar organizata të reja ekonomike dhe ushtarake. Në vitin 1949, ato e kanë formuar Këshillin për ndihmë të ndërsjellë ekonomike (CEB), ndërsa në vitin 1955, tetë vende socialiste (BRSS, Polonia, Çekosllovakia, Gjermania Lindore, Rumunia, Bullgaria, Hungaria dhe Shqipëria), e kanë formuar Paktin e Varshavës. Ai ka qenë i paramenduar si marrëveshje për miqësi, por në fakt ka qenë aleancë ushtarake. Në rast se ndonjë nga vendet do të atakohet, marrëveshja ka parashikuar që asaj t'i jepet çfarëdo ndihme, duke e përfshirë edhe atë ushtarake. Marrëveshja e Varshavës është mbyllur në 20 vite. Mandej është vazhduar për edhe dhjetë. Megjithatë, për shkak të demokratizimit i cili ka filluar në BRSS në periudhën e Mihail Gorbaçov, në vitin 1990 ky bllok ka pushuar së ekzistuari. Më vonë, në vitin 1991 u shpërbë edhe BRSS dhe u shndërrua në Bashkësi të shteteve të pavarura.

Me çfarë qëllimi janë formuar blloqet ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore?

BOTA E TRETË



Naser, Tito dhe Nehru (viti 1956)

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, shumë popuj nga Afrika, Azia dhe Amerika Jugore kanë fituar autonomi dhe pavarësi. Ndërmjet tyre më të njohura janë India, Pakistani, Burma, Indonezia në Kontinentin Aziatik. Luftërat antikoloniale më vonë janë zhvilluar edhe në Afrikë ku pavarësi kanë fituar rreth dyzet shtete, koloni të mëparshme të më shumë vendeve evropiane.

Me fitimin e pavarësisë, kolonitë e mëparshme janë gjetur nën presion të njërit ose të tjetrit bllok. Në përpjekjet për ta ruajtur zhvillimin e tyre të pavarur jashtë blloqeve, në konferencën në Rangun, këto shtete janë

marrë vesh për formimin e të a.q. botës së tretë, përkatësisht Lëvizje e vendeve të painkuadruara. Iniciatorë të lëvizjes së të painkuadruarve kanë qenë Xhavaharlall Nehru, presidenti i Indisë, Josip Broz Tito, lideri i Jugosllavisë dhe Gamall Abdell el Naser, presidenti i Egjiptit. Vendet e Botës së tretë, në vitin 1961 në Beograd e kanë mbajtur konferencën themeluese të a.q. lëvizje të painkuadruarve. Ndërmjet vendimeve më të rëndësishme të marra në konferencë ishte pranimi i parimeve të koegzistencës paqësore aktive.

Në vitin 1964, vendet e painkuadruara dhe të pazhvilluara e kanë formuar Grupin e 77-shteteve, që është angazhuar për zhvillim ekonomik të vendeve të pazhvilluara, për

TEMA 5

zbutjen e dallimeve të mëdha që kanë ekzistuar ndërmjet vendeve të pasura dhe të varfra dhe për faljen e borxheve të huaja për vendet më të varfra.

Cilat kanë qenë parimet themelore të vendeve të painkuadruara?



Konferenca e të painkuadruarve në Beograd (1961)

TË PASUR-TË VARFËR DHE POLITIKA E LËSHIMIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

Me përfundimin e luftës antikoloniale, vendet e porsaçliruara dhe vendet e pazhvilluara ekonomikisht, paraqiten si faktor i ri ndërkombëtar. Mirëpo, për shkak të varfërisë së këtyre vendeve ato nuk paraqesin faktor ekonomik më të rëndësishëm. Baza e tyre e dobët ekonomike dhe varësia nga vendet e zhvilluara paraqet interes për vendet e pasura dhe ekonomikisht të zhvilluara.

Pas kulminimit të luftës së ftohtë në botë, gradualisht mbisundonte njohuria se kjo reflektohet në mënyrë të dëmshme në marrëdhëniet ndërkombëtare. Lufta e ftohtë dhe ndarja në blloqe gradualisht i lironin vend relaksimit të tensionit. Kah fundi i të gjashtëdhjetave dhe fillimit të shtatëdhjetave të shekullit XX, raportet ndërmjet blloqeve udhëheqëse u përmirësuan. Në këtë periudhë me sukses kanë përfunduar marrëveshjet për ndalesën për përhapjen e armëve bërthamore (SLLT).

Tensionimi ka lëshuar edhe në lidhje me Republikën Federale Gjermane. Ajo gradualisht hapej kah vendet evropiane lindore dhe ka filluar bashkëpunim dhe marrëdhënie ekonomike me Republikën Demokratike të Gjermanisë fqinje.

Mendo! Pse lufta e ftohtë dhe ndarja në blloqe gradualisht i lironin vend relaksimit të tensionit?



Pasoja nga kolonializmi – uria në vendet e porsaçliruara



Nënshkrimi i Marrëveshjes së Varshavës

TENDENCAT E REJA NË BOTË PËR PAQE DHE BASHKËPUNIM

ORGANIZATA E KOMBEVE TË BASHKUARA



Ndërtesa e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork

Në zhvillimin e mëtutjeshëm për zhvillimin e raporteve ndërmjet shteteve në botë, rol të madh ka luajtur themelimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Themelet e kësaj organizate janë vendosur edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, me Kartën Atlantike, në të cilën janë prezantuar parimet për rregullimin e botës të pasluftës. Kjo Kartë është hyrje në një Deklaratë më të gjerë të popujve të bashkuar të cilën e kanë pranuar dhe e kanë nënshkruar në vitin 1942 26 vende. Në konferencën në San Francisko më 26 qershor të vitit 1945, është miratuar Karta e OKB-së, në prani të delegatëve nga 50 vende. Karta ka hyrë në fuqi më 24 tetor

të vitit 1945 dhe për këtë shkak ajo ditë kremtohet në tërë botën si Dita e OKB-së.

OKB-ja është organizatë botërore e cila ka për qëllim ta ruajë paqen në botë dhe të zhvillojë marrëdhënie miqësore ndërmjet popujve të tërë botës. Të gjitha anëtarët e OKB-së janë të obliguara që ta respektojnë Kartën, të luftojnë për qëllimet e saj, duke e respektuar edhe pavarësinë edhe barazinë e të gjitha shteteve pa përzierje në punët e brendshme.

Organet kryesore të OKB-së janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Sigurimit, Këshilli Ekonomik dhe Social, Këshilli i Kujdestarisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe Sekretariati i OKB-së.

Organi më i lartë i OKB-së është Asambleja e Përgjithshme të cilën e përbëjnë të gjitha anëtarët dhe secila prej tyre ka të drejtë vote. Këshilli i Sigurimit është një nga organet më të rëndësishme të OKB-së. Përbëhet prej 15 vendeve anëtare. Anëtare të përhershme të Këshillit janë: SHBA, BRSS (prej vitit 1991 Rusia), Kina, Britania e Madhe dhe Franca. Këto anëtare kanë të drejtë në veto, përkatësisht pa pëlqimin e tyre Këshilli nuk mundet të marrë vendim nëse është në kundërshtim me vullnetin e anëtares e cila ka parashtruar të drejtë në veto. Dhjetë anëtare tjera janë të përkohshme dhe ato ndërrohen çdo vit të dytë. OKB-ja ka edhe organizata të veta speciale: UNESCO - Organizata për shkencë dhe kulturë, UNICEF - Organizata për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, Organizata ndërkombëtare shëndetësore.

UNKTAD - Konferenca për tregti dhe zhvillim, Organizata për ushqim dhe bujqësi, Fondi Ndërkombëtar Monetar dhe tjera. Selia e OKB-së gjendet në Nju Jork (SHBA).

Ndërmjet akteve të tjera të miratuara nga OKB-ja, rëndësi të veçantë ka Deklarata për të drejtat universale të njeriut të cilën e kanë nënshkruar të gjitha anëtarët e Organizatës.

Me çfarë qëllimi është formuar OKB-ja?

KËSHILLI EVROPIAN

Luftërat e shpeshta dhe e kaluara e vështirë historike kanë kontribuar që në Evropë të paraqitet dhe të pranohet ideja për Evropën e Bashkuar. Ithtarët e kësaj ideje kanë qenë persona të dalluar në jetën politike pas Luftës së Dytë Botërore, Robert Shuman, Konrad Adenauer, Sharll de Gol etj.

Të nxitur nga kjo ide, në vitin 1949, dhjetë vende të Evropës perëndimore në Strasburg e kanë formuar Këshillin Evropian. Qëllimi i themelimit të Këshillit Evropian ka qenë të sigurohet bashkëpunim më i afërm në planin politik, ekonomik, social dhe kulturor ndërmjet vendeve evropiane.

Organet themelore të Këshillit Evropian janë: Këshilli i Ministrave, Asambleja Këshillëdhënëse dhe Sekretariati. Vendimet e Këshillit Evropian dhe të organeve të tij nuk i obligojnë vendet në rast se ato nuk i pranojnë organet shtetërore të atyre vendeve.

Në punën e deritanishme, Këshilli ka miratuar më shumë Konventa ndërkombëtare prej të cilave më të rëndësishme janë Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe Konventa për zgjidhjen e qetë të kontesteve.

Republika e Maqedonisë është pranuar në anëtarësi të rregullt në Këshillin Evropian në vitin 1995.

Cilat janë qëllimet themelore të Këshillit Evropian?



Sharl de Gol

BASHKËSIA EKONOMIKE EVROPIANE

*Ndërtesa e Bashkësisë
Ekonomike Evropiane*

Në vitin 1957 në Romë është formuar Bashkësia Ekonomike Evropiane (BEE), me seli në Bruksel. Qëllimi i kësaj organizate ka qenë integrimi ekonomik i vendeve anëtare, heqja e doganave dhe lëvizja e mallrave dhe kapitalit. Organet e BEE janë: Këshilli i ministrave, Asambleja dhe Gjykata e Drejtësisë. Selia e saj dhe kryesia ndërrohen çdo gjashtë muaj nga vendet e caktuara - anëtare të bashkësisë.

Në vitin 1991, liderët e qeverive të 12 vendeve anëtare të BEE, në Mاستriht e kanë nënshkruar marrëveshjen për formimin e Bashkimit Evropian (BE). Me këtë janë krijuar kushtet për përforcimin dhe për thellimin e lidhjeve të ndërsjella dhe në planin e ekonomisë, kulturës, drejtësisë, politikës etj.

Bashkimi evropian angazhohet për politikë të jashtme të përbashkët evropiane, për formimin e forcave të përbashkëta evropiane, monedhë të përbashkët (euro), shtetësi të përbashkët evropiane dhe kushtetutë evropiane. Bashkimi Evropian ka flamurin e vet, himnin, ndërsa Dita e fitores mbi fashizmin u shpall për Ditë të Evropës (9 maj).

Hulumto dhe mëso! Cilat vende të mëparshme socialiste janë anëtare të Bashkimit Evropian?



Flamuri i Bashkimit Evropian

KONFERENCA PËR SIGURINË DHE BASHKËPUNIMIN EVROPIAN



Kremtimi i bashkimit të Gjermanisë (1990)

Politika e detantit ka kulminuar në vitin 1975, kur me pjesëmarrjen e 35 shteteve nga Evropa, në Helsinki, është mbajtur Konferenca për sigurinë dhe bashkëpunimin evropian, (KEBS). Me nënshkrimin e Deklaratës për parimet e marrëdhënieve të ndërsjella për përforcimin e besimit, sigurisë dhe çarmatimit, është dhënë kontribut i madh për relaksim të tensionit në Evropë dhe në botë, si edhe përforcimi i sigurisë në Mesdhe. Vend të rëndësishëm në kuvendet e deritanishme i është dhënë mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut në vende të caktuara.

Në Konferencën në Budapest në vitin 1994 është ndërruar emri në Organizatë për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE). Atëherë është miratuar dokumenti me titullin *Në vigjilje të partneritetit të vërtetë në erën e re*, me të cilin është dashur të gjendet modeli për sigurinë në Evropë. Numri i anëtarëve të OSBE-së është 52, ndërmjet tyre është edhe Republika e Maqedonisë.

Në vitet e tetëdhjeta të shekullit XX, BRSS tregon shenja të dobësimit si në planin e brendshëm ashtu edhe në planin e jashtëm. Udhëheqësia e re sovjetike në krye me Mihail Gorbaçov, me qëllim që të gjejë dalje nga kriza, në vitin 1985 ka paralajmëruar reforma të a.q. Perestrojka, me të cilën ka filluar procesi i demokratizimit të vendeve në Evropën Lindore. Në vitin 1989, vendet evropiane dhe BRSS arrijnë marrëveshje rreth rrënimit të Murit të Berlinit dhe bashkimit të dy shteteve gjermane në vitin 1990. Ndërmjet presidentit amerikan Xhorxh Bush dhe presidentit sovjetik Mihail Gorbaçov, janë gjetur zgjidhje për zvogëlimin e tensionit ndërkombëtar. Në zvogëlimin e tensionit dhe të ndarjes në blloqe, rol të veçantë ka luajtur edhe shpërbërja e Paktit të Varshavës.



Presidenti amerikan Ronalld Regan dhe lideri sovjetik Mihaiill Gorbaçov

KRIZA E SOCIALIZMIT DHE RËNIA E KOMUNIZMIT

KARAKTERISTIKAT E SISTEMEVE SOCIALISTE



J.B.Tito dhe N.S.Hrushçov (Beograd 1955)

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, bota hapëroi në fazë të re të marrëdhënieve shoqërore-politike dhe ekonomike. Numri më i madh i vendeve në botë e kanë mbajtur sistemin kapitalist, por një numër i caktuar i shteteve e kanë pranuar rregullimin socialist. Rruga e ndërtimit të marrëdhënieve socialiste ka qenë e ndryshme. Kështu, në Jugosllavi, në Libi, në Shqipëri dhe Kinë, njëkohësisht me luftërat nacionalçlirimtare kundër okupatorëve, janë bërë edhe revolucione socialiste nëpërmjet të cilave këto vende janë bërë socialiste. Falë rolit të madh të BRSS, që e ka luajtur në fitoren mbi fashizmin, si edhe ndihma e Armatës së Kuqe në Bullgari, në Rumuni, në Poloni, Çekosllovakia, Hungari dhe Gjermani Lindore, komunistët e kanë ndërmarrë pushtetin dhe kanë filluar të ndërtojnë shoqëri socialiste.

Si shtet i parë socialist në botë, BRSS ka pasur ndikim të madh në shtetet socialiste si në planin e jashtëm-politik ashtu edhe në zhvillimin e brendshëm dhe politikën. Në të gjitha vendet socialiste, pushtetin e kanë ndërmarrë partitë komuniste të cilat kanë vendosur diktaturë të proletariatit - sistem njëpartiak. Me reformat politike dhe ekonomike në vendet socialiste është hequr pronësia private dhe ekonomia e tregut, kurse janë vendosur pronësia shtetërore dhe ekonomia e planifikuar. Në vend të monarkive, të cilat janë suprimuar, në të gjitha këto shtete është vendosur rregullimi republikan. Nën ndikimin e modelit sovjetik të socializmit, pas vitit 1945, në vendet socialiste është zbatuar reforma agrare, nacionalizimi i mjeteve të prodhimit, kolektivizimi dhe industrializimi dhe vendosja e ekonomisë së planit.

Cilat janë karakteristikat themelore të sistemeve socialiste?

MARRËDHËNIET NDËRMJET SHTETEVE SOCIALISTE

Në shtator të vitit 1947, në Varshavë është mbajtur këshillimi i partive komuniste evropiane, ku është formuar Byroja informative (Informbyroja). Qëllimi i themelimit të



Fidel Kastro dhe Nikita Hrushçov

informbyrosë ka qenë këmbimi i përvojave ndërkombëtare si edhe kontributi për bashkëpunim më të mirë dhe të barabartë ndërmjet vendeve që janë përcaktuar për ndërtimin e socializmit. Mirëpo, Stalini në Informbyronë ka parë mjet për përforcimin e tërësishëm të kontrollit sovjetik mbi punën e të gjitha partive dhe vendeve komuniste dhe punëtore. Megjithatë, praktikën e atillë nuk e ka pranuar Jugosllavia, udhëheqësia partiake e së cilës ka kërkuar marrëdhënie të barabarta, duke parë në barazinë garanci për zhvillimin e mëtutjeshëm të socializmit.

Për shkak të qëndrimeve të këtilla, Stalini nëpërmjet Informbyrosë ka filluar fushatë të hapur dhe të ashpër armiqësore kundër PK të Jugosllavisë, me ç'rast në vitin 1948 është shpallur Rezoluta e Informbyrosë me të cilën më së ashpri është gjykuar politika e Jugosllavisë.

Pas ndërprerjes së Marrëdhënieve me BRSS dhe me të gjitha vendet socialiste, në Jugosllavi është vendosur vetëqeverisja socialiste, si një model i ri në zhvillimin e socializmit. Pas vdekjes së Stalinit, përkatësisht nënshkrimit të Deklaratës së Beogradit (1955) dhe Deklaratës së Moskës (1956), fillon normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Jugosllavisë, Bashkimit Sovjetik dhe vendeve evropiane lindore. Reaksionet në procesin e destalinizimit, si edhe problemet e pazgjidhura të brendshme dhe kërkimi i rrugëve vetjake për zhvillim, kanë sjellë deri në çrregullime të caktuara të brendshme në të gjitha vendet e Evropës Lindore, të cilat definitivisht e kanë hequr kontrollin sovjetik dhe kanë vendosur demokratizim në rregullimin e brendshëm.

Si kanë qenë marrëdhëniet ndërmjet vendeve socialiste pas Luftës së Dytë Botërore?

KRIZA E SISTEMIT SOCIALIST DHE RËNIA E TIJ*Leh Valensa*

Proceset e zhvilluara për demokratizim të sistemeve politike, si dhe vështirësitë ekonomike, kah fundi i shekullit XX kanë sjellë deri në krizë të socializmit e cila do të shkaktojë ndryshime serioze politike në botë. Procesi i demokratizimit fillon në Bashkimin Sovjetik ndërsa në vitin 1990, vendoset edhe sistemi shumëpartiak.

Procesi i demokratizimit i ka përfshirë edhe vendet tjera socialiste, si Polonia, Gjermania Lindore, Bullgaria, Çekosllovakia, Shqipëria dhe Jugosllavia. Opozita politike liberale në Poloni ka qenë e bashkuar rreth organizimit sindikal Solidarnost në krye me Leh Valensa. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 1989, opozita ka fituar, me ç'rast është formuar qeveria e parë jokomuniste në krye me Tadeush Mazovjecki.

Në nëntor 1989, Todor Zhivkov është mënjeluar nga pushteti në Bullgari ndërsa në dhjetor vitin e njëjtë në Rumuni, Nikollae Çausheku, për ta mbrojtur sistemin diktatorial, ka shkaktuar gjakderdhje në rrugët e Bukureshtit dhe Temishvarit, me ç'rast është hequr nga pushteti.

Gjatë nëntorit të vitit 1989, pas vetëm disa ditëve pa gjakderdhje, ka fituar revolucioni i kadifenjtë, me ç'rast për president të Republikës Çeke është zgjedhur shkrimtari Vacllav Havell.

Në tetor të vitit 1989, për shkak të demonstratave masovike kundër regjimit komunist, presidenti Erik Honeker dhe anëtarët e Politbyrosë së PK, doemos është dashur të japin dorëheqje. Muri i Berlinit, simboli i Gjermanisë së ndarë, është rrënuar. Në tetor të vitit 1990, me marrëveshje paraprake të fuqive të mëdha, është bërë bashkimi i Republikës Demokratike të Gjermanisë me Gjermaninë Federale.

Pas vdekjes së Enver Hoxhës, në krye të Shqipërisë vjen Ramiz Alija, i cili është përpjekur ta ruajë sistemin e njëjtë të rregullimit. Komunizmi në Shqipëri shpërbëhet në vitin 1992, kur janë mbajtur zgjedhjet shumëpartiake në të cilat komunistët e kanë humbur pushtetin.

TEMA 5

Me procesin e demokratizimit janë shpërbërë edhe disa shtete federale socialiste. BRSS është shpërbërë në më shumë shtete të pavarura me ç'rast më 31 dhjetor 1991 ka pushuar të ekzistojë, me ç'rast është formuar Bashkësia e shteteve të pavarura. Çekosllovakia është shpërbërë qetë, dhe janë formuar dy shtete të pavarura: Republika e Çekisë dhe Republika e Sllovakisë. Kriza e cila ka filluar në Jugosllavi pas vdekjes së Josip Broz Tito, ka kulminuar me konflikt të përgjakshëm dhe shpërbërjen e Federatës jugosllave në hapësirën e së cilës janë formuar disa shtete të pavarura.

Me kalimin prej sistemit socialist në atë kapitalist, kanë ndodhur ndryshime të thella në jetën politike në vendet evropiane lindore. Në vend të sistemit njëpartiak, në këto shtete janë formuar më shumë parti dhe janë zbatuar zgjedhje demokratike shumëpartiake. Në zgjedhjet parlamentare në këto shtete, janë rrëzuar sistemet komuniste dhe është vendosur demokracia shumëpartiake. Me këtë fillon periudha e tranzicionit, në të cilën është vendosur ekonomia e tregut, është bërë privatizimi i kapitalit shtetëror dhe është bërë denacionalizimi.

*Pse ka ardhur deri në krizë të sistemit socialist dhe deri në shpërbërjen e tij?
Bëni projekt: Shpërbërja e socializmit në vendet e Evropës Lindore.*



Rumune me flamur prej të cilit është prerë simboli komunist



Ushtarët sovjetikë para demonstruesve (gusht 1991)

SHKENCA DHE KULTURA PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

ZHVILLIMI EKONOMIK

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, bota përjeton zhvillim të shpejtë ekonomik. Por përsëri, ai zhvillim nuk ka qenë i barabartë. Vendet e pazhvilluara kanë realizuar të hyra të ulëta nacionale ndërsa përçarja ndërmjet tyre dhe të pasurve vazhdimisht është thelluar. Për tejkalimin e gjendjeve të këtylla, në kuadër të OKB-së është organizuar konferencë botërore për tregti dhe zhvillim (UNKTAD). Iniciativë për mbajtjen e saj kanë dhënë vendet e pazhvilluara dhe të painkuadruara. Detyra e saj ka qenë ta përparojë tregtinë ndërkombëtare, e veçanërisht ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe të pazhvilluara. UNKTAD-i ka mbajtur seanca në të cilat është shqyrtuar bashkëpunimi ekonomik me vendet e pazhvilluara. Kjo ka dhënë rezultate të caktuara për shkak të privilegjeve (proteksionizmit), që e kanë përfaqësuar shtetet e pazhvilluara, ato nuk kanë dhënë çdoherë rezultate.

Me qëllim që të avancohen marrëdhëniet tregtare, në vitin 1948 është lidhur marrëveshja për doganat dhe tregtinë në kuadër të OKB-së (GAAT). Janë themeluar edhe organizata tjera tregtare, financiare dhe të tjera dhe shoqata të cilat kanë pasur qëllim që ta përshejtojnë zhvillimin ekonomik. Gjithë kjo ka kontribuar për zhvillim më të ngadalshëm të ekonomisë botërore, e cila ka arritur rritjen më të madhe deri atëherë.

Çfarë zhvillimi ekonomik vërehet pas Luftës së Dytë Botërore?

ASTRONAUTIKA DHE KOMUNIKIMET MASOVIKE



Jurij Gagarin

Pas Luftës së Dytë Botërore, fuqitë e mëdha BRSS dhe SHBA, kanë investuar mjete të mëdha në hulumtimin dhe pushtimin e hapësirës qiellore. Pas lansimit të satelitit artificial sovjetik Sputnik dhe atij amerikan Eksplorier, në vitin 1961, në kozmos fluturoi njeriu i parë, kozmonauti sovjetik Jurij Gagarin, i cili për 108 minuta i ka shkuar rrotull tokës me anijen kozmike Vostok. Në vitin 1963, në kozmos ka fluturuar edhe gruaja e parë nga Bashkimi Sovjetik, Valentina Tereshkova. Në vitin 1969, kozmonautët amerikanë Nil Armstrong dhe Edvin Olldrin, me anijen kozmike Apollo 11 kanë zbritur në hënë.

TEMA 5


Në botë u zhvilluan shumë mjetet për komunikim masovik. Me ndihmën e tyre njëkohësisht pranohen dhe dërgohen informata të shumta në tërë botën. Veçanërisht përparim i shpejtë është realizuar në zhvillimin e televizionit. Ai, prej të rëndomtut u zhvillua në televizion satelitor me sigurimin e pranimit nga fluturaket satelitore. U paraqit edhe televizioni kabllor i cili është i dedikuar për numër të caktuar të konsumatorëve.

Përparim të rëndësishëm në vitet e kaluar është arritur në përkryerjen e telefonit, telegrafit, telefaksit, internetit dhe tjetër.

Sot, pothuajse në të gjitha fushat e jetës shoqërore ndërhyri përpunimi automatik i të dhënave. Vend të posaçëm në zhvillimin bashkëkohor merr teknologjia kalkuluese (kompjuterike). Me shfrytëzimin



Valentina Tereshkova



Nil Armstrong

e kompjuterëve personal, u automatizua prodhimtaria dhe kontrolli në shumë sektorë të prodhimit dhe veprimtarisë së njerëzve.

Hulumto dhe mëso! Aterrimi i Apollo 11 në Hënë në vitin 1969.

TEKNOLOGJITË E REJA

Prej viteve të pesëdhjeta të shekullit XX e këndej, në botë paraqiten teknologji të reja në prodhimtarinë. Përparimi i teknologjisë është shprehur në paraqitjen e materialeve të reja dhe lëndëve të para të reja. Për zhvillimin më të shpejtë të teknologjisë, në Evropë formohet agjencia për programe të përbashkëta kërkimore dhe për bashkëpunim evropian në teknologjitë e reja i quajtur EUREKA. Atë e formuan 12 vende të zhvilluara të Evropës perëndimore, a me qëllim që të vendoset baraspeshë me SHBA-të dhe Japoninë e zhvilluar në mënyrë teknologjike.

Çfarë paraqet EUREKA?

PËRPARIMI NË KULTURËN MATERIALE DHE KULTURORE

Pas Luftës së Dytë Botërore bota përjeton zhvillim të shpejtë të kulturës materiale dhe kulturore.

Përparim i dukshëm është realizuar në fushën e arsimit. Kështu, përveç universiteteve ekzistuese si institucione të arsimit sipëror, bota është pasuruar edhe me të reja. Ato arritën rezultate të mëdha në hulumtimet shkencore në të gjitha fushat dhe në formimin e kuadrit profesional.

Për përparimin e kulturës në vitin 1945 është themeluar organizata e arsimit, shkencës dhe kulturës pranë OKB-së (UNESKO). Nëpërmjet kësaj

Organizate jepet kontribut i paçmueshëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në regjistrin e të mirave kulturore-historike prej Maqedonie është futur qyteti i Ohrit dhe Liqeni i Ohrit, për të cilin kujdeset edhe UNESKO-ja.

Zhvillim të dukshëm në botë ka shënuar krijimtaria artistike. Në fushën e artit figurativ krijojnë numër i madh i piktorëve të dalluar, siç janë Pabllo Pikaso, Modiljani, Sallvador Dali etj.

Në prozë dhe poezi, vend të rëndësishëm marrin emrat e Ernest Hemingvejt, Pabllo Neruda, Mihail Solzhencin, Albert Kami, Zhan Pol Sartr etj.



Pabllo Pikaso

TEMA 5

Në fushën e operës janë paraqitur më shumë emra opere të cilët janë popullarizuar në botë.

Në vitet e pesëdhjeta të shekullit XX në SHBA është paraqitur edhe rokënroli si një drejtim i ri në krijimtarinë muzikore.

Nëpërmjet krijimtarisë të më shumë inxhinierëve të shquar dhe regjisorëve dhe yjeve të famshëm të pëlhurës filmike, zhvillim të fuqishëm ka arritur edhe krijimtaria filmike.

Jeta bashkëkohore e njeriut nuk ka mundur të paramendohet pa sportin, si atë profesional ashtu edhe atë amator. Zakonisht, rezultatet më të mira sportive arrihen në Lojërat olimpike të cilat mbahen çdo katër vite.

*Hulumto dhe mëso!
Krijimtaria muzikore e rok
grupit legjendar Bitëlls.*



Bitëlls



Merlin Monro



Rrugica e të famshmëve-Holivud

BALLKANI PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

GREQIA PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE



Skenë nga Lufta civile në Greqi

Pas fitores mbi fashizmin, si edhe me nënshkrimin e marrëveshjes në Varkizë, situata në Greqi jo vetëm që nuk është stabilizuar por edhe më shumë është ndërlikuar. Konfliktet ndërmjet majtistes dhe djathtistes së përkrahur nga Britania e Madhe, kanë kulminuar me Luftë civile në vitin 1946-1949.

Në vitin 1946 në Greqi është zbatuar referendum në të cilin shumica e popullsisë janë deklaruar për kthimin e monarkisë. Në tetor vitin e njëjtë, PKG e ka formuar Armatën Demokratike të Greqisë (ADG) nën komandën e gjeneralit Markos, e cila

i ka filluar operacionet ushtarake kundër fuqive qeveritare. Në këtë luftë populli maqedonas ka marrë pjesë në mënyrë masovike në përbërjen e ADG dhe ka qenë bartësi kryesor në atë luftë. Prej gjithsej 35.000 ushtarëve të Armatës Demokratike të Greqisë, 15.000 kanë qenë maqedonas. Beteja të rënda dhe të përgjakshme janë zhvilluar në malet Viço dhe Gramos. Pas disfatës së ADG në vitin 1949, në pushtet në Greqi kanë ardhur fuqitë e djathtistes së skajshme të cilat kanë filluar terror dhe persekutim të popullsisë. Në përlëshjet kanë vdekur 51.000 pjesëtarë të ADG, prej të cilëve 21.000 kanë qenë maqedonas. Për shkak të politikës represive të qeverisë greke, rreth 60.000 maqedonas dhe grekë kanë qenë të detyruar të emigrojnë në vendet e Evropës lindore: BRSS, Çekosllovakia, Rumuni, Hungari dhe Bulgari.

Pas luftës civile në Greqi, në jetën politike në Greqi kanë dominuar qeveri të përbëra nga partitë politike të orientuara djathtë. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 1963, ka fituar unioni i qendrës në krye me Georgios Papandreu. Konflikti ndërmjet qendrës dhe djathtistes ka kulminuar në vitin 1967, kur është bërë grusht shteti dhe pushtetin e ka marrë ushtria. Diktatura ushtarake (hunta), ka shkaktuar krizë të madhe ekonomike në shtet.



Refugjatë nga pjesa e Maqedonisë së Egjeut në Krakov, Poloni, 1949

Nën presion të popullsisë së pakënaqur, në vitin 1974 hunta ka qenë e detyruar të tërhiqet. Në zgjedhjet parlamentare në vitin e njëjtë, ka fituar partia e Lëvizjes Socialiste Gjithëgreke (PASOK), në krye me Andreas Papandreu. Me zgjedhjen e parlamentit të ri, Greqia është bërë republikë parlamentare.

Qeveria e re ka filluar të zbatojë politikë të *pajtimit nacional*, duke lejuar kthim në vend të të gjithë grekëve që pas Luftës Civile e kanë braktisur Greqinë. Kjo politikë nuk i ka përfshirë maqedonasit, ndaj të cilëve ka vazhduar politika diskriminuese.

Në planin e jashtëm-politik, Greqia është e orientuar kah Perëndimi. Është anëtare e NATO-s ndërsa në vitin 1981 është pranuar në anëtarësi të plotfuqishme në Bashkimin Evropian.

Si është situata politike në Greqi pas Luftës së Dytë Botërore?

NDRYSHIMET SHOQËRORE EKONOMIKE DHE POLITIKE NË SHTETET SOCIALISTE NË BALLKAN

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Jugosllavi, në Bullgari, në Rumani dhe në Shqipëri, pushtetin e kanë ndërmarrë partitë komuniste të këtyre vendeve, me ç'rast kanë vendosur sistem socialist. Si pjesë e sferës sovjetike të ndikimit, këto shtete e kanë kopjuar modelin sovjetik të zhvillimit shoqëror-ekonomik. Përveç industrializimit dhe elektrifikimit, në këto vende është vendosur edhe reforma agrare përkatësisht, toka u është ndarë fshatarëve të varfër. Pas reformës së bërë agrare, në këto vende ka filluar procesi i kolektivizimit të detyrueshëm përkatësisht, formimi i kooperativave punëtore fshatare. Mjetet për prodhimtarinë janë nacionalizuar ndërsa theksi i është vënë industrisë së rëndë.

Pas publikimit të Rezolutës së Informbyrosë (1948), janë çrregulluar marrëdhëniet miqësore ndërmjet shteteve socialiste ballkanike. Qeveria bullgare dhe shqiptare, ithtarë të BRSS-së, përveç atakëve ideologjikë mbi Jugosllavinë, i kanë shkëputur të gjitha marrëveshjet e lidhura paraprakisht për miqësi dhe për bashkëpunim ekonomik.

Jugosllavia, pas vitit 1948, me qëllim që ta ruajë integritetin e vet territorial, në vitin 1953, ka nënshkruar marrëveshje për miqësi dhe bashkëpunim me Greqinë dhe Turqinë (i a.q. Pakt Ballkanik).

Çfarë ndryshimesh shoqëro-ekonomike janë bërë në shtetet socialiste në Ballkan pas Luftës së Dytë Botërore?



Enver Hoxha

KRIZA E SOCIALIZMIT NË VENDET BALLKANIKE

Industrializimi i shpejtë, kolektivizimi i detyrueshëm, akumulimi i lartë për reproduksion të zgjeruar dhe importi i kapitalit të huaj, kanë kontribuar që vendet socialiste në Ballkan të hyjnë në krizë të thellë ekonomike dhe politike. Zhvillimi i ekonomisë ka filluar të stagnojë. Mosinteresimi i fshatarëve për prodhimtari, ka kontribuar që të varfërohet tregu. Mungonin artikujt themelorë ushqimorë. Kjo shkaktonte pakënaqësi të madhe te popullsia.



Todor Zhivkov

Ngjarjet në Poloni (*Solidarnost*) dhe perestrojka në BRSS kanë pasur reflektime të fuqishme edhe në Ballkan. Nën presionin e fortë të fuqive opozitare, në nëntor të vitit 1989, pas sundimit 35 vjeçar, presidenti i Bullgarisë, Todor Zhivkov është hequr nga pushteti, me ç'rast është shpërbërë regjimi totalitar komunist në këtë vend.

Në dhjetor të vitit 1989, pas ngjarjeve të përgjakshme në Bukuresht dhe në Temishvar, presidenti i Rumanisë Nikollae Çaushesku ka qenë i detyruar të largohet nga pushteti.

Në Shqipëri, pas vdekjes së Enver Hoxhës, presidenti i ri Ramiz Alija është përpjekur ta ruajë sistemin ekzistues socialist. Nën presionin e pakënaqësisë popullore, në vitin 1990 është vendosur sistemi shumëpartiak. Në zgjedhjet parlamentare në vitin 1992, shumicë ka marrë Partia Demokratike në krye me Sali Berishën, me ç'rast ka përfunduar sundimi i komunistëve në Shqipëri.

Në kushte të krizës së rëndë ekonomike dhe politike në vitin 1989, në krye të qeverisë së Jugosllavisë vjen Ante Markoviq. Përpjekja e tij të vendosë reforma në shtet ka hasur në rezistencë të fuqishme të disa udhëheqësi politike republikane. Në vitin 1990, në shtet është vendosur sistemi shumëpartiak dhe janë mbajtur zgjedhjet e para shumëpartiake. Konflikti ndërmjet hegjemonizmit serb dhe tendencave për emancipim nacional-politik të popujve jo serbë e ka shkaktuar shpërbërjen e Jugosllavisë së Avnojit. Në pjesë të caktuara të Jugosllavisë erdhi edhe deri në luftë të përgjakshme civile. Prej Federatës së dikurshme Jugosllave u formuan shtetet e veçanta: R. e Sllovenisë, R. e Kroacisë, R. e Maqedonisë, Republika Federative e Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) dhe R. e Bosnjës dhe Hercegovinës (Federata kroate - myslimane dhe Republika Sërpska).

Shtetet e mëparshme socialiste në Ballkan synojnë kah proceset integruese evropiane dhe pranimi në NATO.

Cilat kanë qenë arsytet për krizën e vendeve me rregullim shoqëror socialist dhe si janë manifestuar?

PËRMBAJTJA

TEMA 1

PARAHISTORIA

NJERIU NË PERIU DHËN MË TË HERSHME, KOHA E GURIT DHE E METALIT	5
NEVOJAT SHPIRTËRORE DHE KULTURORE TË NJERËZVE NË BASHKËSITË E PARA	9

TEMA 2

SHEKULLI I VJETËR

CIVILIZIMET MË TË VJETRA NË LINDJEN E AFËRME.....	13
EGJIPTI I VJETËR.....	17
ARRITJET KULTURORE DHE SHKENCORE TË POPUJVE NË LINDJEN E VJETËR.....	21
HELADA E LASHTË.....	25
ROMA E LASHTË	31
KRISHTERIZMI – RELIGJIONI I	36
KJULTURA HELENE DHE ROMAKE	39
BALLKANI NË SHEKULLIN E VJETËR	44

TEMA 3

SHEKULLI I VJETËR

FILLIMET E EVROPËS - SHTETI I FRANKËVE	49
ARABËT DHE ISLAMI	52
MBRETËRIA LINDORE ROMAKE (BIZANTI).....	55
EVROPA LINDORE	59
KRYQËZATAT	62
HUMANIZMI DHE RENESANSA	66
ZBULIMET E MËDHA GJEOGRAFIKE	69
ROLI I KISHËS NË EVROPËN PERËNDIMORE	74
SHTETI OSMANLI	78
BALLKANI NË SHEKULLIN E MESËM.....	81

TEMA 4

SHEKULLI I RI

ZHVILLIMI I PËRSHPEJTUAR EKONOMIK	87
REVOLUCIONI I MADH FRANCEZ BORGJEZ	90
SHTETE TË REJA NACIONALE NË EVROPË	94
SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS FUQIA E RE BOTËRORE	97
BOTA NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT TË XIX DHE FILLIMI I SHEKULLIT TË XX	100
ARRITJE SHKENCORE DHE KULTURORE	104
BALLKANIK PREJ FUNDIT TË SHEKULLIT TË XVIII DERI NË LUFTËN E PARË BOTËRORE	108

TEMA 5

KOHA MË E RE

LUFTA E PARË BOTËRORE.....	113
BOTA NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE	117
BASHKIMI SOVJETIK FAKTOR NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE	121
FASHIZMI DHE NACIONALSOCIALIZM	124
BALLKNAI NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE LUFTA E DYTË BOTËRORE	132
KONFERENCAT NDËRKOMBËTARE	136
BALLKANI NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE	139
KOHA E KRIZAVE, NDRYSHIMEVE DNHE KUNDËRVËNIEVE	143
TENDENCAT E REJA NË BOTË PËR PAQE DHE BASHKËPUNIM	147
KRIZA E SOCIALIZMIT DHE RRËNIA E KOMUNIZMIT	151
SHKENCA DHE KULTURA PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	155
BALLKANI PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	159

